- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rurual, Raporti i Gjelbër 2020, Prishtinë, Dhjetor 2020;
- Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme 2020-2021, Prishtinë, 2020;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Plani Hapësinor të Kosovës – Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+, Prishtinë, Qershor, 2010;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036, Prishtinë, Maj 2017;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Strategjia e Cilësisë së Ajrit 2013-2022, Prishtinë, 2013;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit (SMM) 2013-2022, Prishtinë 2013;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019-2028. Plani i Veprimit për Ndryshime Klimatike 2019-2021. Prishtinë, 2018;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022. Prishtinë 2013;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020, Prishtinë 2010;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2016-2020. Prishtinë, 2016;
- Qeveria e Republikës së Kosovës - Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (skzh), Prishtinë, Janar, 2016;
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, Prishtinë, 2016;
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Plani i Veprimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021, Prishtinë, Shtator 2016;
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin parauniversitar në Kosovë 2016-2020, Prishtinë, 2016;
- Qeveria e Republikës së Kosovës - Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (skzh), Prishtinë, Janar, 2016;
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Strategjia Sektoriale 2018-2022. Prishtinë, Dhjetor 2017;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Strategjia e Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Prishtinë, Strategjia për Konsolidimin e Tokës 2010 – 2020, Prishtinë 2010,
- Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010 – 2020, Prishtinë 2009;
- Ministria e Ekonomisë, Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031, Prishtinë, Mars 2023;
- Ministria e Infrastrukturës, Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025, Prishtinë, Tetor 2015;

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Strategjia Kornizë për Ndryshimet Klimatike për Kosovën, Plani Hapësinor i Kosovës 2010 – 2020+, Prishtinë, Qershor 2010;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Plani Hapësinor – Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushës", Prishtinë, 2013;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027, Prishtinë 2016;
- Ministria e Pushtetit Lokal, Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026, Prishtinë, 2016;
- Ministria e Pushtetit Lokal, Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023;
- Ministria e Shëndetësisë, Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021, Prishtinë, Nëntor 2016;
- Ministria e Punëve të Brendshme – Agjencia për Menaxhimin Emergjent, Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Prishtinë, Korrik, 2016;
- Komuna e Klinës, Dokument Planifikimi – Plani Zhvillimor Komunal Klinë, 2014-2021+;
- Komuna e Klinës, Dokument Planifikimi – Harta Zonale e Komunës së Klinës 2020-2028;
- Komuna e Klinës, Dokument Planifikimi – Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027;
- Komuna e Klinës, Dokument planifikimi- Draft-Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2023-2026 ;
- Komuna e Klinës, Dokument Planifikimi – Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal për Komunën e Klinës 2023-2028;
- Komuna e Istogut, Dokument Planifikimi - Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Istogut 2018-2026, Istog, 2018
- Komuna e Gllogocit, Dokument Planifikimi - Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Gllogocit 2020-2028, Gllogoc, 2020.
- Komuna e Malishevës, Dokument Planifikimi - Plani Zhvillimor Komunal i Malishevës 2019-2027, Malishevë, 2018.
- Komuna e Rahovecit, Dokument Planifikimi - Plani Zhvillimor Komunal Rahovec 2018-2026, Rahovec, 2018.
- Komuna e Skenderajt, Dokument Planifikimi - Plani Zhvillimor Komunal i Skenderajt 2017-2025, Skenderaj, 2017.
- Komuna e Pejës, Dokument Planifikimi - Plani Zhvillimor Komunal i Pejës 2020-2028, Pejë, 2019.

**Strategjitë rajonale ose strategjitë e komunave fqinje**

- *Strategjia kombëtare për trashëgiminë kulturore 2017-2027*
  - Objektivi 1: Qasja e Integruar në Trashëgiminë Kulturore, drejt zhvillimit të qëndrueshëm;
  - Objektivi 2: Përfshirja e Trashëgimisë Kulturore në planet zhvillimore;
  - Objektivi 3: Promovimi i Trashëgimisë Kulturore;
  - Objektivi 4: Edukimi, Aftësimi dhe pjesëmarrja aktive në Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.
- *Strategjia për ndryshimet klimatike 2019-2028-Plani i veprimit për ndryshime klimatike 2019-2021 (2018)*
  - Objektivi 1: Zhvillimi i kapaciteteve të Kosovës për përmbushjen e obligimeve në kuadër të Konventës së UNFCCC dhe BE-së;
  - Objektivi 2: Zvogëlimi i emetimeve të gazrave serrë.

- Objektivi 3: Zhvillimi i mekanizmave të ri dhe përmirësimi i atyre aktualë në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, në sektorët me rëndësi ekonomike që janë të cenueshëm ndaj ndryshimeve klimatike;
- Objektivi 4: Ngritja e kapaciteteve të përshtatjes të ekosistemeve natyrore;
- Objektivi 5: Ngritja e kapaciteteve të partnerëve, akterëve dhe hisedarëve qendrorë dhe lokalë për integrimin e çështjeve të ndryshimeve klimatik dhe përshtatjes në proceset e zhvillimit.

❖ *Strategjia (2021-2030) dhe Plani i veprimit (2021-2023) për menaxhimin e integruar të mbeturinave në Kosovë*

Objektivi 1: Shërbimet dhe infrastruktura: Qendrat e menaxhimit të integruar të mbeturinave

Deponia e Pejës do të zgjerohet, ndërsa një deponi e re do të identifikohet për t'i shërbyer rajonit të Prishtinës. Deponitë e tjera rajonale do të avancohen, do të vazhdojnë të funksionojnë ose do të mbyllen dhe rehabilitohen, sipas nevojave dhe orarit të përcaktuar. Transfer stacionet ekzistuese në Ferizaj, Drenas dhe Gjakovë do të vihen në përputhje me standardet, ndërsa transfer stacione të reja do të ndërtohen në Istog, **Klinë**, Skenderaj dhe Novobërdë. Një transfer stacion tjetër është planifikuar të ndërtohet në Malishevë;

- Realizimi i këtij objektivi është reflektuar edhe në Planin e Veprimit të kësaj strategjie, koha e paraparë për realizimin e studimit të fizibilitetit dhe ndërtimit të transfer stacioneve ka qenë periudha 2022-2023.

❖ *Strategjia për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2022-2028*

- Objektivi 1: Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të fermës;
- Objektivi 2: Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore (tokat, pyjet dhe uji);
- Objektivi 3: Mbështetje për bizneset në zonat rurale dhe rritjen e punësimit dhe të infrastrukturës sociale;
- Objektivi 4: Reforma gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për të krijuar shërbime publike efikase.

❖ *Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë në Kosovë 2022-2030*

- Objektivi 1: Përmirësimi i Gjendjes së Resurseve Pyjore;
- Objektivi 2: Mbrojtja e Resurseve Pyjore;
- Objektivi 3: Përdorimi i Qëndrueshëm dhe Shumëqëllimor i Resurseve Pyjore;
- Objektivi 4: Ngritja e Kapaciteteve;
- Objektivi 5: Digjitalizimi dhe Komunikimi.

❖ *Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027*

**Vizioni** - *Komuna e Klinës duke u bazuar ne synimin e përgjithshëm do të siguroj që shërbimet për rreth menaxhimit të mbeturinave të përfshijnë mbulueshmërin e 100 % të territorit të Komunës.*

**Misioni-** *Komuna e Klinës do të angazhohet maksimalisht për zgjerimin e Shërbimit të Mbledhjes se Mbeturinave dhe për ngritjen e cilësisë së shërbimit.*

**Masat e Shërbimit të Grumbullimit të Mbeturinave:**

- *Masa e Par*ë - Ngritja e Cilësisë së Shërbimit në mënyrë të qëndrueshme dhe respektimi i standardit nga të gjithë ata të cilëve u ofrohet shërbimi.
- *Masa e dyt*ë - Rritja e Mbulueshmërisë me Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave dhe përmirësimi i situatës financiare që lidhet me shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbeturinave.
- *Masa e Tret*ë - Krijimi i strukturave organizative;
- *Masa e Katërt-* Vlerësimi i gjendjes ekzistuese;
- *Masa e Pest*ë- Planifikimi operacional i menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave;
- *Masa e* Gjashtë- Planifikimi financiar për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave;
- *Masa e Shtat*ë- Konsultimet për zbatueshmërinë e planit me përfaqësuesit kryesore të komunës.

❖ *Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal për Komunën e Klinës 2023-2028*

***Vizioni, Qëllimet dhe Objektivat për Zhvillim Ekonomik***

Vizioni i komunës s Klinës është të arrihet qëndrueshmëria ekonomike e komunës. Ndërsa, komuna ka si mision të saj përkrahjen dhe mbështetjen e zhvillimit të NVM-ve, bujqësisë, turizmit. Po ashtu, pjesë e misionit të saj është edhe përmirësimi i infrastrukturës fizike, ngritja e cilësisë në arsim, shëndetësi dhe shërbime publike. Duke mos lënë anash ruajtjen e mjedisit dhe trashëgiminë kulturore (citim).

***Qëllimet Strategjike dhe Objektivat Specifike***

Çështjet kryesore me të cilat përballet komuna e Klinës janë përqendruar në pesë tema, të cilat janë shndërruar në qëllime strategjike për zhvillim ekonomik lokal të komunës.

- **Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm** (përkrahja e vazhdueshme e NVM-ve me fokus të veçantë në bujqësi dhe blegtori, nxitja e krijimit të bizneseve të qëndrueshme, nxitja e investimeve të huaja direkte dhe tërheqja e investimeve të huaja, nxitja e rritjes së eksportit të produkteve vendore, nxitja e inovacionit nëpërmjet Partneriteteve Publiko Private, zhvillimi i turizmit vendor nëpërmjet promovimit të resurseve natyrore, peizazheve, trashëgimisë kulturore).
- **Zhvillim i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarëve dhe bizneseve** (ndërtimi i rrugëve të reja dhe infrastrukturës nëntokësore, mirëmbajtja e rrugëve të vjetra, fasadimi i objekteve të vjetra, funksionalizimi i stacionit të autobusëve, ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe rrjetit të kanalizimit, zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik, shtrirja e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave).
- **Përmirësim i cilësisë në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale** (renovimi i objekteve shkollore dhe fushave sportive, investimi në infrastrukturë dhe teknologji informative bashkëkohore, ngritja e kapaciteteve në planifikim strategjik dhe monitorim, përmirësimi i cilësisë në menaxhim të arsimit dhe mësimdhënie, renovimi dhe ndërtimi i objekteve shëndetësore, përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore, përkrahje e të moshuarve dhe familjeve në nevojë, përmirësimi i mirëqenies së qytetarëve).
- **Shërbime komunale cilësore efikase për qytetarët dhe bizneset** (informimi i qytetarëve dhe bizneseve në kohë për lehtësirat në shërbimet komunale, përmirësimi i dhënies së

informatave nga zyrtarët përkatës, publikimi i përditësuar i informatave në ëebfaqen komunës, matja e kënaqshmërisë së qytetarëve dhe bizneseve për shërbimet e ofruara komunale etj.)

- **Ruajtja dhe mbrojta e mjedisit jetësor** (pyllëzimi – mbjellja e drunjve në sipërfaqe të reja, rikultivimi i zonave të degraduara, mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara, ulja graduale e ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës, rregullimi i shtretërve të lumenjve, pastrimi i sipërfaqes së tokës nga mbeturinat e ngurta, mbrojtja e pyjeve nga prerjet e pakontrolluara, rishikimi i planeve menaxhuese të pyjeve në nivel komunal, mbështetje financiare për projektet e riciklimit të mbeturinave).



Fig. shtyllat kryesore të zhvillimit- vizioni

## 1.2.2. Strategjitë prej planeve të mëparshme komunale

❖ *Plani hapësinorë për monumentin e natyrës me interes të veçantë ''Ujëvara e Mirushës''*

Parku "Ujëvarat e Mirushës", është një ndër zonat më të bukura dhe më interesante të natyrës së Kosovës, i cili shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, në territorin e komunave Klinë, Malishevë dhe Rahovec, dhe përfshinë një sipërfaqe prej 598.4 ha. Parku gjendet në jug të maleve Gremnik, në të dy anët e rrjedhës së lumit Mirusha.

Sipas konceptit zhvillimor pjesa më e madhe e territorit i takon zonës së parë dhe të dytë të mbrojtjes (bazuar në Ligjet në fuqi), në të cilat përpos aktiviteteve mbrojtëse nuk parashihen zhvillime tjera. Ndërsa pjesa tjetër që nuk është më e madhe se 10% e territorit të përgjithshëm i dedikohet zhvillimeve kryesisht të shërbimeve që mungojnë, të cilat në mënyrë indirekte janë paraparë të kenë efekte në mbrojtjen e zonës si tërësi.

❖ *Plani zhvillimor komunal 2014-2021+*

**DEKLARATA E VIZIONIT** "*"Komuna e Klinës - qendër rajonale e zhvillimit bujqësor, me shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve natyrore, nyje e transportit rajonal, mikpritëse dhe atraktive, me qytetarë aktiv dhe të motivuar."*

QËLLIMET AFATGJATA TË ZHVILLIMIT

Mjedisi dhe Natyra:

- Mbrojtja e tokës bujqësore;
- Mbrojtja e tokës pyjore;
- Mbrojtja e burimeve ujore;
- Mbrojtja e ujërave dhe shtretërve të lumenjve;
- Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore;
- Shfrytëzimi i energjisë alternative.

Zhvillimi Social:

- Qeverisje efikase komunale;
- Ngritja e kualitetit të arsimit dhe shtrirja e arsimit fillor në tërë territorin e komunës;

- Ngritja e kualitetit dhe shtrirja e shërbimeve shëndetësore primare në tërë territorin e komunës;
- Zhvillimi i arsimit profesional për t'i aftësuar të rinjtë për punë në profesionet prodhuese;
- Zhvillimi i kulturës dhe sportit dhe rekreacionit në Klinë dhe fshatra.

Zhvillimi Ekonomik:
- Politika stimuluese për zhvillimin e bujqësisë;
- Rivitalizimi i industrisë bujqësore – produktet themelore dhe përpunimi i prodhimeve;
- Zhvillimi i tregëtisë dhe shërbimeve;
- Zhvillimi i eko turizmit dhe turizmit kulturor.

Infrastruktura:
- Ndërtimi i një sistemi efikas të rrjetit të qarkullimit në tërë komunën;
- Ndërtimi qendrës së mobilitetit në klinë - stacioni i autobusëve dhe hekurudhor;
- Ndërtimi i sistemit funksional të ujësjellësit në tërë territorin e komunës;
- Ndërtimi i i sistemit efikas të kanalizimit;
- Përmirësimi i furnizmit me energji elektrike.

PRIORITETET STRATEGJIKE
- Mbrojtja e tokës bujqësore;
- Kufizimi i zgjerimit të vendbanimeve;
- Përkrahja e turizmit përmes hartimit të planeve rregulluese;
- Mbrojtja e shumëllojshmërisë së peizazheve natyrore;
- Ndërtimi i një sistemi të integruar të furnizimit me ujë për tërë komunën;
- Ndërtimi i një sistemi të ri dhe të ndarë të kanalizimit fekal dhe atmosferik.

❖ *Plani Zhvillimor Urban i Klinës*

Komuna e Klinës ka një Plan Rregullues Urban (PRrU) i cili mbulon gjithë pjesën Urbane të qytetit të Klinës. Zona urbane e mbuluar me PRrU aktualisht ka një sipërfaqe prej 577,92 ha. Vizioni sipas Planit Zhvillimor Urban e orienton zhvillimin e qytetit duke u bazuar në potencialet e Klinës dhe duke investuar në zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre. Duke u artikuluar me synimet strategjike për zhvillim, vizioni , qytetin e Klinës e parasheh si "qytet bujqësor", "eko-qytet" apo "qytet me turizëm ekologjik". Qëllimet e të tri varianteve janë : mbrojtja e tokës bujqësore, përkrahja e prodhimit bujqësor, përforcimi i balansit ekologjik, inkurajimi i agroturizmit, inkurajimi i ndërmarrjeve për të zhvilluar vikend-turizmin, përkrahje të themelimit të agjensioneve turistike etj..

Deklarata e vizionit për qytetin e Klinës është: "*Klina, qytet me zhvillim të qëndrueshëm të bazuar në bujqësi, resurse natyrore dhe vlerat e trashëgimisë kulturore*"

❖ *Harta Zonale e Komunës së Klinës 2020-2028*

Komuna e Klinës aktualisht e ka në fuqi Hartën Zonale të Komunës e cila është e vlefshme për periudhën 2020-2028.

## 1.2.3. UDHËZIMET, PËRGJEGJËSITË DHE KËRKESAT QË BUROJNË NGA KONTEKSTI I GJERË PLANIFIKIMIT SIÇ JANË PLANIFIKUAR NË PLANIN HAPËSINOR TË KOSOVËS

Me Konceptin e zhvillimit të ardhshëm hapësinor, Kosova ndahet në katër zona të cilat janë caktuar në bazë të tipareve që janë karakteristike për këto zona. Këto tipare paraqesin llojllojshmërinë dhe në të njëjtën kohë janë unike për secilën nga to. Tiparet sipas të cilave është bërë ky zonim janë: potencialet zhvillimore të këtyre zonave, karakteristikat gjeografike dhe veprimtaritë ekonomike që zhvillohen në këto zona. Zonat janë emëruar me emra që prezantojnë një formë të identitetit të zonave, disa karakteristika që posedojnë dhe në hartë paraqiten me ngjyra të caktuara.
Klina bënë pjesë në hapësirën e quajtur “Kopshti i Kosovës (Hapësira e portokalltë) - kulturore-turistike, shërbyese tregtare, agro-industriale – Peja” Kjo hapësirë zë pjesën perëndimore dhe veriperëndimore të Kosovës, shtrihet në luginën e pëlleshme të Dukagjinit, përgjatë kufirit me Bjeshkët e Nemuna, në luginën e Lumëbardhit, me afro 300.000 banorë, klimë kontinentale e klimë mesdhetare dhe me një rrjet hidrografik të zhvilluar. Komunat që e përbëjnë këtë zonë janë: Peja, Istogu dhe Klina.
Hapësira karakterizohet me mjedis të pastër, pyje dhe tokë kualitative bujqësore, rezerva të ujërave termal, thëngjillit në afërsi të Klinës, trashëgimi të pasur natyrore dhe kulturore, si dhe një traditë në kultivim të agro-industrisë, tregtisë dhe turizmit. Lidhja ndërkufitare e qytetit të Pejës me Malin e Zi bën që qyteti të jetë bartës i zhvillimit ekonomik të hapësirës dhe zgjerimin e tregut.




Figura 1 Strategjia e Zhvillimit Hapësinor – Hapësira e Portokalltë

**Zonat dhe monumentet natyrore të mbrojtura**

- Burimi i ujit mineral në Dresnik, Klinë – monument natyror me karakter hidrologjik;
- Gryka e lumit Klina, Klinë – monument i natyrës me vlera gjeomorfologjike, hidrologjike dhe botanike;
- Trungu i qarrit në Zllakuqan, Klinë – monument natyror me karakter botanik dhe turistik;
- Trungu i qarrit në Poterq të ulët, Klinë – ish monument natyror me karakter botanik;
- Trungu i Vidhit në Qabiq, Klinë - ish monument natyror me karakter botanik;
- Trungu i qarrit në Bërkovë, Klinë - ish monument natyror me karakter botanik.

**Zonat e veçanta të mbrojtura**
Në grupin ku kufiri i zonave është përcaktuar me anë të hartave janë:
1. Manastiri i Budisavcit, Klinë;
2. Kisha e Heremitëve, Ularicë, Klinë.
Në grupin ku zonat kanë një bufer zonë prej 50m' nga perimetri i "oborrit" të tyre janë:
1. Manastiri i Dollcit, Klinë.

**Vizioni:** *"Zonë e zhvilluar kulturore e turistike, agro-industriale dhe tregtare, zhvilluar në rrënjët dhe traditat e lashta, me qeveri lokale të përgjegjshme dhe efikase, në bashkëpunim me qytetarët e saj dhe aktorët për zbatim të qëllimeve zhvillimore me shfrytëzim të resurseve natyrore dhe njerëzore, posaçërisht në fushën e turizmit, afarizmit e bujqësisë."*
**Qëllimet e përgjithshme:**

- Zhvillimi i rrjetit e atraktiv të qyteteve të planifikuara;
- Mbështetje ZHEL për ZHEK me promovim të NVM me – shfrytëzim të përparësive konkurruese;
- Zhvillimin e lidhjeve efikase urbane, ndërurbane, rrjetit të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, TI-së);
- Qeverisje dhe administratë lokale efikase dhe përkrahëse në synimet për zhvillime;
- Zhvillimi i turizmit malor e kulturor, veprimtarive industriale, shërbyese e tregtare, me mbrojtje të trashëgimisë natyrore, kulturore;
- Bashkëpunim ndërkufitar për zhvillime me interes të përbashkët.

**Përparësitë, mangësitë dhe mundësitë e zhvillimit të ardhshëm**

**Përparësitë dhe mundësitë:**

- Hapësirë e pasur me resurse njerëzore e natyrore, me traditë në kultivim të artizanateve, procesim të prodhimeve ushqimore, tregti e industri përpunuese;
- Peja, qytet tërheqës kulturor për vizitorë dhe investitorë potencial, afërsi me Bjeshkët e Nemuna si park nacional;
- Trashëgimi kulturore e historike, potenciale për zhvillimin e turizmit;
- Lidhjet e mira rrugore me tregjet kosovare dhe shtete fqinje Mal të Zi e më tej Adriatik;
- Fakulteti i Biznesit në Pejë;
- Përfshirja e diasporës në përpjekjet për ZHEL;
- Burime të mjaftueshme uji (pije, sistem të ujitjes, hidroenergji)

**Mangësitë**
- Shkallë e lartë e papunësisë;
- Humbja e tokës bujqësore;
- Mungesë e planifikimit urban;
- Ndërtim ilegal me shfrytëzim të pakontrolluar të resurseve;
- Hekurudha joaktive;
- Moskoordinim institucional ndërmjet qeverisë lokale dhe komunitetit të biznesit, me komunat fqinje administrim i dobët lokal;

- Ekonomia joformale.

**Zonat hapësinore në zonën e portokalltë me interes të veçantë për Kosovën**
- Zonat e kalimit kufitar (Kulla, Çakorr);
- Parku Nacional (Bjeshkët e Nemuna);
- Mbrojtja e trashëgimisë kulturo-historike (Patriarkana e Pejës, Manastiri i Deçanit, Kullat Shqiptare);
- Mbrojtja e ujërave (Drini Bardhë, Lumëbardhi i Pejës), ujërat termalë.

## 1.3. INFORMATA PËR PROCESIN E PLANIFIKIMIT

### 1.3.1. Listimi i prezantimeve publike, konsultimeve, takimeve rishikuese dhe mekanizmave të përdorur për të angazhuar publikun në procesin e planifikimit

Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) i Komunës së Klinës dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor janë hartuar nga Komuna e Klinës për të orientuar zhvillimin e saj në mënyrë të qëndrueshme për vitet e ardhshme. Procesi i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) sipas udhëzimit administrativ përfshin fazat e planifikimit në të gjitha aspektet socio-ekonomike dhe ambientale duke involvuar të gjitha palët e interesit. Kuvendi Komunal Klinë miratuar vendimin për nisjen e procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe udhëzimin administrativ në fuqi me datën 25.06.2021.
Me vendim të Kryetarit është formuar komision, që përfshin profesionistë nga fusha e urbanizmit, arkitekturës, mjedisit, ekonomisë, dhe përfaqësues të palëve të interesit, siç janë organizatat joqeveritare dhe komuniteti lokal.
Janë mbajtur takimet e njëpasnjëshme me ekipin punues dhe kompaninë konsulente dhe janë përcaktuar objektivat kryesore të PZHK-së duke u bazuar në zhvillimet strategjike të komunës, politikat kombëtare, si dhe kriteret e qëndrueshmërisë (integrimi i SDG-ve, politikat e mbrojtjes së mjedisit, etj.).
Komuna dhe komisioni i caktuar kanë mbledhur të dhëna në lidhje me zonimin aktual, strukturat ekzistuese, infrastrukturën, burimet natyrore, popullsinë, ekonominë, dhe shërbimet publike. Është përgatitur një analizë e detajuar e situatës aktuale që përfshin të gjitha aspektet urbanistike dhe zhvillimore të komunës dhe janë përdorur mjete si Sistemi Informativ Gjeografik (GIS) për të shfaqur dhe analizuar të dhënat.
Janë realizuar takime dhe konsultime me palët e interesit për të mbledhur për të diskutuar mbi sfidat dhe mundësitë e zhvillimit të komunës.
Bazuar në analizën e të dhënave dhe kontributi i palëve e interesuara, është hartuar drafti i parë i Planit Zhvillimor Komunal ku ka përfshirë:
- Propozime për ndarjen e tokave sipas përdorimit.
- Planifikimin e infrastrukturës (rrugët, shërbimet publike, etj.).
- Strategjitë për zhvillimin ekonomik.
- Propozimet për mbrojtjen e mjedisit dhe të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Pas kësaj është mbajtur edhe Diskutimi i draftit të parë “ Profili Komunal dhe Gjendja Ekzistuese” ku është prezantuar drafti përmes takimeve me banorët e komunës, organizatat e shoqërisë civile, dhe institucionet përkatëse.

Konsultimi publik: Drafti i parë i PZHK-së është mbajtur me datën 17.11.2023 ku është vendosur në dispozicion të publikut për konsultim. Komuna ka organizuar takime të hapura ku qytetarët dhe grupet e interesit japin sugjerimet dhe vërejtjet e tyre në lidhje me Fazën e "Profilit dhe Gjendjes ekzistuese".

Pas përfundimit të periudhës së konsultimit publik, janë bërë rishikime dhe përmirësime të draftit duke marrë parasysh rekomandimet e dhëna nga palët e interesit dhe institucionet përkatëse.

Në vazhdimësinë e aktiviteteve në lidhje me Hartimin e PZHK-së është mbajtur edhe Punëtoria njëditore me datën 04.12.2023 për hartimin e Kornizës së Zhvillimit Hapësinor për Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës, ku ishte një aktivitet i rëndësishëm që synonte përfshirjen e të gjithë anëtarëve të ekipit punues dhe të ekspertëve relevantë për të krijuar një bazë të qartë për zhvillimin e planit të përgjithshëm. Kjo punëtori u organizua për të siguruar që të gjitha aspektet kryesore të hapësirës urbane dhe rurale të Klinës të merren në konsideratë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe strategjike. Gjatë punëtorisë, u trajtuan tematika të rëndësishme si:

- Hartimi i vizionit për komunën e Klinës
- Përcaktimi i objektivave kryesore të zhvillimit hapësinor: Diskutim mbi qëllimet afatgjata dhe afatshkurtra të zhvillimit të komunës, duke u fokusuar në ndarjen e tokave, zhvillimin e infrastrukturës, dhe përdorimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore.
- Analiza e sfidave aktuale: Çështjet e identifikuara në analizat paraprake u diskutuan në detaje, duke përfshirë problemet me infrastrukturën, qasjen në shërbimet publike, dhe sfidat e mbrojtjes së mjedisit.
- Hartimi i kornizës së zhvillimit: U zhvilluan diskutime të thelluara për përcaktimin e zonave prioritare për zhvillim, ndarjen e funksioneve urbane dhe rurale, dhe integrimin e kritereve për qëndrueshmëri dhe efikasitet energjetik.
  - Pjesëmarrja e palëve të interesit: U vlerësua rëndësia e përfshirjes së qytetarëve dhe palëve të tjera të interesit gjatë fazave të ardhshme të hartimit të planit, për të siguruar transparencë dhe bashkëpunim.

Në përfundim të punëtorisë, u formuluan disa rekomandime dhe hapa të ardhshëm për përpunimin e mëtejshëm të kornizës së zhvillimit hapësinor. Kjo punëtori ndihmoi në krijimin e një platforme solide për hartimin e suksesshëm të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës 2025-2033.

Për daljen në Shqyrtim publik të Dokumentit të PZHK-së është e nevojshme edhe në bazë të legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit, është bërë vlerësimi nëse për projektin e PZHK-së kërkohet VSM. Për shkak të ndikimeve të mundshme në mjedis që sjellin planet zhvillimore afatgjata, VSM është e domosdoshme për PZHK-në.

Komuna ka përzgjedhur një kompani në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor për të hartuar dokumentin e VSM-së, që përfshin analiza të thelluara mbi ndikimet mjedisore, socio-ekonomike dhe kulturore, jenë analizuar ndikimet potenciale të ndryshimeve në përdorimin e tokës, zhvillimin urban, infrastruktura dhe projekte të tjera të planifikuara në PZHK në mjedis, si p.sh. ndikimi në tokë bujqësore, pyje, lumenj, cilësinë e ajrit, etj.

MMPHI ka lëshuar pëlqimin për Raportin e VSM-së me datë 10.12.2024.

### 1.3.2. Të dhënat e marra nga qytetarët dhe mënyra e trajtimit të tyre gjatë procesit të planifikimit

### 1.3.3. PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE E SHKURTËR E PZHK-SË

Ky Plan Zhvillimor Komunal për Komunën e Klinës përfshinë periudhën 2025-2033 dhe është hartuar duke respektuar me përpikmëri udhëzimet dhe kërkesat e Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 11/2015 Mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal.

Ky plan në tërësi respekton Planin Hapësinor të Kosovës dhe planet dhe dokumentet tjera strategjike të nivelit qendror, siguron vazhdimësi të Planit Zhvillimor Komunal të Klinës 2014-2021+ si dhe Hartën Zonale të Komunës së Klinës. Plani po ashtu është harmonizuar me dokumentet tjera strategjike dhe sektoriale të Komunës së Klinës, ndërsa është harmonizuar edhe me Planet Zhvillimore Komunale të komunave fqinje.

Si i tillë, ky plan është strukturuar dhe ka një përmbajtje që respekton në tërësi kërkesat e Udhëzimit Administrati, në këtë mënyrë dokumenti përmbanë pjesën e Profilit Komunal, Analizës së Gjendjes Ekzistuese dhe fazën e Planifikimit për fushat kyce si Vecoritë Fizike të Komunës, Demografinë dhe Cështjet Sociale, Ekonominë, Infrastrukturën Publike dhe Sociale; Infrastrukturën Teknike dhe Telekomunikacionin, Transportin dhe Infrastrukturën e tij; Trashëgiminë Kulturore dhe Natyrore; Vendbanimet dhe Banimin, Shfrytëzimin e Tokës etj.

Plani po ashtu përmbanë edhe Kornizën e Zhvillimit Hapësinor, e cila përfshinë Vizonin, Qëllimet dhe Objektivat Zhvillimore, Konceptin e Zhvillimit Hapësinor, Planin e Veprimit dhe Prioritetet Strategjike si dhe pjesën e Zbatimit dhe Monitorimit. I gjithë planifikimi është bërë duke respektuar Deklaratën e Vizionit dhe Objektivat Strategjike të dokumentit, të cilat përfshijnë sigurimin e balancit në mes të zhvillimit socio-ekonomik, mbrojtjes së mjedisit si dhe gjithëpërfshirjes dhe barazisë sociale. Mbrojtja strikte e burimeve natyrore, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore, zhvillimi ekonomik i bazuar në potencialin real zhvillimor të komunës si dhe invesimi në infrastrukturën publike-sociale dhe në atë teknike për të përmbushur të paktën standardet minimale të përcaktuara me Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor të Kosovës janë ndër qëllimet kryesore strategjike të këtij dokumenti.

Planifikimi për të ardhmen është bërë duke marrë për bazë projeksionin e popullsisë së adhshme të komunës së Klinës, e cila është paraparë që deri në vitin 2033 të bie në 27,089 banorë.

# 2.PROFILI I KOMUNËS

## 2.1. KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË KOMUNËS

### 2.1.1. Historiku i Komunës

Pozita e mirë gjeografike, kushtet e përshtatshme për jetesë, pasuritë natyrore dhe klima e favorshme kanë kushtëzuar që territori i Komunës së Klinës të jetë i banuar që nga lashtësia dhe të krijohen vendbanime të shumta. Aty gjenden vendbanime që datojnë nga parahistoria - koha e neolitit. Dëshmi për këtë janë gërmadhat e shumta që gjenden në lokalitete të ndryshme të komunës. Ndër to mund të veçohen gjurmët e lokaliteteve të njohura ilire si në Përcetë (Përcevë), Qëndresë (Gllarevë), pastaj gërmadhat ende të pa hulumtuara në vetë lokalitetin e Klinës, Dërsnikut, Lugut (Dollcit), Gurgatit (Pograxhës), Klinafcit, Bardhajve (Jashanicës) e shumë të tjera. Janë bërë edhe zbulime të tjera arkeologjike të periudhave të ndryshme historike edhe në vendbanimet tjera. Janë zbuluar sidomos tuma ilire në shumë vendbanime të kësaj komune. Pothuajse në çdo lokalitet të vendbanimeve të sotme ka gjurmë të lokaliteteve të vjetra të periudhave të ndryshme. Janë gjetur edhe gjurmë të shumta të kulturës materiale. Dëshmitë tregojnë se Klina ishte një vendbanim i hershëm ilir, me emër Chinna, të cilën e hasim te Ptolemeu që në vitet 87-150 (në hartën e Ptolemeut). Ky lokalitet i lashtë ilir shtrihet në bregun e majtë të rrjedhës së epërme të Drinit të Bardhë, që i përgjigjet realitetit të sotëm gjeografik. Chinna në kuptimin Cin shpjegohet si "kin" në mes të Drinit të Bardhë dhe lumit Klina. Në shekullin e parë para erës sonë, romakët filluan depërtimin e tyre pushtues ndërsa më vonë Mbretërisë Dardane iu njoh statusi i provincës së Dardanisë. Gjatë sundimit romak u ngritën shumë vendbanime përgjatë rrugëve kryesore rajonale. Vendbanimet i ngriti një pjesë e popullsisë që zbriti nga vendbanimet e vjetra në keshtjellat në kodrina. Në shekullin e parë të erës sonë, si qendër në këtë pjesë të fisit dardan përmendet edhe Dërsniku, ndërsa gjatë sundimit bizantin hasim në gjurmët e kishës së Pashkaj (Paskalices) me kambanore në fshatin Videjë. Kronisti Konstantin Porfirogjeni në traktatin e tij të njohur "Shënime për popujt" në vitin 948-952, shkruan se ndër qytetet e banuara dendur është edhe Dresniku - "Desstinik". Vendbanim i hershëm është edhe Dollci i sotëm, i cili është i shënuar me emrin Zalug në hartën e Manastirit të Hilandarit ne vitin 1198/9. Pushtimi romak shkaktoi pasoja jo vetëm nga aspekti politik, por edhe ekonomik. Në këtë drejtim pësuan vendbanimet, posaçërisht ato të fortifikuara, që ishin të njohura në atë kohë, si dhe fortifikatat mbrojtëse të popullatës iliro-dardane. Pas sundimit romak, bizantin dhe bullgar, nga fundi i shekullit XII trevat e Kosovës u pushtuan nga sllavët. Me ardhjen e sllavëve, edhe në këto treva ndryshoi harta onomastike e saj. Shumë emërtime të vjetra iliro-shqiptare të vendbanimeve, të personave e të tjera u zëvendësuan me emërtime të reja sllave. Në këtë periudhën e sundimit mesjetar serb, u bë edhe përvetësimi i kishave ekzistuese të asaj kohe. Në Betejën e Kosovës më 1389, këto treva ranë përkohësisht nën sundimin osman, mirëpo ai nuk e ndryshoi në thelb fizionominë e strukturës etno-kulturore të nacionalitetit shqiptar në Kosovë dhe në Rrafshin e Dukagjinit, megjithatë, solli ndryshime të rëndësishme në planin politik, ekonomik, shoqëror e ideologjik. Defterët osman, shënimet e udhëpërshkruesve të ndryshëm gjatë sundimit osman e burime të tjera japin shënime të rëndësishme, për trevat shqiptare duke përfshirë edhe territorin e Klinës në veçanti. Të bazuar në defterin e Vilajetit Vëllk të vitit 1455, qendër e kësaj treve ishte Dollci, si nahi, me manastirin e tij dhe me 19 fshatra. Vendbanimi më i madh ishte Dresniku me 104 shtëpi. Edhe Vushtrria e sotme me shumë vendbanime ishte në kuadër të kësaj Nahije. Gjatë sundimit osman edhe në këto treva ndodhen shumë luftëra,

kryengritje, rezistencë e popullatës shqiptare, dhe sigurisht që kishte lëvizje të shumta të popullsisë. Të gjitha këto u reflektuan edhe në krijimin, rrënimin, ngritjen etj. të vendbanimeve të këtij territori. Pas rënies së Perandorisë Osmane më 1912, Kosova u pushtua nga Serbia dhe Mali i zi dhe më tutje gjatë shekullit XX, kaloi nëpër një varg të krizave, luftërave e pushtimeve të ndryshme. Këto ndryshime lanë pasoja tejet të rënda në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror, ekonomik dhe politik. Nga kjo situatë nuk u kursye as treva e Klinës. Format e ndryshme të presioneve sociale, politike e ekonomike vazhduan gjatë tërë kësaj periudhe ndërsa pati momente kur u rrezikua edhe vetë ekzistenca fizike e popullatës. Komuna e Klinës si njësi organizative në kuadër të organizimit territorial të Republikës së Kosovës është themeluar në rang komune, në vitin 1954. Gjatë pjesës së dytë të shekullit XX, komuna e Klinës, sikurse edhe e gjithë Kosova kishte një zhvillim ekonomik e social të ngadalshëm dhe me ndryshime të theksuara. Kjo si rrjedhojë e rrethanave politike e socio-ekonomike që kaloi Kosova deri në luftën e fundit.
Në komunën e Klinës vërehet një zhvillim më i theksuar ekonomik gjatë vite 1970 e deri në vitin 1980. Më pas, pas vitit 1980 e deri në fillimin e luftës së fundit prapë kemi një stagnim të theksuar si pasojë e okupimit klasik nga pushteti okupues serb. Nga lufta pati pasoja shumë të rënda si: humbja e jetës së njerëzve, zhdukja e tyre dhe një numër i konsiderueshëm i tyre janë të pa gjetur edhe sot. Dëmet ekonomike ishin shumë të mëdha si në ndërmarrje ekonomike, ashtu edhe në ekonomi familjare dhe shtëpia të banimit, të mira të tjera materiale, në infrastrukturë etj.
Pas përfundimit të luftës në vitin 1999, kjo komunë dhe qytetarët e saj, duhej të fillonin me organizimin e jetës, rindërtimin e shtëpive, zhvillimin ekonomik e social, infrastrukturën etj. Për më shumë se dy dekada pas përfundimit të luftës, komuna e Klinës ka arritur ta përmirësoj dukshëm gjendjen ekonomike, sociale e infrastrukturore, por bazuar në pozitën e saj qendrore dhe potencialet natyrore e humane, në të ardhmen mund të ketë një zhvillim më të qëndrueshëm që do të ndikoj në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

### 2.1.2. Pozita Gjeografike

Komuna e Klinës shtrihet në pjesën perëndimore të Kosovës apo në pjesën verilindore të Rrafshit të Dukagjinit. Ka një sipërfaqe prej 308.8 km2 dhe përbëhet nga zona urbane e Klinës dhe 54 fshatra. Gjendet rreth 55 km në perëndim të Prishtinës dhe kufizohet me shtatë komuna: në veri kufizohet me Istogun, në lindje me Skenderajn dhe Drenasin, në jug me Malishevën, Rahovecin dhe Gjakovën, ndërsa në perëndim me Pejën. Pozita e mirë gjeografike në të cilën shtrihet komuna e Klinës i mundëson lidhje të mira me qendrat e tjera të Kosovës.



Harta 1. Pozita Gjeografike e Komunës së Klinës në Hartën e Republikës së Kosovës

Pozita natyrore dhe konfiguracioni mundësojnë që Klina të ketë lidhje të mira rrugore dhe hekurudhore. Nëpër Klinë kalon rruga magjistrale Prishtinë-Klinë-Pejë, rruga Klinë-Skenderaj-Mitrovicë, Klinë-Istog-Pejë si dhe vijat hekurudhore Fushë Kosovë-Klinë-Pejë dhe Fushë Kosovë-Klinë-Prizren. Qendra komunale e Klinës ka një specifikë të veçantë, sepse ndodhet në mesin e të gjitha fshatrave të saj dhe distanca më e largët nga qendra komunale është vetëm 12 km. Gjithashtu, struktura e qendrave institucionale është e rregulluar me qasje të mirë dhe të shpejtë.
Magjistralja Prishtinë – Pejë kalon pran këtij qyteti. Me Prishtinën (55 km) dhe Pejën (30 km) lidhët përmes kësaj rruge. Gjithashtu kjo rrugë e lidh edhe me aeroportin e Prishtinës në një largësi prej 48 km. Relievi i komunës së Klinës ndryshon mes pjesës lindore dhe asaj perëndimore. Në pjesën perëndimore dhe qendrore të komunës dominon terren më i rrafshët (deri 500 m lartësi mbidetare), ndërsa pjesa veriore dhe verilindore është më e lartë (500-700 m të lartësisë mbidetare). Dominon kryesisht klima e butë kontinentale me ndikimin dhe depërtimin e klimës mesdhetare përmes luginës së Drinit, me temperatura mesatare vjetore 10.8 °C.
Nëpër territorin e komunës së Klinës rrjedhin gjashtë lumenj: Drini i Bardhë, Lumëbardhi i Pejës, Klina, Mirusha, Lumi i Istogut dhe lumbardhi i Deçanit. Prej tyre katër kanë rrjedhë fushore dhe me ndërtimin e ujë nxënieve (pendave) përgjatë rrjedhës së tyre do të mund të ujiteshin deri në 2.000 ha toka bujqësore. Me realizimin e projekteve për ndërtimin e kanaleve të ujitjes dhe pendave deri me tani ujiten rreth 1200 ha tokë bujqësore. Në territorin e komunës së Klinës janë hulumtuar rezerva të nevojshme për zhvillimin e mihjeve të mëdha të thëngjillit, të rezervave të boksitit, zhavorrit dhe argjilës për prodhim të tullave.

### 2.1.3. Veçoritë Mjedisore

#### *2.1.3.1. Gjeomorfologjia*

Territori i komunës së Klinës ka një relief mjaft të përshtatshëm pasi që shtrihet në një hapësirë relativisht të rrafshët. Në pjesën qendrore të komunës dominojnë rrafshinat me lartësi deri në 400 m, ndërsa pjesët më të ngritura të relievit janë të pozicionuara në anën juglindore me lartësi mbi 700 m. Komuna e Klinës si hapësirë gjeografike në kuadër të territor të saj, lartësitë deri në 600 m janë afro 90% e territorit. Klina shtrihet në kuadër të basenit të Dukagjinit dhe në territorin e saj ka mjaftë tokë pjellore e sipërfaqe pyjore (si pjesa e maleve të Grebnikut). Në kuadër të pjesës ultësinore janë formuar dhe terrene aluviale të lumenjve që rrjedhin në këtë hapësirë si Drini i Bardh, Lumëbardhi i Pejës, Lumëbardhi i Deçanit, lumi Mirusha, lumit Klina).

**Tabelë 1**. Sipërfaqja e Komunës së Klinës sipas Lartësisë Mbidetare

| Lartësia | Km² | Përqindja (%) |
|---|---|---|
| **Deri 400 m** | 54.02 | 17.45 |
| **401 – 500 m** | 132.10 | 42.66 |
| **501 – 600 m** | 101.29 | 32.71 |
| **601 – 700 m** | 21.98 | 7.10 |
| **Mbi 700 m** | 0.25 | 0.08 |
| **Totali** | 309.64 | 100.00 |




**Harta 2.** Lartësia mbidetare e Komunës së Klinës

Element mjaftë i rëndësishëm sa i përket relievit është edhe ekspozicioni i terrenit. Komuna e Klinës bazuar në konturat e relievit rezulton që ka një ekspozicion mjaftë të përshtatshëm.

**Tabelë 2**. Ekspozicioni i terrenit në Komunën e Klinës

| Drejtimi i uljes (Aspects) | Shkalla | Vlera e thyerjes (%) | Sipërfaqe/ ha |
|---|---|---|---|
| **Rrafshët** | (-01) | 0.37 | 114.29 |
| **Veri** | 0 - 22.5 | 7.17 | 2219.09 |
| **Veri-Lindje** | 22.5 -67.5 | 10.30 | 3189.98 |
| **Lindje** | 67.5 - 112.5 | 8.94 | 2767.86 |
| **Jug-Lindje** | 112.5 - 157.5 | 12.56 | 3888.08 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Jug** | 157.5 - 202.5 | 15.98 | 4948.96 |
| **Jug-Perëndim** | 202.5 - 247.5 | 13.08 | 4050.64 |
| **Perëndim** | 247.5 - 292.5 | 11.26 | 3485.74 |
| **Veri-Perëndim** | 292.5 - 337.5 | 13.82 | 4278.18 |
| **Veri** | 337.5 - 360 | 6.53 | 2021.18 |
| **Total** | | 100% | 30964 Ha |




**Harta 3.** Ekspozcioni i terrenit në komunën e Klinës

Nga harta dhe tabela e paraqitur më lartë evidentohet se në komunën e Klinës dominojnë territore me ekspozicion lindje, juglindje, jug e jugperëndim. Këto ekspozicione përfshijnë afro 60% të territorit të komunës. Pjesa tjetër ka kryesisht ekzpozicion verior e veriperëndimor. Pjesët e rrafshëta kryesisht janë të evidentuara në pjesën veriperëndimore të komunës dhe pjesën qendrore të saj. Element shumë i rëndësishëm i relievit është edhe pjerrësia e terrenit. Në kuadër të territorit të Klinës terrenet e buta deri në 5 shkallë janë të evidentuara në pjesën qendrore të komunës afër rrjedhave lumore, ndërsa pjesët periferike të komunës si mali Gremnik janë territore më pjerrësi të theksuar të terrenit.

Shtrirja e komunës së Klinës sipas pjerrësisë së terrenit: Rol të rëndësishëm në shfrytëzimin e terrenit për nevoja të ndryshme si bujqësi, turizëm, ndërtim ka edhe valorizimi i terrenit sipas pjerrësisë. Bazuar në analizat morfologjike të terrenit, rezulton që ka afro 70% të sipërfaqeve (242.28 km2) të komunës së Klinës me terrene të rrafshëta, apo hapësira deri në $8^{o}$. Hapësirat në të cilat gjenden këto terrene janë në shtratin e lumit Drini i Bardhë (zonat kadastrale Stupë,

Budisalc, Jagodë, Deiq), pjesën fundore të lumit Klina (zonat kadastrale Dresnik – perëndim), hapësirat përgjatë shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës (Zonat kadastrale Dugojevë, Grabanicë).

**Tabelë 3**. Klasifikimi i terrenit në Komunën e Klinës sipas pjerrësisë së terrenit

| Pjerrtësia | Sipërfaqja ($km^2$) | Përqindja | Tipi i relievit |
|---|---|---|---|
| **<1$^o$** | 17.71 | 5.74 | Rrafshirë (fushë) |
| **1 - 3$^o$** | 79.57 | 25.78 | Terren shumë pak i pjerrët |
| **3 - 5$^o$** | 68.77 | 22.28 | Terren pak i pjerrët |
| **5 - 8$^o$** | 82.28 | 26.66 | Terren relativisht i pjerrët |
| **8 - 12$^o$** | 46.55 | 15.08 | Terren dukshëm i pjerrët |
| **12 - 16$^o$** | 9.6 | 3.11 | Terren shumë i pjerrët |
| **16 - 20$^o$** | 2.41 | 0.78 | Terren i rrëpirët |
| **20 - 30$^o$** | 1.56 | 0.51 | Terren mesatarisht I rrëpirët |
| **30 - 40$^o$** | 0.142 | 0.05 | Terren shumë I rrëpirët |
| **>40$^o$** | 0.017 | 0.01 | |
| | 308.60 | 100.00 | |

Terren dukshëm të pjerrët (8-12$^o$) deri në terrene mesatarisht të rrëpirët (30$^o$) janë 19.29% e territorit të komunës të cilat përfshijnë terrenet në zonat kadstrale Dresnik, Dollc, Gremnik, Qupevë, Volljak. Terrenet të cilat konsiderohen si shumë të pjerrëta përfshijnë disa zona ndërmjet zonës kadastrale Klinafc dhe Dresnik, Ujmirë etj. Këto terrene kanë sipërfaqe afro 1 $km^2$ apo 0.06% të territorit të komunës së Klinës.




**Harta 4.** Pjerrësia e terrenit në komunën e Klinës

### 2.1.3.2. Gjeologjia

Territori i Komunës së Klinës në aspektin gjeologjik është mjaft kompleks. Në ndërtimin gjeologjik të hapësirës së saj janë të pranishme formancione gjeologjike të moshave të ndryshme, kryesisht nga ato më të reja të periudhës së Kuaternarit (përfaqësohen nga avluvionet e rërës dhe argjilës) dhe atyre më moshë më të vjetër kryesisht të përfaqësuara nga shkëmbinjtë e triasikut dhe jurasikut të mesëm (piroksenite pjesërisht të serpentizuara). Hulumtimet gjeologjike në territorin e komunës së Klinës janë kryer në kuadër të hulumtimeve për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Në kuadër të territorit të komunës së Klinës janë zhvilluar procese të ndryshme gjeologjike, të cilat kanë krijuar mineralizime të ndryshme, si ajo e gëlqeres në Volljak.




**Harta 5.** Harta Gjeologjike e  komunës së Klinës

## *2.1.3.3. Pedologjia*

Në kuadër të komunës së Klinës janë evidentuar këto lloje të tokave:
<u>*Tokat e kuqe*</u>- përfshijnë pjesën juglindore të komunës së Klinës, kryesisht të evidentuara në fshatrat Dresnik, Gjurgjevik i Madh, Dollc, një pjesë e Gremnikut dhe Sferkës, pastaj në Perqevë, Gllarevë, Zbërgj, pjesën lindore të Klinafcit dhe pjesën jugore të Jashanicës.
<u>*Tokat minerale moqalore*</u>- hasen në një rrip të ngushtë në kuadër të zonës së tokave aluviale që gjenden në rrjedhën e lumit Drini i Bardhë. Konkretisht këto toka gjenden në mes të Krushevës së Madhe, Zllakuqanit, Jagodës e Berkovës.
<u>*Tokat aluviale*</u>- evidentohen në pjesën qendrore të komunës së Klinës. Këto toka janë tipike në afërsi të rrjedhave lumore siç janë në rastin konkret ato të Drinit të Bardhë, Lumëbardhit të Pejës. Në kuadër të zonave kadastrale këto tokat gjenden kryesisht në Klinë, Zajm, Deiq, Petriq i Epërm, Petriq i Poshtëm, Drenoc, Nagllvakë, Stupë, Budisal, Rudicë, Berkovë, një pjesë e Zllakuqanit.
<u>*Tokat deluviale*</u>- gjenden në kuadër të zonave kadastrale Klinafc, Dresnik, Gremnik e Qupevë. Këto toka janë të evidentuara si rripe tokësore në mes të llojeve tjera të tokave përreth.

<u>*Tokat e mesme të kuerremta*</u>- hasen në pjesën veriore tek Dranashiqi e Zllakuqani, ndërsa në pjesën jugore të komunës së Klinës këto toka evidentohen tek Kpuzi, Volljaku, Dushi, një pjesë e Sferkës, Qeskovës, Grabanicës, Dugajevës.

*Tokat e murme në shtresa kompakte*- hasen në zonën verilindore të komunës tek Siqeva dhe Dushi i Vogël.

*Tokat e murme argjilore*- janë toka me pjesëmarrje të vogël në kuadër të llojeve kryesore të tokave në komunën e Klinës. Këto toka janë të pozicionuara në Jashanicë, një pjesë të Dushit të Vogël (veri), dhe një rrip toke të ngushte në Binxhë.

*Rankeri*- evidentohet në zonat e Shtupielit, në Binxhë, Dranashiq, një pjesë të Jashanicës. Tokat e rankerit hasen dhe në zonat mes Gjurgjevikut të Madhë, Siqevës, Ujmirit, Dobërdoll e Çabiç.

*Smonica*- janë tokat që përmbyllin kufirin lindor të komunës së Klinës dhe evidentohen në Caravik, Çabiç, pjesë shumë të vogla në Dobërdol e Ujmirë.




**Harta 6.** Harta Pedologjike e komunës së Klinës

## *2.1.3.4. Kushtet klimatike*

Klima e komunës së Klinës kryesisht ndikohet nga pozita e saj gjeografike në kuadër të basenit të Dukagjinit dhe morfologjisë së terrenit. Në komunën e Klinës kryesisht dominon klima e mesme kontinentale, në të cilën janë të pranishme katër stinët e vitit dhe të cilat ndikojnë në veprimtaritë ekonomike dhe në vet jetën e popullsisë së kësaj komune. Të dhënat më të reja për komunën e Klinës kryesisht merren nga stacioni meterologjik në Pejë dhe Gjakovë, pasi në territorin e komunës së Klinës nuk ka stacion meterologjik.

**Temperatura e ajrit** – Sipas të dhënave për vitin 2020, temperatura mestare vjetore në komunën e Klinës është 12.2°C. Nëse krahasohet me temperaturat para 10 viteve arrijmë në përfundim se nuk kemi ndonjë ndryshim të theksuar të temperaturave mestare vjetore pasi që temperatura në vitin 2010 ishte 12°C, në vitet 1990 ishte 11.7 °C. Në kuadër të komunës së Klinës sipas të dhënave të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, kalojnë izotermat 10°C dhe 9°C.




**Harta 7.** Harta e temperaturave (Izotermet)

Temperaturat më të ulët janë gjatë muajit Dhjetor dhe Janar, ku gjatë vitit 2020 temperaturat ishin -7.6°C.  Muajt më të nxehtë janë qershori dhe korriku në të cilët gjatë viti 2020 temperaturat maksimale që janë regjistruar ishin 33.9°C.

**Lagështia relative e ajrit** në komunën e Klinës ka vlera mestare prej 76%, me mesataren më të ulët prej 61% gjatë muajve të verës dhe më të lartë prej 88% gjatë muajit dhjetor.




**Grafiku 1.** Lagështia relative e ajrit sipas muajve e shprehur në %

**Diellosja ose Insolacionit** – Është element klimatik që ka ndikim në veprimtaritë e ndryshme ekonomike (bujqësi, turizëm, mjekësi) etj. Zgjatja e diellosjes varet nga faktorët astronomik, meteorologjik dhe nga relievi. Diellosja është më e vogël në lugina të ngushta dhe gryka lumore si dhe në viset malore për shkak të rritjes së vranësirave me rritjen e lartësisë mbidetare. Në bazë të vrojtimeve të diellzimit në katër stacionet meteorologjike (Prishtinë, Ferizaj, Prizren, Pejë), Kosova ka mesatarisht 2066 orë me diell gjatë vitit ose mesatarisht 5.7 orë në ditë. Vlerën më të madhe të diellosjes e ka Prishtina me 2140 orë në vit, Peja me 1958 orë, Ferizaj 2067 orë dhe Prizreni me 2099 orë më diell gjatë vitit. Gjatë vitit në muajin korrik ka më së shumti diellosje, kurse në dhjetor më së paku.[1]

**Erërat** – Pozita gjeografike e komunës së Klinës, konsiston më një hapësirë e cilat përballet kryesisht me erëra që kanë drejtim dominues nga veriu dhe veriperëndimit. Nga kuadranti verior dhe veriperëndimor shpejtësia e erërave është prej 4 – 10 m/s ndërsa nga kuadranti juglindor dhe lindor shpejtësia e erërave arrin prej 2 – 8 m/s. Pra, konstatohet që drejtimet dominuese të erërave janë kryesisht nga ai verior, veriperëndimor, lindor e juglindor.Bazuar në vjetarin hidrometeorologjik të Kosovës, konstatohet që drejtimi i erërave gjatë muajve janar, shkurt, mars, prill e qershor erërat kanë pasur drejtim lindje e juglindje, ndërsa gjatë muajve korrik, gusht kanë pasur drejtim perëndim,




Figura 2. Erërat në komunën e Klinës (Vjetari Hidrometerologjik i Kosovës

[1] Burimi: prof. Dr, Ruzhdi Pllana, Gjeografia e Kosoves 8

ndërsa në muajt gusht, shtator, tetor, nëntor e dhjetor drejtimi i erërave ishte veri, veri-verilindje dhe veri-veriperëndim.

**Reshjet –** Sipas të dhënave për vitin 2020, në komunën e Klinës janë regjistruar gjithsej 954.2 mm reshje. Numri i ditëve me reshje ishte 99 ditë. Sasia më e madhe e reshjeve është regjistruar në muajt Shtator, Nëntor dhe Dhjetor. Shpërndarja e reshjeve në komunën e Klinës është pothuajse e njëtrajtshme, pasi konfiguracioni i terrenit nuk është shumë i theksuar.

Në pjesën më të madhe të territorit të Klinës dominojnë izohijtet me vlera 700 mm. Ndërsa në drejtim të veriut dhe perëndimit sasia e reshjeve rritet deri në 800 mm.




**Harta 8.** Harta e reshjeve në Komunën e Klinës

### *2.1.3.5. Karkakteristikat Hidrografike*

Komuna e Klinës është pasur me rrjet hidrografik sipërfaqësor dhe nëntokësor. Ujërat sipërfaqësor në komunën e Klinës ndahen në lumenj kryesor që kanë gjatësi 68,543 m. Rrjetin kryesor hidrografik të komunës së Klinës e përbëjnë Drini i Bardhë, Lumëbardhi i Pejës, Lumëbardhi i Deçanit, Lumi i Klinës, Mirusha.
Lumi kryesor është Drini i Bardh që njëkohësisht është lum i cili mbledh të gjitha degët lumore që kalojnë në komunën e Klinës. Drini i Bardh buron në malet e Bjeshkëve të Nemuna, rrëzë malit të Rusolisë në lartësi 586 metra. Lum me rëndësi në këtë pjesë është edhe lumi i Klinës i cili buron në shpatet verilindore të Malit të Thatë, në jug të liqenit të Ujmanit. Drini i Bardhë si lum kryesor i kësaj komune ka sipërfaqe të pellgut 4649 km², ndërsa sasia e rrjedhjes është 61 m³/s.




**Harta 9.** Rrjeti hidrografik i komunës

Ujërat nëntokësor janë elemente që varen nga karakteristikat gjeomorfologjike e gjeologjike të komunës së Klinës. Për të shqyrtuar potencialin e ujërave nëntokësore, qarkullimin e tyre dhe mbi të gjitha, furnizimin me ujë ose vlerësimin e marrjes së ujit në vende të caktuara, të gjitha masat shkëmbore janë të ndara në bazë të kritereve të mëposhtme:
Përbërjes litologjike; Shkallës së shkatërrimit mekanik dhe Tipit të porozitetit, ujë përshkueshmërisë dhe koeficienti të filtrimit.
Sipas llojit të porozitetit, të gjitha masat shkëmbore në komunën e Klinës klasifikohen në akuifere me porozitet intergranular me permeabilitet mestar deri në të lartë dhe nga mestar deri në të ulët.
Sipas llojit të porozitetit ndahen në katër grupe të përshkueshmërisë së ujit

- Akuifere me porozitet intergranular me permeabilitet mestar deri në të lartë,
- Akuifere me porozitet intergranular me permeabilitet mestar deri në të ulët,
- Zona pa porozitet të theksuar të çarjeve dhe intergranular,
- Akufere me porozitet të çarjeve dhe karstik me ndryshme të mëdha, vende lokale shumë të lartë, permeabilitet i thyerjeve

**Tabelë 4**. Sipërfaqja në km2 sipas tipit të akuiferit dhe pjesëmarrja në %

| Tipi i akuiferit | Sipërfaqja km² | Përqindja (%) |
|---|---|---|
| Akuifere me porozitet intergranular me permeabilitet mestar deri në të lartë, | 61.96 | 21.01 |
| Akuifere me porozitet intergranular me permeabilitet mestar deri në të ulët, | 153.63 | 49.83 |
| Zona pa porozitet të theksuar të çarjeve dhe intergranular | 36.09 | 11.66 |
| Akufere me porozitet të çarjeve dhe karstik me ndryshme të mëdha, vende lokale shumë të lartë, permabilitet i thyerjeve. | 50.96 | 17.45 |

Nga harta dhe tabela mund të kuptohet që në territorin e komunës së Klinës dominojnë terrenet me porozitet mestar deri në të ulët me 49.83% , duke u pasuar nga ato që kanë porozitet mestar deri në të lartë me 21.01% të territorit të komunës së Klinës. Akuiferet që konsiderohen ujëmbajtëse kryesisht ndërtohen nga rëra dhe zhavori, dhe janë të pozicionuara në pjesën afër rrjedhave lumore (Drini Bardhë, Lumbardhi i Pejës). Këto akuifere janë të rëndësishme për furnizim me ujë të pijshëm dhe kërkesa të tjera. Në të njëjtën kohë edhe akuiferet me porozitet mesatar deri në të ulët janë të pozicionuara në pjesën perëndimore dhe verilindore. Këto akuifere në përgjithësi janë në risk nga ndota që mund të vijë nga ujërat sipërfaqësor dhe reshjet. Monitorimi dhe njohja e shkallës së ndotjes së këtyre ujërave është me interes të veçantë për institucionet në komunën e Klinës me qëllim të ndërmarrjes së masave për parandalimin e përkeqësimit, mbrojtjes dhe ruajtjes së cilësisë së ujërave në to.




**Harta 10.** Hidrogjeologjia e komunës

## *2.1.3.6. Biodiversiteti*

Komuna e Klinës është e pasur me lloje të ndryshme të pasurive natyrore botanike, hidrologjike, gjeomorfologjike e peizazhore. Në vitin 2008 nga Instituti i Mbrojtjes së Natyrës janë evidentuar në komunën e Klinës 7 monumente të natyrës dhe 1 park regjional. Prej monumenteve të natyrës që janë evidentuar nga Insituti i Mbrojtjes së Natyrës janë: Rrjedha e lumit Mirusha, e evidentuar më 1983 dhe i takon kategorisë së 3-të si monument natyror me rëndësi hidrologjike, gjeomorfologjike e pejsazhore; Burimi i ujit mineral në Dresnik i evidentuar më 1985 dhe i takon kategorisë së 3-të dhe është monument me karakter hidrologjik; Trungu i qarrit në Potërç (1985) është monument me karakter botanik dhe turistik, pastaj trungu i vidhit në Çabiç (1985), Trungu i qarrit në Bërkovë (1985), të gjitha këto janë monumente me karakter botanik të kategorisë së 3-të. Në Komunën e Klinës dallohen grupe të ndryshme të ekosistemeve si: agroekosisteme, pyje, shkurre, livadhe-kullosa, lumenj, etj. Komuna e Klinës ka 12.734 ha tokë bujqësore (agroekosisteme), 12.735 ha pyje me, 2.184 ha livadhe dhe 2.043 ha kullosa.[2] Pyjet – një pjesë mjaft e madhe e komunës së klinës është e mbuluar me pyje, të cilat përfaqësohen nga lloje të ndryshme të dushkut, përkatësisht nga bashkësia pyjore e shpardhit dhe qarrit (Quercetum frainetto-

[2] VSM, 2019. Raporti i Vlersimit Strategik Mjedisor për Hartën Zonale të Klinës. Instituri për Shkencë fhe Teknologji – INSI SHPK

cerris scardicum) dhe më rrallë edhe nga bashkësia pyjore e bungë-buti me qarr (Quercetum pubescentis-cerris). Këto janë bashkësi klimatogjene që shtrihen në lartësi mbidetare prej 400 deri 750 m në tërë territorin e Kosovës. Këto pyje dominohen nga llojet si: shpardhi (Quercus farnetto), qarri (Quercus cerris), bungë-buti (Quercus pubescent) dhe në vartësi nga lartësia mbidetare, baza gjeologjike, ekspozicioni, etj., këtyre iu bashkëngjitën edhe bungbuta (Quercus pubescens), frashëri i bardhë (Fraxinus ornus), mollëviçja (Sorbus torminalis), kreka (Acer campestre), molla florentinë (Malus florentiana), bungu (Quercus petrea), shkozë (Carpinus sp.), etj.. Pos pyjeve të larta dhe atyre të ulëta në Komunën e Klinës gjenden edhe shkurre të ndryshme, përkatësisht bashkësia bimore e dëllinjës (Astero-Juniperetum oxycedri), të dominuar nga dëllinja (Juniperetum oxycedri). Në zonat rreth lumenjve po ashtu zhvillohet vegjetacioni i drunjve të lartë dhe shkurreve, përkatësisht bashkësive bimore të shelgut të bardhë (Salicetum albae fragilis), shelgut të kuq (Salicetum purpurea), verrit të zi (Alnetum glutinosae). Këto bashkësi dominohen nga llojet e shelgut të bardhë (Salix albae), verrit të zi (Alnus glutinosae), plepit (Populus ps.), shelgut të kuq (Salix purpurea). Këto bashkësi bimore janë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të aktorit antropogjen.[3]

**Tokat pyjore** në Komunën e Klinës zënë 26.68% të sipërfaqes së komunës dhe janë të klasifikuara si: pyje gjetherënëse (22.95%) dhe zonat tranzitore nga pyjet në shkurre (3.73) Livadhe-kullosa – pos ekosistemeve drunore, Komuna e Klinës është e pasur edhe me ekosisteme barishtore. Këto ekosistem, janë të dominuar nga bimët barishtore, e më rrallë e pranishme bimët shkurrore apo edhe drunore. Në pikëpamje biologjike paraqesin ekosistem me vlera të larta të biodiversiteti. Sipërfaqet barishtore mbulojnë vetëm 1.63% të territorit të komunës dhe klasifikohen si: livadhe natyrore (0.07%), zona me vegjetacion të rrallë (0.49%) dhe kullosa (1.07%) Agroekosistemet – Zënë pjesën më të madhe të sipërfaqes së Komunës së Klinës. Kjo sipërfaqe kryesisht përdoret për kultivimin e produkteve të ndryshme bujqësore (drithërave, bishtajorëve por edhe të pemëve dhe perimeve). Agroekosistemet zënë 71.42% të territorit të kësaj komune dhe klasifikohen si: zona komplekse të kultivuara (60.4%), zona bujqësore me vegjetacion natyrorë (5.96%), toka bujqësore pa 50talan ujitje (4.86%), plantacione të frutave dhe qershizave (0.2%). Këto dhe tokat zakonisht shfrytëzohen për prodhim bujqësor dhe zhvillimin e blegtorisë.

**Llojllojshmëria e bimëve (Flora)-** Komuna e Klinës ka një florë të pasur, e cila është karakteristikë edhe për zonat tjera të Kosovës të cilat shtrihen në lartësi mbidetare të ngjashme me atë të komunës së Klinës. Disa nga llojet më të shpeshta janë të listuar më poshtë: Acer campestre, Acer tataricum, Allium carinatum, Anthyllis vulneraria, Anthyllis vulneraria, Calepina irregularis, Carpinus betulus, Cerinthe minor, Convolvulus arvensis, Coronilla varia, Corylus avellana, Cytisus nigricans, Dactylis glomerata, Euphorbia amygdaloides, Euphorbia cyparissias, Euphrasia stricta, Festuca heterophylla, Fragaria vesca, Galium verum, Helianthemum nummularium, Helleborus odorus, Hieracium murorum, Hypericum perforatum, Inula oculus-christi, Juniperus communis, Juniperus oxycedrus, Lathyrus niger, Lathyrus pratensis, Lathyrus venetus, Lithospermum purpureo-coeruleum, Lolium perenne, Lonicera caprifolium, Malus 50talanta50e, Malus silvestris, Medicago falcata, Melica uniflora, Mentha longifolia, Muscari botryoides, Narcissus poeticus, Onobrychis arenaria, Onobrychis arenaria, Orlaya grandiflora, Papaver rhoeas,, Plantago lanceolata, Plantago major, Plantago media, Platanthera bifolia, Quercus cerris, Potentilla argentea,, Prunella laciniata, shpardhi (Quercus farnetto), qarri (Quercus cerris), bungë-buti (Quercus

[3] Rexhepi F. (1994): Vegjetacioni i Kosovës. UP-FSHN. Prishtinë

pubescent) dhe (Quercus petrea), Quercus farnetto, Quercus petraea, Rosa canina, Rumex crispus, Salvia sclarea, Sedum maximum, Senecio vulgaris, Silene viridiflora, Stachys officinalis, Stachys scardica, Stellaria holostea, Tanacetum vulgare, Teucrium chamaedrys, Trifolium angustifolium, Trifolium medium, Trifolium montanum, Trifolium 51talant, Thymus sp., Ulmus minor, Urtica dioica, Verbascum sp., Veronica chamaedrys, Vicia sativa [4]

Në mesin e bimëve të pranishme në Komunën e Klinës janë edhe bimët mjekësore dhe aromatike të cilat paraqesin një 51talanta51e veçantë në aspektin ekonomik. Llojet më të rëndësishme të këtyre bimëve janë: Achillea millefolium, Bellis perennis, Centaurium erythrea, Cichorium intibus, Cornus mas, Corylus avellana, Crataegus monogyna, Digitalis lanata, Equisetum arvense, Fragaria vesca, Fraxinus ornus, Galium verum, Hypericum perforatum, Juniperus communis, Juniperus oxycedrus, Malus sylvestris, Malva sylvestris, Mentha longifolia, Origanum vulgare, Primula sp. Prunus spinose, Robinia pseudoacacia, Rosa canina, Salix alba, Sambucus nigra, Taraxacum officinale, Teucrium chamaedrys, Thymus sp., Tilia cordata, Tussilago farfara, Urtica dioica, etj. Disa lloje bimore në Komunën e Klinës, ose në kufi të kësaj komune me komunat tjera (zona e Mirushës) janë llojet endemike të Ballkanit, si p.sh.: boshtra evropiane (Forsythia europaea), bari I zgjebes (Scabisa fumaroides), moltkia Dorflerit (Moltkia doerfler), asteri Shqiptar (Aster albanicus), 51talanta e Dorflerit (Polygala doerfleri), gjineshtra e Hasertit (Genista hassertiana), halaçia e Sendtnerit (Halascya sendtneri), dioskorea e Ballkanit (Dioscorea balcanica), skutelaria lindore (Scutellaria orientalis), rrushqyqja e serpentine (Sedum 51talanta51e), pendëkaposhi I Majorit (Stipa mayeri), veronica e Andrasovskit (Veronica andrasovskyi, Malus 51talanta51e, Moltkia doerfleri) (IPH 2012). Me qëllim të mbrojtjes së këtyre llojeve zona e Mirushës është shpallur 51tal e mbrojtur "Monumenti I Natyrës me rëndësi të veçantë" [5].

**Llojet tjera:** alfacariensis, Colias crocea, Gonepteryx rhamni, Leptidea sinapis/juvernica, Leptidea duponcheli, Euchloe ausonia, Pieris brassicae, Pieris ergane, Pieris napi, Pieris mannii, Pieris rapae, Pontia edusa, Aricia agestis, Callophrys rubi, Celastrina argiolus, Cupido argiades, Cupido 51talanta51e, Cupido minimus, Glaucopsyche alexis, Lampides boeticus, Lycaena alciphron, Lycaena dispar, Lycaena phlaeas, Lycaena tityrus, Lycaena thersamon, Plebejus argus, Plebejus argyrognomon, Polyommatus amandus, Polyommatus bellargus, Polyommatus coridon, Polyommatus daphnis, Polyommatus Icarus, Scolitantides orion, Aglais io, Aglais urticae, Apatura ilia, Araschnia levana, Arethusana 51talanta, Argynnis aglaja, Argynnis 51tala, Argynnis pandora, Argynnis paphia, Boloria dia, Boloria euphrosyn, Brenthis daphne, Brenthis 51talan, Brintesia circe, Chazara briseis, Coenonympha pamphilus, Hipparchia fagi/syriaca, Hipparchia statilinus, Hipparchia volgensis, Hyponephele lupina, Issoria lathonia, Kirinia roxelana, Lasiommata megera, Limenitis reducta, Maniola jurtina, Melanargia galathea, Melitaea athalia, Melitaea aureli, Melitaea cinxia, Melitaea didyma, Melitaea phoebe, Melitaea trivia, Polygonia c – album, Pyronia 51talanta, Vanessa 51talanta, Vanessa cardui.[6]

[4] Hundozi B. 1977/1978. Mbi disa lloje bimore te flores se Kosoves. (O nekim biljnim vrstama floreKosova); Zbornik PMF u Pristini, 5: 117-122,
[5] IPH (Instituti për Planifikim Hapësinor). Plani Hapësinor - Monumenti i Natyrës me rëndësi të veçantë "Ujëvarat e Mirushës" Prishtinë, 2012.
[6] Zhushi-Etemi F, Bytyqi P, Musliu M, Ceka R. 2018. Distribution of Butterfly Species (Lepidoptera: Papilionoidea) in the Protected Area "Mirusha Ëaterfalls" nn Kosovo. Nat. Croat. Vol. 27(2), 2018. Doi 10.20302/Nc.2018.27.19

### 2.1.3.7. Herpetofauna

Llojllojshmëria e ekosistemeve dhe bimëve, ofrojnë kushte të pasura për shumë prej llojeve shtazore. Në Komunën e Klinës jetojnë lloje të ndryshme të insekteve si: Ephemeroptera: Baetis rhodani, Baetis alpinus, Baetis buceratus, Ecdyonurus cf. epeorides, Ecdyonurus starmachi, Ecdyonurus venosus, Ecdyonurus submontanus, Serratella ignita (Xërxa et al. 2019); Trichoptera: Adicella syriaca, Agapetus, Anabolia furcate, laniger, Athrips oses cinereus, Cheumatopsyche lepida, Cyrnus trimaculatus, Goera pilosa, Hydropsyche angustipennis, Hydropsyche bulbifera, Hydropsyche incognita, Hydropsyche saxonica, Hydropsyche sp., Leptocerus interruptus, Mystacides azureus, Mystacides niger, Notidobia ciliaris, Polycentropus irroratus, Psychomyia pusilla, Rhyacophila fasciata, Silo graellsi, Silo piceus, Tin oses pallidulus, Ëormaldia subnigra (Ibrahim et al. 2014); Lepidoptera (Fluturat): Carcharodus alceae, Carcharodus floccifera, Ochl oses Sylvanus, Pyrgus armoricanus, Pyrgus malvae, Pyrgus sidae, Spialia orbifer, Iphiclides podalirius, Papilio machaon, Parnassius mnemosyne, Zerynthia polyxena, Anthocharis cardamine, Aporia crataegi, Colias alfacariensis, Colias crocea, Gonepteryx rhamni, Leptidea sinapis/juvernica, Leptidea duponcheli, Euchloe ausonia, Pieris brassicae, Pieris ergane, Pieris napi, Pieris mannii, Pieris rapae, Pontia edusa, Aricia agestis, Callophrys rubi, Celastrina argiolus, Cupido argiades, Cupido decolorata, Cupido minimus, Glaucopsyche alexis, Lampides boeticus, Lycaena alciphron, Lycaena dispar, Lycaena phlaeas, Lycaena tityrus, Lycaena thersamon, Plebejus argus, Plebejus argyrognomon, Polyommatus amandus, Polyommatus bellargus, Polyommatus coridon, Polyommatus daphnis, Polyommatus Icarus, Scolitantides orion, Aglais io, Aglais urticae, Apatura ilia, Araschnia levana, Arethusana arethusa, Argynnis aglaja, Argynnis niobe, Argynnis pandora, Argynnis paphia, Boloria dia, Boloria euphrosyn, Brenthis daphne, Brenthis hecate, Brintesia circe, Chazara briseis, Coenonympha pamphilus, Hipparchia fagi/syriaca, Hipparchia statilinus, Hipparchia volgensis, Hyponephele lupina, Issoria lathonia, Kirinia roxelana, Lasiommata megera, Limenitis reducta, Maniola jurtina, Melanargia galathea, Melitaea athalia, Melitaea aureli, Melitaea cinxia, Melitaea didyma, Melitaea phoebe, Melitaea trivia, Polygonia c – album, Pyronia tithonus, Vanessa atalanta, Vanessa cardui.[7]
Përpos insekteve, në këtë komunë të pranishme janë edhe lloje të ndryshme të shtazëve kurrizor siç janë lloje të ndryshëm të peshqve: Alburnoides ohridanus, Alburnus scoranza, Barbatula sturanyi, Barbus sp, Chondrostoma ohridanus, Cobitis ohridana, Eudontomyzon stankokaramani, Gobio skadarensis/ohridanus, Oncorhynchus mykiss, Pachychilon pictum, Pachychilon pictum, Perca fluviatilis, Phoxinus sp., Pseudorasbora parva, Rhoseus amarus, Sabanejeëia balcanica, Salmo farioides, Squalius platyceps. [8]
Ujë-tokësorët- përkatësisht bretkosat - zvarranikët si: breshka (Testudo europeus), gjarpërinjtë të ndryshëm si: bolla (Ellafe longissima), gjarpri i ujit (Natrix natrix), gjarpri i gurit (Vipera ammodytes); hardhucat si p.sh. Lacerta muralis dhe Lacerta visridis (IPH, 2012). Shpendët më të përhapur në këtë zonë janë: qukapiku, harabeli, bilbili, thëllëza, pëllumbi, kumria, skifteri, gjeraqina, shkurtëza, qyqja etj. Përpos llojeve të sipërpërmendura në Komunën e Klinës janë të pranishme edhe gjitarët të ndryshëm si: derri i egër (Sus scofa), vjedulla 18 23 (Meles meles), lepuri (Lupus europeus), ketri (Scirius Vulgaris), ujku (Canis lupus), macja e egër (Felis sylvestris),

[7] Zhushi-Etemi F, Bytyqi P, Musliu M, Ceka R. 2018. Distribution of Butterfly Species (Lepidoptera: Papilionoidea) in the Protected Area "Mirusha Ëaterfalls" nn Kosovo. Nat. Croat. Vol. 27(2), 2018. Doi 10.20302/Nc.2018.27.19
[8] Grapci-Kotori L, Vavalidis T, Zogaris D, Šanda R, Vukić J, Geci D, Ibrahimi H, Bilalli A, Zogaris S. 2020. Fish distribution patterns in the Ëhite Drin (Drini i Bardhë) river, Kosovo. *Knoël. Manag. Aquat. Ecosyst.*, 421, 29.

sqarthi (Martes martës) iriqi (Erinaceus europaeus), etj. [9] Fauna është e rrezikuar nga gjuetia ilegale dhe e pa kontrolluar si dhe nga prerja e pyjeve me ç'rast vije deri te dëmtimi i ekosistemeve te tyre nga ana e faktorit njeri. Marrja ne mbrojtje e zonave natyrore qe shquhen me biodiversitet të faunës se egër do të ishte një ndër hapat e rëndësishëm që do të ndihmonte në mbrojtjen dhe ruajtjen e tyre.




**Harta 11.** Biodiversiteti në komunën e Klinës

[9] IPH (Instituti për Planifikim Hapësinor). Plani Hapësinor - Monumenti i Natyrës me rëndësi të veçantë "Ujëvarat e Mirushës" Prishtinë, 2012.

## 2.2. DEMOGRAFIA

### 2.2.1. Zhvillimi Demografik

Të dhënat për popullsinë e komunës së Klinës janë marr nga regjistrimet e popullsisë për vitet 1948 deri 2024. Sipas regjistrimit të vitit 2024, në këtë komunë jetojnë 30,503 banorë.

**Tabelë 5**. Të dhënat për popullsinë dhe ekonomitë familjare për periudhën 1948 – 2024

| Viti | Popullsia | | Ekonomitë Familjare (EF) | | Madhësia e familjes (numri i anëtareve në ekonomitë familjare) | | Pjesëmarrja e qytetit në komunë (%) | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Komuna | Qyteti | Komuna | Qyteti | Komuna | Qyteti | Ekonomitë familjare | Popullsia |
| 1948 | 20,665 | 630 | 2,980 | 112 | 6.9 | 5.6 | 3.7 | 3 |
| 1953 | 22,592 | 699 | 3,135 | 120 | 7.2 | 5.8 | 3.8 | 3.1 |
| 1961 | 27,153 | 1,092 | 3,770 | 230 | 7.2 | 4.7 | 6.1 | 4 |
| 1971 | 33,312 | 1,929 | 4,177 | 344 | 7.9 | 5.6 | 8.2 | 5.8 |
| 1981 | 42,813 | 4,512 | 4,931 | 713 | 8.6 | 6.3 | 14.4 | 10.5 |
| 1991 | 52,266 | 8,050 | 6,413 | 1,376 | 8.1 | 5.8 | 21.4 | 15.4 |
| 2011 | 38,496 | 5,542 | 5,843 | 1,010 | 6.5 | 5.4 | 17.3 | 14.4 |
| 2024 | 30,503 | / | 6,753 | / | 4.5 | / | / | / |

Sipas të dhënave, komuna e Klinës ka pasur rritje të numrit të popullsisë dhe ekonomive familjare nga viti 1948 deri në vitin 1991. Në vitin 1948 kishte 20,665 banorë dhe 2,980 ekonomi familjare. Ndërsa në vitin 1991 kishte 52,266 banorë dhe 6,413 ekonomi familjare. Gjatë kësaj periudhe 43 vjeçare popullsia e komunës së Klinës është rritur për 31,601 banorë dhe 3,433 ekonomi familjare. Pas vitit 1991 kemi një rënie të vazhdueshme të popullsisë. Në regjistrimin e vitit 2011 kemi 38,496 banorë dhe 5,843 ekonomi familjare, ndërsa në regjistrimin e fundit të vitit 2024 janë gjithsej 30,503 banorë dhe 6,753 ekonomi familjare. Numri i ekonomive familjare nuk ka shënuar rënie përkundër zvogëlimit të numrit të popullsisë për faktin se është zvogëluar madhësia mesatare e familjes. Madhësia mesatare e familjes në këtë komunë në vitin 2024 është 4.5 banorë.

**Lëvizjet natyrore të popullsisë** – Të dhënat e shtimit natyror janë analizuar nga statistikat e lindjeve dhe vdekjeve në Kosovë për vitin 2022. Gjatë vitit 2022 në komunën e Klinës janë shënuar 469 lindje dhe 236 vdekje. Bazuar në këto të dhëna është llogaritur shkalla e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror në promilë dhe në përqindje. Shkalla e natalitetit në komunën e Klinës ka shënuar rënie të konsiderueshme në krahasim me periudhat e më hershme kohore dhe sot është 15.3 promil apo 1.5 %. Shkalla e mortalitetit është 7.7 promil apo 0.7 %. Në bazë të këtyre shkalleve të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë në komunë është 7.6 promilë apo 0.7 %.




**Grafiku 2.** Nataliteti, mortaliteti dhe shtimi natyror në promila për komunën e Klinës në vitin 2022




**Grafiku 3.** Shtimi natyror në promila për komunën e Klinës sipas viteve

Shtimi natyror në komunën e Klinës gjatë dekadës së fundit kishte oscilime mjaft të theksuara sipas viteve. Në vitin 2016 ishte më i lartë, ndërsa më pas kishte një rënie të vazhdueshme.

### 2.2.2. Strukturat e popullsisë

Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë

Gjatë analizës së të dhënave demografike për vitin 2024 vërehen ndryshime në strukturën e popullsisë. Këto ndryshime mund ti dallojmë më çart përmes piramidës së popullsisë. Në vitin 2024, baza e piramidës është më e ngushtuar dhe kjo si pasojë dy faktorëve: migrimeve dhe tendencave të zvogëlimit të natalitetit.

Nga piramida e popullsisë vërehet se grup-moshat e reja 0 deri 4 vjeç kanë pjesëmarrje më të vogël në popullsinë e përgjithshme në krahasim me grup-moshën 5 deri 9 vjeç, 10 deri 14 vjeç, 15-19 dhe 20-24 vjeç.




**Grafiku 4.** Piramida e popullsisë – Klinë, 2024




**Grafiku 5.** Piramida e popullsisë – Klinë, 2011

Në përgjithësi grup-moshat e reja të popullsisë (0 deri 19 vjeç) dominojnë dukshëm në popullatën e përgjithshme të komunës, dhe kjo është një indikator mjaft i rëndësishëm që tregon se në të ardhmen do të ketë natalitet të lartë, nga fakti se këto grup-mosha në të ardhmen japin një përqindje të konsiderueshme të popullsisë fertile që konsiderohet si burim i lindshmërisë.




**Grafiku 6.** Tri grup-moshat e popullsisë së komunës së Klinës në %

Rreth 30 % e popullsisë së përgjithshme në Komunë janë me moshë të re (0 deri 19 vjeç), ndërsa grup-moshat mbi 65 vjeç kanë pjesëmarrje me 11.9 %. Nëse këto tri struktura i krahasojmë me vitin 2011, vërejmë ndryshime të theksuara sidomos te grup moshat e reja dhe ato mbi 65 vjeç.

Të dhënat për strukturën gjinore janë marr nga regjistrimi i fundit i popullsisë në vitin 2024 dhe këto të dhëna tregojnë për një balansim gjinor. Ka një dominim shumë të vogël të gjinisë femërore me 15474 femra dhe 15029 meshkuj ku koeficienti i feminitetit është rreth 1,030, që do të thotë se mesatarisht ekzistojnë 1,030 femra për çdo 1,000 meshkuj.




**Graf. 7.** Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Klinës, 2024

Struktura e krijuar e moshës dhe gjinisë dhe ndryshimet e tyre gjatë kohës kanë krijuar efekte të reja socio-ekonomike dhe demografike. Këto dy struktura kanë ndikuar në krijimin e kontingjenteve të rëndësishme siç janë: Kontingjenti i punës, fertil, shkollor, i moshuar etj.

**Tabelë 6.** Kontingjentet më të rëndësishëm të strukturës së moshës dhe gjinisë në %, 2024

| **Kontingjentet e rëndësishëm** | **Përqindja** |
|---|---|
| Kontingjenti parashkollor dhe me shkollim të obligueshëm (0-14 vjet) | 22,2 % |
| Popullsia fertile femërore (15-49 vjet) | 24,5 % |
| Kontingjenti i punës (15-64/m dhe 15-59/f) | 63 % |
| Kontingjenti i moshuar (mbi 65 vjet) | 11,9 % |

Në mungesë të të dhënave në nivel të vendbanimeve nga regjistrimi i popullsisë i realizuar në vitin 2024, jemi shërbyer me të dhënat nga regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 dhe nga vlerësimet e ASK-së të vitit 2022. Të dhënat për nivelin komunal të popullsisë janë inkorporuar në këtë dokument pasi që ato janë publikuar nga ASK.

**Tabelë 7**. Popullsia sipas vendbanimeve dhe grup-moshës

| **Vendbanimi** | **0-4** | **5-9** | **10-14** | **15-19** | **20-24** | **25-29** | **30-34** | **35-39** | **40-44** | **45-49** | **50-54** | **55-59** | **60-64** | **65-69** | **70-74** | **75-79** | **80+** | **Gjithsej** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Bërkovë** | 11 | 29 | 26 | 27 | 21 | 9 | 9 | 19 | 15 | 17 | 13 | 12 | 7 | 12 | 10 | 7 | 2 | 246 |
| **Binxhë** | 14 | 16 | 15 | 14 | 7 | 15 | 6 | 10 | 5 | 4 | 4 | 2 | 0 | 3 | 2 | 0 | 0 | 117 |
| **Bokshiq** | 31 | 42 | 50 | 61 | 48 | 34 | 23 | 31 | 25 | 21 | 11 | 21 | 10 | 8 | 8 | 5 | 4 | 433 |
| **Budisalc** | 18 | 39 | 49 | 34 | 29 | 22 | 31 | 31 | 26 | 24 | 22 | 14 | 12 | 12 | 10 | 18 | 7 | 398 |
| **Caravik** | 141 | 138 | 145 | 140 | 125 | 88 | 94 | 67 | 73 | 45 | 44 | 34 | 36 | 25 | 26 | 9 | 11 | 1241 |
| **Çabiq** | 95 | 78 | 93 | 84 | 87 | 79 | 66 | 55 | 33 | 54 | 32 | 23 | 20 | 17 | 16 | 18 | 12 | 862 |
| **Deiq** | 35 | 38 | 35 | 39 | 31 | 23 | 28 | 28 | 25 | 20 | 16 | 12 | 14 | 13 | 7 | 9 | 3 | 376 |
| **Dobërdol** | 24 | 21 | 49 | 41 | 29 | 26 | 15 | 24 | 19 | 18 | 12 | 19 | 11 | 12 | 10 | 3 | 6 | 339 |
| **Dollc** | 31 | 29 | 31 | 28 | 21 | 23 | 18 | 21 | 13 | 13 | 7 | 12 | 6 | 10 | 8 | 2 | 3 | 276 |
| **Dollovë** | 36 | 45 | 48 | 42 | 47 | 36 | 32 | 26 | 30 | 24 | 20 | 18 | 12 | 13 | 8 | 3 | 4 | 444 |
| **Dranashiq** | 1 | 1 | 1 | 1 | 5 | 3 | 0 | 0 | 0 | 2 | 2 | 2 | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 21 |
| **Drenoc** | 47 | 45 | 44 | 52 | 37 | 32 | 36 | 28 | 27 | 15 | 19 | 10 | 21 | 6 | 11 | 6 | 4 | 440 |
| **Drsnik** | 145 | 153 | 176 | 187 | 153 | 154 | 122 | 130 | 96 | 101 | 89 | 76 | 57 | 57 | 32 | 25 | 17 | 1770 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Dugajevë** | 44 | 39 | 33 | 44 | 34 | 30 | 25 | 25 | 21 | 16 | 19 | 12 | 18 | 10 | 12 | 11 | 6 | 399 |
| **Dush** | 19 | 16 | 31 | 28 | 35 | 16 | 17 | 13 | 4 | 14 | 16 | 13 | 3 | 3 | 3 | 4 | 6 | 241 |
| **Dush i Vogël** | 14 | 17 | 15 | 20 | 20 | 15 | 13 | 18 | 13 | 11 | 8 | 10 | 9 | 4 | 5 | 1 | 3 | 196 |
| **Gllarevë** | 208 | 185 | 181 | 175 | 199 | 178 | 137 | 120 | 71 | 65 | 78 | 45 | 35 | 43 | 31 | 21 | 12 | 1784 |
| **Grabanicë** | 59 | 67 | 76 | 104 | 64 | 69 | 40 | 47 | 38 | 37 | 33 | 24 | 29 | 12 | 16 | 6 | 7 | 728 |
| **Grabc** | 19 | 20 | 25 | 21 | 23 | 19 | 17 | 13 | 5 | 8 | 9 | 7 | 11 | 5 | 4 | 0 | 0 | 206 |
| **Gremnik** | 103 | 99 | 128 | 145 | 124 | 80 | 77 | 71 | 81 | 54 | 42 | 34 | 26 | 25 | 22 | 9 | 11 | 1131 |
| **Gjurgjevik i Madh** | 49 | 50 | 40 | 58 | 42 | 42 | 37 | 31 | 32 | 17 | 15 | 9 | 9 | 9 | 3 | 2 | 4 | 449 |
| **Gjurgjevik i Vogël** | 57 | 56 | 80 | 76 | 84 | 68 | 49 | 47 | 36 | 32 | 42 | 45 | 23 | 17 | 17 | 8 | 8 | 745 |
| **Jagodë** | 18 | 13 | 16 | 29 | 22 | 11 | 8 | 10 | 15 | 13 | 16 | 11 | 2 | 1 | 5 | 1 | 6 | 197 |
| **Jashanicë** | 158 | 186 | 188 | 186 | 184 | 141 | 135 | 122 | 95 | 97 | 70 | 50 | 54 | 42 | 43 | 23 | 10 | 1784 |
| **Jelloc** | 5 | 7 | 3 | 0 | 2 | 1 | 3 | 0 | 2 | 1 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 1 | 27 |
| **Kërnicë** | 63 | 87 | 79 | 91 | 89 | 65 | 52 | 59 | 40 | 36 | 35 | 23 | 24 | 25 | 12 | 11 | 3 | 794 |
| **Klinafc** | 45 | 48 | 43 | 48 | 47 | 39 | 28 | 34 | 27 | 25 | 31 | 13 | 16 | 7 | 9 | 11 | 9 | 480 |
| **Klinë** | 428 | 475 | 580 | 602 | 528 | 460 | 362 | 390 | 327 | 297 | 267 | 252 | 188 | 138 | 106 | 72 | 70 | 5542 |
| **Kpuz** | 68 | 67 | 68 | 64 | 65 | 52 | 52 | 47 | 28 | 25 | 21 | 13 | 11 | 17 | 12 | 6 | 6 | 622 |
| **Krushevë e Madhe** | 42 | 42 | 62 | 72 | 44 | 37 | 37 | 40 | 43 | 39 | 30 | 10 | 12 | 27 | 20 | 15 | 13 | 585 |
| **Krushevë e Vogël** | 25 | 23 | 35 | 25 | 24 | 21 | 20 | 27 | 19 | 13 | 15 | 14 | 17 | 9 | 11 | 12 | 13 | 323 |
| **Leskoc** | 16 | 26 | 23 | 30 | 18 | 30 | 14 | 11 | 16 | 9 | 7 | 11 | 12 | 4 | 2 | 5 | 5 | 239 |
| **Nagllavë** | 7 | 9 | 5 | 3 | 8 | 8 | 7 | 1 | 2 | 1 | 3 | 3 | 4 | 4 | 0 | 1 | 1 | 67 |
| **Përqevë** | 119 | 111 | 127 | 119 | 107 | 88 | 70 | 46 | 44 | 42 | 30 | 39 | 25 | 13 | 12 | 7 | 6 | 1005 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pjetërq i Epërm** | 49 | 50 | 51 | 60 | 57 | 41 | 51 | 30 | 34 | 31 | 29 | 20 | 16 | 11 | 15 | 7 | 11 | 563 |
| **Pjetërq i Poshtëm** | 15 | 15 | 21 | 17 | 19 | 7 | 9 | 10 | 11 | 9 | 4 | 5 | 4 | 5 | 4 | 3 | 2 | 160 |
| **Pograxhë** | 31 | 37 | 42 | 37 | 41 | 28 | 31 | 27 | 16 | 18 | 16 | 12 | 8 | 5 | 10 | 5 | 2 | 366 |
| **Qeskovë** | 34 | 32 | 41 | 53 | 29 | 28 | 25 | 22 | 31 | 10 | 16 | 8 | 9 | 5 | 10 | 12 | 8 | 373 |
| **Qupevë** | 71 | 55 | 71 | 73 | 65 | 59 | 37 | 40 | 29 | 27 | 16 | 14 | 5 | 5 | 6 | 3 | 3 | 579 |
| **Raduloc** | 24 | 42 | 37 | 40 | 27 | 23 | 14 | 19 | 19 | 25 | 26 | 9 | 10 | 11 | 7 | 10 | 10 | 353 |
| **Ranoc** | 16 | 26 | 46 | 64 | 29 | 11 | 15 | 23 | 24 | 22 | 16 | 15 | 8 | 7 | 18 | 9 | 4 | 353 |
| **Resnik** | 24 | 35 | 41 | 51 | 45 | 37 | 31 | 22 | 21 | 31 | 15 | 12 | 12 | 6 | 11 | 3 | 2 | 399 |
| **Rixhevë** | 83 | 101 | 94 | 89 | 104 | 79 | 66 | 60 | 41 | 30 | 29 | 29 | 18 | 21 | 12 | 11 | 3 | 870 |
| **Rudicë** | 26 | 43 | 60 | 53 | 40 | 30 | 33 | 34 | 26 | 22 | 15 | 18 | 15 | 8 | 9 | 5 | 9 | 446 |
| **Sferkë** | 273 | 286 | 292 | 297 | 214 | 181 | 212 | 152 | 112 | 103 | 73 | 66 | 59 | 52 | 32 | 23 | 21 | 2448 |
| **Siqevë** | 130 | 143 | 144 | 142 | 127 | 118 | 83 | 96 | 70 | 65 | 63 | 39 | 30 | 27 | 20 | 22 | 19 | 1338 |
| **Stupë** | 12 | 16 | 14 | 22 | 17 | 13 | 20 | 15 | 15 | 8 | 5 | 10 | 1 | 3 | 6 | 2 | 0 | 179 |
| **Shtupel** | 56 | 60 | 88 | 89 | 83 | 68 | 65 | 42 | 42 | 33 | 37 | 27 | 23 | 21 | 14 | 15 | 8 | 771 |
| **Ujmir** | 45 | 56 | 60 | 58 | 48 | 50 | 39 | 42 | 28 | 22 | 26 | 15 | 20 | 8 | 7 | 15 | 5 | 544 |
| **Videjë** | 34 | 53 | 68 | 71 | 74 | 57 | 38 | 41 | 42 | 42 | 39 | 27 | 19 | 16 | 18 | 14 | 10 | 663 |
| **Volljak** | 104 | 113 | 109 | 86 | 98 | 84 | 74 | 52 | 44 | 29 | 30 | 27 | 26 | 25 | 15 | 9 | 4 | 929 |
| **Zabërgjë** | 70 | 60 | 89 | 79 | 79 | 71 | 56 | 47 | 38 | 22 | 29 | 24 | 20 | 14 | 9 | 7 | 14 | 728 |
| **Zajm** | 125 | 158 | 144 | 122 | 125 | 95 | 109 | 86 | 64 | 50 | 51 | 44 | 37 | 26 | 16 | 7 | 8 | 1267 |
| **Zllakuqan** | 48 | 62 | 61 | 72 | 64 | 50 | 37 | 41 | 32 | 44 | 41 | 20 | 23 | 21 | 18 | 15 | 11 | 660 |
| **KLINË** | 3465 | 3760 | 4173 | 4265 | 3788 | 3144 | 2725 | 2543 | 2085 | 1853 | 1654 | 1334 | 1100 | 900 | 751 | 528 | 428 | 38496 |

### 2.2.3. Struktura arsimore e popullsisë

Niveli i shkollimit të popullsisë është një faktor mjaft i rëndësishëm që ndikon në zhvillimin e shumë fushave socio-ekonomike. Është analizuar niveli i shkollimit te popullsia mbi 10 vjeç ku numri i përgjithshëm i tyre është 26,267 banorë.




**Grafiku 8.** Popullsia e moshës mbi 10 vjeç sipas nivelit të shkollimit, 2024

Sipas të dhënave nga grafiku vërehet se pjesa më e madhe e popullsisë së komunës së Klinës është me shkollim të mesëm të ulët dhe shkollim të mesëm të lartë. Me këto dy nivele të shkollimit janë gjithsej 17,038 banorë apo rreth 65 %. Vetëm me shkollim të mesëm të ulët janë 9,543 persona apo rreth 36%, ndërsa me shkollim të mesëm të lartë janë 7,495 persona apo rreth 28%. Është me rëndësi të theksohet se në këtë komunë kemi një numër të konsiderueshëm edhe të personave që janë të diplomuar dhe me diploma pasuniversitare. Numri i tyre është gjithsej 3205 apo mbi 12%.

### 2.2.4. Struktura etnike e popullsisë

Komuna e Klinës ka një popullsi homogjene në aspektin etnik ku dominon popullsia shqiptare me mbi 95%. Pakicat tjera përbëjn më pak se 5% të popullsisë si: Egjiptian 2.8%, serb 1% dhe etnitetet tjera me më pak se 1%.

**Tabelë 8.** Struktura etnike e popullsisë në komunën e Klinës, 2024

| | Gjithsej | Shqiptar | Serb | Boshnjak | Rom | Ashkali | Egjiptian | Të tjerë | Pa pergjigje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | 30503 | 29151 | 327 | 14 | 86 | 41 | 865 | 10 | 9 |
| % | 100 | 95.57 | 1.07 | 0.05 | 0.28 | 0.13 | 2.84 | 0.03 | 0.03 |

### 2.2.5. Struktura fetare e popullsisë

Në komunën e Klines dominon besimi islam me 81% dhe më pas ai katolik me mbi 16%.

| | Gjithsej | Islam | Ortodoks | Katolik | Të tjerë | Asnjë besim fetar | Nuk përgjigjet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | 30503 | 24716 | 328 | 5120 | 32 | 84 | 223 |
| **%** | 100 | 81.0 | 1.1 | 16.8 | 0.1 | 0.3 | 0.7 |

### 2.2.6. Lëvizja mekanike e popullsisë – Migrimet

Të kushtëzuar nga një varg faktorësh, komuna e Klinës ka një emigrim të shprehur si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Migrimet e jashtme në këtë komunë janë intensifikuar vazhdimisht që nga vitet e 70-ta dhe sot ekzistojnë rreth 43 % e popullsisë që jetojnë, punojnë dhe veprojnë jashtë shtetit. Sipas të dhënave nga ASK për migrimet në Kosovë, komuna e Klinës ka shkallën më të lartë të migrimit në nivel të Kosovës pas Suharekës. Edhe migrimi i brendshëm është mjaft i shprehur. Migrimet e brendshme kryesisht kanë të bëjnë me lëvizjet fshat qytet, ku më i theksuar është migrimi drejt qendrave më të mëdha urbane.

Agjencia e Statistikave të Kosovës, gjatë realizimit të regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 i kanë regjistruar edhe emigrantët. Sipas të dhënave që janë grumbulluar gjatë këtij regjistrimi del se 13,140 banorë të komunës së Klinës jetojnë jashtë Kosovës. Në vlerësimet e popullsisë nga ASK për periudhën 2011-2022 jepen të dhënat për migrimin në komunën e Klinës gjatë kësaj periudhe. Sipas këtyre të dhënave, për periudhën 11 vjeçare, nga kjo komunë kanë migruar 4,213 banorë. Sipas këtyre shënimeve, në vitin 2022 komuna e Klinës ka 17,353 banorë, apo rreth 43% të popullsisë që jetojnë jashtë vendit. Sipas vlerësimit nga ASK për vitin 2022, bilanci i përgjithshëm i migrimit në këtë komunë ishte – 592 banor apo -1.9%.




**Grafiku 5.** Numri i popullsisë dhe numri i emigranteve në komunën e Klinës

## 2.2.7. Dendësia e popullsisë

Dendësia e popullsisë në komunën e Klinës është rreth 99 banorë në 1 km², ku 30,503 banorë jetojnë në 308.8 km². Brenda territorit të komunës së Klinës ekzistojnë dallime të theksuara sa i përket dendësisë së popullsisë. Përderisa në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë dendësia është shumë më e lartë, në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë dendësia është shumë më e vogël.




Harta 12. Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve në komunën e Klinës

## 2.3. ZHVILLIMI EKONOMIK

Në aspektin ekonomik, në komunën e Klinës si dhe në gjithë Kosovën, nga viti 1970 e deri në vitin 1980 vërehet një ndryshim pak më i theksuar sa i përket zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, por nga viti 1980 e deri në fillimin e luftës së fundit prapë kishte një stagnim si pasojë e okupimit klasik nga pushteti okupues serb. Nga lufta u shkatërruan në tërësi dhe pësuan dëme shumë të mëdha të gjitha ndërmarrjet ekonomike ekzistuese dhe pothuajse të gjitha shtëpitë e banimit dhe ekonomitë e tyre familjare. Edhe infrastruktura fizike edhe pse e pa zhvilluar, pësoi dëme të konsiderueshme si pasojë e luftës. Të gjitha pushtet lokale, ashtu edhe sikur e gjithë shoqëria kosovare kishin barrën e rifillimit të jetës nga zero.

Zhvillimin ekonomik të Klinës duhet shikuar në kontekst më të gjerë dhe përtej kufijve komunal. Pozita e saj në raport me resurset dhe lidhjet me vijat e qarkullimit paraqesin një potencial për shndërrimin e Klinës në një nyje regjionale për zhvillimin e bujqësisë dhe veprimtarive përpunuese.[10] Territori i Komunës së Klinës shquhet për pasuri natyrore. Hapësira karakterizohet me pyje dhe tokë kualitative bujqësore, pasuri nëntokësore, trashëgimi të pasur natyrore dhe kulturore.

Ekonomia e Klinës është e bazuar kryesisht në veprimtarinë bujqësore dhe përpunim të prodhimeve bujqësore. Bujqësia si aktivitet ekonomik është e bazuar në kushtet e mira të tokës bujqësore, pasurisë me rrjedha ujore si dhe të reshurave të cilat në Klinë janë në sasi të volitshme. Në komunën e Klinës 87.7% e tokës është nën 600 m lartësi mbidetare, ndërsa 95% është tokë pjellore.[11] Përveç bujqësisë, Klina shquhet me resurse të pasura natyrore minerale dhe jominerale të tilla si: rezerva të linjitit (2 miliardë ton), xehes se boksitit (2 milionë ton), argjilës (6.5 milionë ton), rërës dhe zhavorrit (3.5 milionë ton) etj.

Sa i përket numrit të bizneseve aktive, aktualisht (viti 2023) në Komunën e Klinës janë 1,510 binzese aktive, me pjesën më të madhe të tyre (68 % e totalit) të vendosura në zonën urbane, ndërsa 32 % prej tyre të vendosura në zonat rurale të komunës. Sektori me numrin më të madh të bizneseve të regjistruara është sektori i Tregtisë me 23 % të totalit të bizneseve të regjistruara, i pasuar nga sektori i Akomodimit dhe shërbimit të ushqimeve me 17 % të totalit të bizneseve, si dhe nga sektori i Shërbimeve me 14 % të totalit të bizneseve të regjistruara në komunën e Klinës.

Numri total i të punësuarve të regjistruar në Komunën e Klinës është 3,808, e që i bie 2.5 punëtorë për biznes të regjistruar.

### 2.3.1. Klasifikimi i ndërmarrjeve të regjistruara sipas pronësisë

Sipas të dhënave të ARBK-së për vitin 2023, në Komunën e Klinës aktualisht operojnë 1,510 ndërmarrje biznesore aktive. Nga ky total i ndërmarrjeve aktive 1,500 (apo 99.4) ndërmarrje janë në pronësi private, 5 ndërmarrje (0.3 %) janë në pronësi komunale si dhe 5 ndërmarrje janë në pronësi publike.

Sa i përket numrit të punësuarve, ndërmarrjet private në komunën e Klinës punësojnë 13,568 punëtorë, apo 89.4 % të totalit të punëtorëve në komunë (16,663), ndërmarrjet Publike-Komunale punësojnë 1,415 punëtorë, apo 8 % të totalit të punëtorëve në komunë. Ndërsa ndërmarrjet Publike-Shoqërore punësojnë vetëm 265 punëtorë, apo 1.6 %, të totalit të punëtorëve në komunën e Klinës.

[10] Plani zhvillimor i komunës së Klinës, 2012, fq. 9.
[11] Plani zhvillimor i komunës së Klinës, 2012, fq. 29.

**Tabelë 7**. Klasifikimi i ndërmarrjeve të regjistruara sipas pronësisë

| Nr | Pronësia | Nr. i Ndermarrjeve | % e Totalit të Ndërmarrjeve | Nr. i të punesuarve | % e Totalit të të |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Private | 1500 | 99.4 | 13,568 | 89.4 |
| 2 | Publike- Komunale | 5 | 0.3 | 1,415 | 8 |
| 3 | Publike- Shoqerore | 5 | 0.3 | 265 | 1.6 |
| 4 | Publiko(Komunale)- | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Publiko (Shoqerore)- | 0 | 0 | 0 | 0 |
| TOTALI | | 1510 | 100 | 16,663 | 100 |

*Klasifikimi i Sektorëve Ekonomik sipas numrit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe numrit të të punësuarve*

Sipas të thënave të ATK-së për vitin 2023, në Komunën e Klinës nga gjithsej 1,510 biznese aktive, sektori me pjesëmarrjen më të madhe të bizneseve është sektori i Tregtisë me Shumicë dhe Pakicë. Në këtë sektor operojnë gjithsej 343 biznese, apo 23 % e numrit total të bizneseve aktive në vitin 2023. Në këtë sektor punojnë 5,733 punëtorë, apo 34.4 % e numrit total të të punësuarve në komunën e Klinës.
Sektori i dytë me numrin më të madh të bizneseve është sektori i Akomodimit dhe Aktiviteteve të Shërbimit të Ushqimit me 262 biznese aktive, apo 17 % të të gjitha bizneseve aktive në vitin 2023. Në këtë sektor punojnë 1,184 punëtorë, apo 7.1 % e numrit total të të punësuarve në komunën e Klinës.
Ky sektor përcjellet nga sektori i Aktiviteteve Shërbyese me 212 biznese, apo 14 % të të gjitha binzeseve aktive. Në këtë sektor punojnë 853 punëtorë, apo 5.1 % e numrit total të të punësuarve në komunën e Klinës
Në tabelën e më poshtme janë pasqyruar të gjithë sektorët ekonomikë bashkë me numrin e bizneseve aktive si dhe pjesëmarrjen e tyre (në %) në aktivitetin ekonomik të Komunës së Klinës, si dhe bashkë me numrin e punëtorëve të punësuar në sektorët përkatës.

**Tabelë 8**. Klasifikimi i sektorëve ekonomik sipas numrit të ndërmarrjeve dhe të punësuarve

| Nr. | Sektori | Nr Ndermarrjeve | % e Totalit të Ndërmarrjeve | Nr. i të punesuarve | % e Totalit të punësuarve |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësia, Pylltaria dhe Peshkimi | | | 468 | 2.8 |
| 2 | Xeheroret dhe gurëthyesit | 23 | 1.5 | 836 | 5.0 |
| 3 | Industria Perpunuese | 7 | 0.5 | 3,195 | 19.2 |
| 4 | Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim | 10 | 0.5 | 166 | 1.0 |
| 5 | Furnizimi me uje; | 5 | 0.5 | 43 | 0.2 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese | | | | |
| **6** | Aktivitete Sherbyese | 212 | 14 | 853 | 5.1 |
| **7** | Ndertimtaria | 110 | 7 | 2,200 | 13.2 |
| **8** | Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave | 343 | 23 | 5,733 | 34.4 |
| **9** | Transporti dhe Magazinimi | 104 | 7 | 255 | 1.5 |
| **10** | Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit | 262 | 17 | 1,184 | 7.1 |
| **11** | Tjera | 434 | 29 | 1,730 | 10.4 |
| **TOTALI** | | **1510** | **100** | **16,663** | **100** |

**Tabelë 9.** Renditja e venbanimeve (urbane dhe rurale) sipas numrit të bizneseve të regjistruara

| Nr. | Lloji i Vendbanimit | Nr i Ndermarrjeve | % e Totalit të Ndërmarrjeve |
|---|---|---|---|
| **1** | Vendbanimi A (Zona Urbane) | 1030 | 68.2 |
| **2** | Vendbanimi B (Zonat Periferike) | 480 | 31.8 |
| **TOTALI** | | 1050 | 100 |

*Shtrirja Gjeografike e Ndërmarrjeve Ekonomike në Komunën e Klinës*

Sipas të dhënave të ARBK-së për vitin 2023, shtrirja gjeografike e bizneseve në Komunën e Klinës konsiston me këtë gjendje: Në qytetin e Klinës (në zonën urbane) janë të vendosura 1,030 biznese, e që përbëjnë 68.2 të numrit total të binzeseve aktive në Komunën e Klinës (1,510). Pas zonës urbane, vendbanimi me numrin më të madh të bizneseve të regjistruara në komunën e Klinës është Gremniku, me 60 biznese aktive të regjisturara apo 4.0 % të të gjitha bizneseve aktive, i pasuar nga Zajmi me 41 biznese aktive të regjistruara (2.7 % e totalit), Zllkauqani me 28 binzese (1.9 % e totalit), Volljaka me 23 biznese (1.5 % e totalit) dhe Gllareva me 20 biznese aktive të regjistruara, apo 1.3 % të të gjitha bizneseve aktive të regjistruara në Komunën e Klinës.
Nga vendbanimet tjera, secili prej tyre ka më pakë se 20 biznese të regjistruara, ndërsa vendbanimi i vetëm me asnjë (0) biznes aktiv të regjistruar është vendbanimi Dugajevë.

**Tabelë 9**. Shpërndarja gjeografike e ndërmarrjeve të regjistruara në Komunën e Klinës

| Renditja | Vendbanimi | Numri i bizneseve te regj. | % e totalit të bizneseve të regjistruara |
|---|---|---|---|
| 1 | Klinë | 1030 | 68.2 |
| 2 | Berkovë | 2 | 0..1 |
| 3 | Binxhë | 1 | 0.1 |
| 4 | Bokshiq | 4 | 0.3 |
| 5 | Budisalc | 11 | 0.7 |
| 6 | Çabiq | 4 | 0.3 |
| 7 | Caravik | 13 | 0.9 |
| 8 | Deiq | 7 | 0.5 |
| 9 | Dobërdoll | 5 | 0.3 |
| 10 | Dollc | 11 | 0.7 |
| 11 | Dollovë | 10 | 0.7 |
| 12 | Dranashiq | 0 | 0 |
| 13 | Drenoc | 15 | 1.0 |
| 14 | Dresnik | 5 | 0.3 |
| 15 | Dugajevë | 0 | 0 |
| 16 | Dush | 1 | 0.1 |
| 17 | Dush i Vogël | 1 | 0.1 |
| 18 | Gjurevik i Vogël | 6 | 0.4 |
| 19 | Gjurevik i Madh | 8 | 0.5 |
| 20 | Gllarevë | 20 | 1.3 |
| 21 | Grabanicë | 12 | 0.8 |
| 22 | Grabc | 0 | 0 |
| 23 | Gremnik | 60 | 4.0 |
| 24 | Jagodë | 2 | 0.1 |
| 25 | Jashanicë | 17 | 1.1 |
| 26 | Jallovc | 4 | 0.3 |
| 27 | Kërrnicë | 4 | 0.3 |
| 28 | Klinafc | 13 | 0.9 |
| 29 | Kpuz | 11 | 0.7 |
| 30 | Krushevë e Madhe | 7 | 0.5 |
| 31 | Krushevë e Vogël | 5 | 0.3 |
| 32 | Leskoc | 6 | 0.4 |
| 33 | Nagllavë | 0 | 0 |
| 34 | Përqevë | 9 | 0.6 |
| 35 | Pjetërq i Poshtëm | 1 | 0.1 |
| 36 | Pjetërq i Epërm | 3 | 0.2 |
| 37 | Pograxhë | 12 | 0.8 |
| 38 | Qeskovë | 2 | 0.1 |
| 39 | Qupevë | 4 | 0.3 |
| 40 | Radulloc | 5 | 0.3 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 41 | Ranoc | 1 | 0.1 |
| 42 | Resnik | 12 | 0.8 |
| 43 | Rixhevë | 11 | 0.7 |
| 44 | Rudicë | 5 | 0.3 |
| 45 | Sferkë | 15 | 1.0 |
| 46 | Shtupel | 11 | 0.7 |
| 47 | Siqevë | 6 | 0.4 |
| 48 | Stupë | 1 | 0.1 |
| 49 | Ujmirë | 7 | 0.5 |
| 50 | Videjë | 10 | 0.7 |
| 51 | Volljakë | 23 | 1.5 |
| 52 | Zabërgjë | 5 | 0.3 |
| 53 | Zajm | 41 | 2.7 |
| 54 | Zllakuqan | 28 | 1.9 |




**Harta 13.** Shperndarja gjeografike e bizneseve në Komunën e Klinës

*Shërbimet*

Sa i përket sektorit të shërbimeve në komunën e Klinës, nga numri total i bizneseve aktive (1,510), 212 prej tyre (14 % e totalit) i takojnë sektorit të shërbimeve. Kur kësaj i shtohet edhe numri i binzeseve nga sektori i hotelerisë dhe akonomidimit (262, ose 17 % e totalit të bizneseve aktive), e që ndërlidhen me shërbimet, mund të thuhet se shërbimet në komunën e Klinës përbëjnë rreth 30 % të aktivitetit ekonomik të komunës. Rrjedhimisht, sektori ka rëndësi të madhe edhe për të tashmen, por edhe për të ardhmen e ekonomisë së Klinës.

### 2.3.2. Popullësia aktive, Punësimi dhe Papunësia

Nga totali i popullsisë së Klinës (27,098) 9,031 banorë, apo 33 % e totalit janë popullsi ekonomikisht aktive, ndërsa 18,067 banorë, apo 67 % e popullsisë totale janë popullsi ekonomikisht jo aktive.

Nga totali i popullsisë aktive 3,822 banorë, apo 42 % e popullsisë aktive janë duke punuar aktualisht. Ndërsa shkalla e punësimit në raport me totalin e popullsisë së Klinës është vetëm 14 %. Sa i përket dallimeve gjinore në mesin e popullsisë ekonomikisht aktive dhe asaj të punësuar kemi gjendjen si vijon: edhe pse dallimi gjinor në numrin total të popullsisë është dallim i pa përfillshëm (49.30 % e popullsisë janë meshkuj, ndërsa 50.7 % e popullsisë janë femra), dallimet gjinore në mesin e popullsisë aktive dhe asaj të punësuar janë shumë të mëdha, me një dominim absolut të gjinisë mashullore. Në këtë mënyrë, 75 % e popullsisë ekonomikisht aktive përbëhet nga meshkujt, ndërsa vetëm 25 % e saj nga femrat. Ndërsa kur jemi tek dallimet gjinore mes popullsisë së punësuar, 80 % e tyre janë meshkuj, ndërsa vetëm 20 % e popullsisë së punësuar në komunën e Klinës përbëhet nga femrat.

*Papunësia:* Bazuar në rezultatet nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011 del se shkalla e papunësisë në komunën e Klinës është më e lartë se mesatarja e Kosovës. Papunësia në këtë komunë është 57%. Popullsia e moshës mbi 15 vjeç në komunën e Klinës është 27,098 banorë apo rreth 70% e popullsisë totale. Nga ky numër, popullsi aktive janë 9,031 banorë apo rreth 33%. Numri i të papunëve në këtë komunë është 5,209 persona apo 57% e popullsisë aktive. Të punësuar janë 3,822 persona apo rreth 43% e popullsisë aktive.
Nëse analizohet shkalla e papunësisë sipas gjinisë në komunën e Klinës, mund të konstatojmë se papunësia është më e theksuar tek gjinia femërore.




**Grafiku 6.** Shkalla e punësimit dhe papunësisë sipas gjinisë në komunën e Klinës

Numri i të papunëve tek gjinia femërore është 1,501 persona apo 66%. Ndërsa tek gjinia mashkullore është 3,708 persona apo rreth 55%.

*Varfëria:* **Vendbanimet me shkallë të ulët të varfërisë nga 0 deri 3.5 %** janë vendbanimet nën devijimin standard dhe atë: Qeskovë (3.5%), Dobërdol (1.9%), Dugujevë (1.6%) dhe Gjurgjevik i Vogël (3.5%).

**Vendbanimet me shkallë të mesme të varfërisë nga 3.5 deri 29.2** - janë vendbanimet brenda shkallës së devijimit standard dhe atë: Berkovë (5.4%), Bokshiq (23%), Budisalc (13.3%), Çabië (13.8%), Caravik (14.8%), Beiq (7%), Dollovë (13.4%), Drenoc (6%), Dersnik (7.4%), Dush (19.4%), Gjurgjevik i Madh (27.9%), Gllarevë (17.4%), Grabanicë (15.4%), Grapc (16%), Gremnik (6.4%), Jagodë (26.6%), Jashanicë(14.4%), Kërnicë (6.6%), Klinë(15.9%), Kpuz (10.6%), Krushevëe Madhe (15.7%), Krushevë e Vogël (8%), Leskoc (25%), Pjeterq i Epërm (10.5%), Pjeterq i Ulët (4%), Përqevë (11.8%), Radulloc (5.6%), Ranoc (5.6%), Rixhevë (10.6%), Rudicë (3.8%), Shtupel (25.6%), Siçevë (12.8%), Stupë (11%), Sverkë (13.7%), Ujmirë (10.9%), Videjë (6%), Volljak (6.3%), Zabërxhë (14.5%), Zajm (14.5%), dhe Zllkuqan (12%).

Vendbanimet me shkallë të lartë të varfërisë mbi 29.2 % janë vendbanimet mbi shkallën e deviacionit standard si: Çupevë (29.5%), Dollc (29.3%), Jelloc (83%), Klinafc (53%) dhe Resnik (30%).




**Harta 14.** Shtrirja hapësinore e varfërisë në komunën e Klinës

### 2.3.3. Bujqësia

Pozita e volitshme gjeografike, toka pjellore, kushtet klimatike, resurset humane dhe natyrore si dhe relievi në rajonin e komunës së Klinës kanë krijuar kushte optimale për zhvillimin e bujqësisë. Nëpër territorin e Klinës kalojnë gjashtë lumenjë: Drini i Bardhë, Lumbardhi i Pejës, Klina, Mirusha, Lumi i Istogut dhe Lumbardhi i Deçanit. Prej tyre katër kanë rrjedhë fushore dhe me ndërtimin e pendave përgjatë rrjedhës së tyre do të mund të ujiteshin deri në 2,000 ha toka bujqësore. Me realizimin e projekteve për ndërtimin e kanaleve të ujitjes dhe pendave deri me tani ujiten rreth 1,200 ha tokë bujqësore.

Sipas të dhënave nga ASK-ja, komuna e Klinës disponon me 14,948 ha sipërfaqe me tokë bujqësore, ndërsa Klina hyn në zonën intensive për nga mundësitë e zhvillimit të bujqësisë, pasi që 87.7% e sipërfaqes është nën 600 metra të lartësisë mbidetare. Tokë bujqësore është 95%, vetëm 4.9% janë toka jopjellore.

Në strukturën e tokave bujqësore dominojnë arat me 12,734 ha, pyjet me 12,735 ha, livadhet me 2,184 ha, kullosat me 2,043 ha etj. Kulturat e drithërave zënë sipërfaqe totale prej 7,551 ha, ku kultura e grurit dominon me sipërfaqe prej 5,557 ha, pas saj vjen kultura e misrit me 1,767 ha. Elbi, thekra dhe tërshëra kultivohen më pak. Ndërsa, nga kulturat bishtajore dominon bizelja me sipërfaqe prej 130 ha, pas saj vjen fasulja me 76 ha. Kulturat e pemëve dhe perimeve shtrihen në sipërfaqe prej 72.8 ha. Prej tyre dominon kultura e specit me 29 ha, pastaj qepa me 9.5 ha, domatja me 8.5 ha, shalqiri me 8 ha, lakra me 5.7 ha, trangulli me 3.5 ha, hudhra me 3.3 ha etj. (ASK, 2014). Në komunën e Klinës ka vetëm 4.7 ha sipërfaqe me vreshta (ASK, 2014).

Sipas Regjiistrimit të Bujqësisë për vitin 2014, Komuna e Klinës kishte një potencial të fuqisë punëtore bujqësore prej 10,076 personave, ky potencial është shfrytëzuar deri në numrin 4,022 persona nga 1,016 ekonomi familjare (Regjistrimi i bujqësisë, 2014) me 1, 090 ferma (Drejtoria e Bujqësisë, 2023). Sa i pket nivelit të shkollimit; punonjës të angazhuar në bujqësi pa arsim fare janë 1,384 persona, me shkollë fillore të përfunduar janë 441 persona, me shkollë të mesme bujqësore 151, me shkolla tjera të mesme 527, kolegje 4 dhe shkollim të lartë 211 persona. Numri i personave që merret me bujqësi e që janë të pa shkolluar fare dhe/ose vetëm me shkollë fillore është i lartë (Regjistrimi i bujqësisë, 2014). Numri i personave që merreshin me bujqësi në vitin 2014 ishte 4,022, ndërsa sipas të dhënave të drejtorisë së bujqësisë- bazuar në aplikimet për subvencione në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillit Rural në vitin 2023- numri i atyre që aktualisht merren me bujqësi është vetëm 1,090.

Në komunën e Klinës sipërfaqja e tokës punuese për kokë banori llogaritet të jetë rreth 0.33 Ha. (Drejtoria e Bujqësisë, 2023). Sa i përket prodhimtarisë bujqësore, toka në mbjelljet vjeshtore mbillet kryesisht me grurë, përderisa në mbjelljet pranverore mbillet me misër dhe bimë foragjere për blegtori. Kulturat tjera të rëndësishme janë perimet, patatet, shalqiri etj. Shumica e prodhuesve janë ekonomi bujqësore familjare, dhe vetëm 1,090 prodhues janë të organizuar në ndërmarrje bujqësore.

Pas luftës është vërejtur dukuria e shpërndarjes së pa kontrolluar urbane, e cila e degradon tokën bujqësore. Ky fenomen Komunës së Klinës i ka kushtuar me humbjen e disa hektarë tokë bujqësore vetëm gjatë periudhës 2015-2020.

**Tabelë 10**. Sipërfaqe tokësore dhe me strukturë të kulturave bujqësore Klina

| Nr. | Lloji | Private | Shoqërore | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Ara | 9540.67.51 ha | 3263.61.34 ha | 12804.28.85 ha |
| 2. | Kopshte | 17.17.42 ha | 2.67.71 ha | 19.85.13 ha |
| 3. | Pemishte | 423.11.33 ha | 116.95.65 ha | 540.06.98 ha |
| 4. | Vreshta | 88.79.45 ha | 5.41.75 ha | 94.21.02 ha |
| 5. | Livadhe | 2075.44.09 ha | 146.39.98 ha | 2221.84.07 ha |
| 6. | Kullosa | 893.56.45 ha | 1193.40.85 ha | 2086.97.30 ha |
| 7. | Pyje | 5089.28.06 ha | 6477.84.04 ha | 11567.12.10 ha |
| 8. | Jopjellore | 363.27.63 ha | 1205.71.21 ha | 1568.98.84 ha |
| Gjithsej | | **18.491.31.94 ha** | **12.412.02.53 ha** | **30.903.34.29 ha** |

(Burimi:Drejtoria për Kadastër Klinë)

Gjatë periudhës së luftës dhe procesit të privatizimit që ka filluar pas luftës, shifrat e paraqitura me lartë kanë pësuar ndryshime rrënjësore veçanërisht në sektorin shoqëror, gjithashtu ka ndryshime edhe në kulturat bujqësore si p.sh: në vreshta të cilat tani më nuk ekzistojnë.

### *2.3.3.1. Prodhimtaria Bujqësore (Lavërtaria, Perimkultura dhe Pemëtaria)*

Territori i Komunës së Klinës ka një konfiguracion të përshtatshëm për zhvillimin e bujqësisë, përveç kësaj këtë regjion e përshkojnë 6 lumenjë të cilët krijojnë mundësi për ujitjen e sipërfaqeve të mëdha të tokave bujqësore. Komuna e Klinës është regjion kryesisht bujqësor ku rreth 70 % e popullsisë jeton në zonat rurale dhe merret me bujqësi.

Sipas të dhënave nga Drejtoria e Bujqësisë, në vitin 2023, nga e gjithë sipërfaqja e tokës bujqësore të planifikuar për mbjellje (9,979 ha) janë mbjellur gjithësej 8,426.5 ha, me grurin dhe misrin kokërr si kultura dominuese. Pas tyre, perimet dhe patatet janë mbjellur në sasi më të vogla. Kulturat bishtajore si bizelja dhe fasulja zënë sipërfaqe të konsiderueshme. Pemët dhe perimet mbulojnë 72.8 ha, ku dominojnë speci dhe qepa. Në komunën e Klinës, numri i traktorëve është problematik, me shumicën mbi 10 vjet vjetërsi.

Mungesa e përdorimit të mjeteve moderne rritë shpenzimet dhe ulë cilësinë e prodhimit. Investimet në infrastrukturën e ujitjes janë të nevojshme për të përmirësuar rendimentin dhe cilësinë. Projektet e kaluara si hapja e kanaleve për ujitje si dhe puseve për fermerët janë hapa pozitivë drejt përmirësimit të kushteve bujqësore në komunën e Klinës.

**Tabelë 11**. Sipërfaqja bujqësore e planifikuar për mbjellje për vitin 2023 dhe kulturat bujqësore

| Kultura | Sip. e planifikuar per mbjellje (Ha.) | % e sip. së planifikuar për mbjellje |
|---|---|---|
| **Grurë** | 4540 | 45.49 |
| **Misër** | 2985 | 29.91 |
| **Perime** | 205 | 2.054 |
| **Patate** | 145 | 1.45 |
| **Jonxhë** | 430 | 4.30 |
| **Bimë foraxhere** | 800 | 8.01 |
| **Thekër** | 115 | 1.15 |
| **Tërshërë** | 205 | 2.05 |

| | | |
|---|---|---|
| **Elb birre** | 170 | 1.70 |
| **Elb pranveror** | 35 | 0.35 |
| **Mollë** | 87 | 0.87 |
| **Kumbull** | 95 | 0.95 |
| **Dardhë** | 34 | 0.34 |
| **Arrë** | 85 | 0.85 |
| **Qershi** | 1.50 | 0.01 |
| **Lajthi** | 45 | 0.45 |
| **Dredhëz** | 1.5 | 0.01 |
| **TOTALI** | 9979 | 99.944 |

(Burimi: Drejtoria e Bujqësisë, 2023)

Sa i përket rendimentit të kulturave bujqësore në Komunën e Klinës, rendimenti i grurit sillet diku rreth 4980kg/ha për vitin 2020,3800kg ha për vitin 2021,3500kg/ha për vitin 2022 dhe 3460kg për vitin 2023.Rendimenti i misrit kokërr 5800kg/ha në vitin 2020,5600kg/ha në vitin 2021,5700 kg/ha për vitin 2022 ndërsa për vitin 2023 nu ka ende shënime sepse ende ska filluar dhe përfunduar korrja.
Rendimenti për ha të misrit të gjelbërt gjegjësishtë misri për silazh në vitin 2020 ishte 37000kg/ha,në vitin 2021 36000kg/ha, ndërsa në vitin 2022 ishte 35000kg/ha.

Rendimenti për ha te patatet në vitin 2020 ishte 18,000kg, në vitin 2021 ishte 17, 600kg, në vitin 2022 ishte 17, 400kg dhe në vitin 2023 ishte 19,300kg/ha. Rendimenti në kulturën e specit për vitin 2020 ishte 16,300kg/ha, në vitin 2021 ishte 16,500kg/ha, ndërsa në vitin 2022 ishte 16, 200kg/ha.Te domatja rendimenti për ha në vitin 2020 ishte 35,000kg, në vitin 2021 ishte 37,000kg/ha, ndërsa në vitin 2022 ishte 34,000kg/ha.
Kur jemi tek vlera financiare e kulturave dhe produkteve bujqësore (e nxjerrë nga llogaritja e rendimentit te pritshem dhe çmimit per kg në tregun e Kosovës për vitin 2023) totali i vlerës financiare, nga të gjitha kulturat dhe produktet bujqësore të cekura më lartë është afërsisht 30,000,000.00 Eur.. Sa i përket klasifikimit të tokës sipas përshtatshmërisë për prodhimtari bujqësore, Komuna e Klinës ka në disponim këto sipërfaqe

**Tabelë 12**. Sipërfaqja dhe përqindja e tokës bujqësore sipas klasave të përshtatshmërisë - Bonitetit

| Përshtatshmëria e Tokës Bujqësore | Sipërfaqja (Ha) | % |
|---|---|---|
| **Klasa 1** | 4928.95 | 15.9 |
| **Klasa 2** | 4337.13 | 14.1 |
| **Klasa 3** | 7665.95 | 24.8 |
| **Klasa 4** | 8647.25 | 27.9 |
| **Klasa 5** | 4091.70 | 13.2 |
| **Klasa 6** | 878.87 | 2.8 |
| **Klasa 7** | 78.37 | 0.2 |
| **Klasa 8** | 264.65 | 0.8 |
| **Gjithsej** | 30892.91ha | 100 |

Sic shihet edhe nga tabela më lart;  mbi gjysma e sipërfaqeve të tokës bujqësore në Komunën e Klinës janë nga klasa I deri IV që njëherit është edhe e mbrojtur me ligj dhe paraqet një bazë shumë të mirë zhvillimore sa i përket kultivimit me kultura bujqësore. Kjo cilësi e tokës bujqësore siguron rendimente të larta në prodhim si te drithërat, perimet ashtu edhe pemët.




**Harta 15.** Harta e përshtatshmërisë së tokës bujqësore në Komunën e Klinës

Bazuar në të dhënat e ELUP në Klinë, shtirja gjeografike e sipërfaqeve të tokave sipas përshtatshmërisë është si vijon:

*Klasa e parë e tokës* shtrihet në fshatrat: Gllarevë, Gjurgjevik i Madhë, Dresnik, Dollc, Gremnik , Qupevë, Sferkë, Caravik, Siqevë , Jashanicë, Zllakuqan, Berkovë, Krushevë e Madhe, Nagllak, Budisalc, Videjë, Pjeterq i Poshtem, Pjeterq i Epërm, Drenovc, Bokshiq, Dugajevë,Kpuz, Volljakë, Doberdol, Ujmirë, Perqeve, Zajm, Pograxhë, Dushi vogël.

*Klasa e dyte e tokës* shtrihet në fshatrat: Rixhevë, Zabërgjë, Cabiq, Caravik, Dobërdoll, Dresnik, Dollc, Gremnik, Qupevë, Volljakë, Dush, Sfërk, Kpuz, Qeskovë, Dollovë, Grabanicë, Dugojevë, Bokshiq, Zajm, Drenoc, Pjeterq i Poshtem, Pjeterq i Epërm, Krushevë e vogel, Videjë, Radulloc, Nagllavkëm Budisalc, Stupë, Krushevë e madhe, Zllakuqan, Berkovë, Ranoc, Leskoc, Jashanicë, Jellovc, Siqevë, Dush i vogël.

*Klasa e tretë e tokës* shtrihet në fshatrat: Kpuz, Volljak, Dush, Sferkë, Perqevë, Gllarevë, Dollovë, Bokshiq, Gremnik, Grabanicë, Pjeterq i Poshtem, Pjeterq i Epërm, Drenoc, Deiq, Dresnik, Gjurgjevik i Madh, Dollc,Zabërgjë, Cabiq, Dobërdoll, Ujmirë, Siqevë, Jellovc, Jashanica, Resnik, Shtupel, Binxhë, Dranashiq, Ranoc, Leskoc, Klinafc, Krushevë e vogël, Nagllavkë, Budisalc, Stupë, Rudicë, Berkovë, Klina, Pograxhë, Jashanica.

*Klasa e Katërt* shtrihet në fshatrat: Pograxhë, Jashanica, Rixhevë, Caravik, Kpuz, Volljak, Dush, Sferkë, Perqevë, Gllarevë, Dollovë, Bokshiq, Gremnik, Grabanicë, Pjeterq i Poshtem, Pjeterq i Epërm, Drenoc, Deiq, Dresnik, Gjurgjevik i Madh, Dollc,Zabërgjë, Cabiq, Dobërdoll, Ujmirë, Siqevë, Jashanica, Resnik, Shtupel, Binxhë, Dranashiq, Ranoc, Leskoc, Klinafc, Nagllavkë, Budisalc, Stupë, Rudicë, Berkovë, Pograxhë, Jashanica, Rixhevë, Caravik, Gremnikë, Videjë.

*Klasa e pestë* shtrihet në fshatrat:Ranoc, Leskoc, Dranashiq, Binxhë, Jashanica, Shtupel, Kerrnicë, Klinafc, Gjurgjevik i madh, Ujmirë, Siqevë, Cabiq, Caravik, Zabërgjë, Gllarevë, Perqevë, Sferkë, Dush, Vollajkë, Kpuz, Dolovë, Qupevë, Qeskovë, Bokshiq, Grabanicë, Dugojevë, Pjeterq i Poshtem, Pjeterq i Epërm, Videjë, Krushevë e madhe, Budisalc, Drenoc, Gremnikë, Dollc.

*Klasa e gjashtë e tokës* shtrihet në fshatrat: Sferkë, Perqevë, Dush, Vollajk, Kpuz, Qeskovë, Bokshiq, Grabanicë, Gremnik, Qupevë, Dugojevë, Pjeterq i Poshtem, Gjurgjevik i madh, Siqevë, ujmirë, Cabiq, Dush i vogël, Shtupel, Binxhë, Leskoc.

*Klasa e shtatë e tokës* shtrihet në fshatrat:Gjurgjevik i madh, Sferkë, Gremnik, Volljakë.

*Klasa e tetë e tokës* shtrihet në fshtarat:Gremnikë, Qupevë, Dollovë, Qeskovë, Bokshiq, Kpuz, Dush, Ujmirë, Cabiq, Gjurgjevik i madh, Dresnik, Klinafc, Binxhë, Ranoc, Leskoc, Jashanicë.

#### *2.3.3.2. Pjerrësia e terrenit për shfrytëzim bujqësor*
Në krijimin e resurseve tokësore në komunën e Klinës kanë pasur ndikim faktorë të ndryshëm si: ndërtimi gjeologjik i hapësirës, relievi, klima, hidrografia, bota bimore etj. Në komunën e Klinës hasen tipe të ndryshme të tokave të cilat janë të ndërlidhura ngushtë me pjerrësinë e terrenit, i cili është faktorë shumë i rëndësishëm dhe madje determinues edhe për shfrytëzimin e tokës për bujqësi. Në kontekstin e përgjithshëm hapësirat që identifikohen me pjerrësi më të vogël, trashësia e shtresës së tokës (humusi) është më e madhe dhe anasjelltas. Trashësia e humusit është element i rëndësishëm edhe në krijimin e bonitetit të tokës. Pjerrësia e terrenit gjithashtu është e lidhur ngusht edhe me procesin e erozionit: sa më i pjerrët që është terreni, niveli i erozionit është më i theksuar dhe anasjelltas.
Nga analiza e pjerrësisë së terrenit në komunën e Klinës për nevojat e bujqësisë, evidentohet se nga sipërfaqja e përgjithshme e komunës së Klinës vetëm 54% apo 166.75 km2 konsiderohen sipërfaqe të përshtatshme për bujqësi. Ndërsa pjesa tjetër e sipërfaqeve konsiderohen si kategori kufizuese për shfrytëzim të rëndësishëm bujqësor, apo si hapësira të dobishme vetëm për pylltari.
Tokat me pjerrësi të vogël e që janë të përshtatshme për bujqësi evidentohen përgjatë rrjedhave lumore të Drinit të Bardhë, Lumbardhit të Pejës dhe lumit Klina. Sipërfaqet me pjerrësi mbi $12^{o}$ zënë pjesën tjetër të mbetur dhe janë të pozicionuara në lartësi mbi 500m në zonat kodrinore-malore të komunës së Klinës, konkretisht në zonat kadastrale Gllarevë, Sferkë, Binxhë, Dushë i Vogël etj.

**Tabelë 13**. Klasifikimi i sipërfaqeve për nevoja të bujqësisë në komunën e Klinës

| Pjerrësia | Sipërfaqja (km²) | Përqindja | Tipi i tokës |
|---|---|---|---|
| **<5⁰** | 166.75 | 54.03 | Shpate të përshtatshme për bujqësi |
| **5 - 12⁰** | 128.37 | 41.60 | Shpate relativisht të përshtatshme për bujqësi me ekzistimin e rrezikut nga erozioni |
| **12 - 25⁰** | 12.92 | 4.19 | Kategoria kufizuese e shpateve për shfrytëzim më të rëndësishëm bujqësor |
| **25 - 40⁰** | 0.55 | 0.18 | Shpatet të dobishme për bujqësi përmes tarracimit |
| **> 40⁰** | 0.01 | 0.003 | Shpatet e dobishme vetëm për pylltari |
| | 308.6 | 100.00 | |




**Harta 16.** Klasifikimi i sipërfaqeve për nevoja të bujqësisë në komunën e Klinës

### *2.3.3.3. Ujitja e Sipërfaqeve Bujqësore*

Sa i përket ujitjes së tokës bujqësore në Komunën e Klinës, aktualisht janë 1,500 ha nën ujitje të kombinuar. Pra, gjendja momentale e ujitjes së tokave bujqësore në komunë është ende e vogël dhe kjo është edhe një ndër arsyet kryesore të rendimentit të ulët të kulturave bujqësore.

**Tabelë 14**. Ujitja e Sipërfaqeve Bujqësore në Komunën e Klinës

| Nr. | Vendi | Burimi i ujit | Lloji i Kulturës së Ujitur | Sip. e mundshme për ujitje/ha | Sip. e ujitura/ha |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Stupë, Budisalc, Rudicë | Drini i Bardhë | Misër, Perime, Livadhe, Pemë | 470 | 470 |
| **2** | Krushevë e Madhe | Drini i Bardhë | Misër, Perime, Livadhe, Pemë | 300 | 250 |
| **3** | Zllakuqan, Jagodë, Videjë | Drini i Bardhë | Misër, Perime, Livadhe, Pemë | 300 | 300 |
| **4** | Zajm | Drini i Bardhë | Misër, Perime, Livadhe, Pemë | 140 | 0 |
| **5** | Pjetërq i Epërm, Pjetërq i Poshtëm, Drenoc | Lumbardhë i Pejës | Misër, Perime, Livadhe, Pemë | 200 | 0 |
| **6** | Dugajevë | Lumbardhë i Pejës | Misër, Perime, Livadhe, Pemë | 120 | 0 |
| **7** | Grabanicë e Epërme | Lumbardhë i Pejës | Misër, Perime, Livadhe, Pemë | 150 | 150 |
| **8** | Grabanicë e Poshtme | Lumbardhë i Pejës | Misër, Perime, Livadhe, Pemë | 100 | 80 |
| **9** | Dollovë | Lumbardhë i Pejës | Misër, Perime, Livadhe, Pemë | 120 | 120 |
| **10** | Kpuz | Lumbardhë i Deçanit | Misër, Perime, Livadhe, Pemë | 70 | 50 |
| **11** | Gremnik | Burim i Fshatit | Misër, Perime, Livadhe, Pemë | 50 | 50 |
| **12** | Zllakuqan, Radulloc, Krushevë e Vogël | Drini i Bardhë | Misër, Perime, Livadhe, Pemë | 100 | 40 |

Burimi: Drejtoria e Bujqësisë Klinë, 2023

### *2.3.3.4. Sektori i blegtorisë dhe shpeztarisë*

Sipas të dhënave nga ASK (2014), komuna e Klinës në vitin 2014 numëronte gjithësej 10,474 gjedhe, në vitin 2020 numëronte 3,560 krerë, ndërsa në vitin 2021 numëronte 3,610 sosh**.** Sipas burimit të njëjtë (ASK, 2014), komuna e Klinës në vitin 2014 numëronte gjithësej 2,345 dele, në vitin 2020 numëronte 3,030 krerë, ndërsa në vitin 2021 numëronte 3,070 sosh. Përveç kësaj, në vitin 2014 komuna e Klinës numëronte 606 dhi, 4,160 derra, 56 kuaj, gomarë dhe mushka, ndërsa numëronte edhe 3,724 koshere bletësh.

Sa i përket shpeztarisë; sipas të dhënave dhe statistikave nga ASK (2014), komuna e Klinës në vitin 2014 numëronte gjithësej 75,240 shpezë. Prej tyre, pula për vezë: 41,546 (55.2%), zogj, pula dhe

gjela: 27,393 (36.4%), zogj për majmëri: 2,706 (3.6%), biba: 2,207 (2.9%), rosa dhe pata: 523 (0.7%) dhe të tjera: 865 (1.2%). Sipas shënimeve nga Drejtoria e Bujqësisë Klinë numri i gjedheve për vitin 2022 ishte 5,100 krerë, në vitin 2023 ishte 5,060 krerë, numri i lopëve qumështore për vitin 2022 ishte 3,500 krerë, ndërsa në vitin 2023 ishte 3,480 krerë. Aktualisht në Komunën e Klinës ka 4 ferma komerciale të qumështit me nga 40 krerë si dhe 10 ferma me nga 15 krerë. Fermat tjera komerciale janë me numër më të vogël.
Fermat komerciale vazhdojnë të ngriten vazhdimisht mirëpo kanë nevojë për mbështetje financiare qoftë nëpërmjet kreditimeve të volitshme apo subvencioneve për bujqësi. Problem tjetër paraqesin tokat rreth lumenjve të cilat janë të rrezikuara vazhdimisht nga erozioni i cili shpesh herë ndikon në ndryshimin e rrjedhës së lumenjëve dhe dëmton sipërfaqet e tokës bujqësore. Gjendja më e renduar në tokat buzë lumenjëve është në fshatrat Grabanicë, Zllakuqan dhe Dugojevë ku kërkohet intervenim i menjëhershëm. Momentalisht në territorin e komunës së Klinës për rreth lumenjëve ujiten 500-600 ha por ekziston mundësia që me rehabilitimin dhe ndërtimin e e pendave të reja të ujiten deri në 2,000 ha.
Numri i deleve për vitin 2022 ishte 3,036, ndërsa për vitin 2023 ishte 3,220 krerë. Numri i dhive për vitin 2022 ishte 1,182 krerë, ndërsa në vitin 2023 ishte 1,205 krerë.
Në vitin 2023 në Klinë kishte 37,500 pula vojse, e të që mbarështohen në 1,700 ekonomi familjare. Sa i përket bletëve, në vitin 2023 në Klinë kishte 5,200 shoqëri e të cilat mbarështohen nga 150 bletarë.

### *2.3.3.5. Rendimentet e qumështit*

Rendimenti i qumështit te lopët për vitin 2022 ishte 15,330,000 l në total, ndërsa në vitin 2023 ishte 13,350,224 l. Kjo i bije që rendimenti i qumështit në vitin 2022 ishte 4,380 l për kokë lope, ndërsa në vitin 2023 ishte 3,836 l për kokë lope.
Ndërsa në anën tjetër, sasia e prodhuar e qumështit të deles për vitin 2020 ishte 666,000 l, ndërsa për vitin 2021 ishte 683,070 l.
Ky nivel i ulët i prodhimit vije për arsye të shumta, e ndër më kryesoret janë si vijon: niveli arsimor, racat jo tipike qumështore, ushqim jo i mjaftueshëm dhe kualitativ për lopët, mos normim i ushqimeve për racionet ushqimore, vjetërsia e kafshëve, shtyerja e riprodhimit, mungesa e mirëqenies në ferma, menaxhimi jo i mirë i mbetjeve nga fermat, mos ndryshimi dhe rezistimi i shumë fermave për të aplikuar teknologjitë e reja etj.

### *2.3.3.6. Prodhimi i mishit*

Bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Bujqësisë, në vitin 2023 në Komunën e Klinës, ka 3 ferma për majmëri gjedhi për mish, me mesatarisht 50 krerë për fermë, ndërsa 10 prej tyre kanë rreth 20 krerë. Fermat e tjera janë kryesisht ferma të vogla.
Komuna e Klinës ka një fond blegtoral mjaft të pasur dhe të larmishëm. Ky fond përbëhet kryesisht nga: Gjedhët, delet, dhitë, pulat,derrat etj.
Gjedhëtaria e cila paraqet edhe bazën kryesore momentale të zhvillimit të bujqësisë në komunë numëron 3,610 krerë lopë qumështi që mbarështohen nëpër ferma komerciale të mëdha, të mesme dhe të vogla por me tendencë rritjeje. Te lopët qumështore dominon raca Simental dhe metisët e sajë, Hollshtajn Frizis, Hollshtajn, Red Hollshtajn, Monte Biliard etj.,
Nënsektori i Shpezëve (pula vojse) poashtu paraqet një potencial të mirë zhvillimor, mirëpo Klina ka vetëm një fermë komerciale me pula vojse me kapacitet 6,500 copë.

*Brojlerët (zogjët për mish):* Kjo kategori e shpezëve është fare pak e zhvilluar edhe atë më shumë në ekonomi familjare. Duhet kushtuar një vëmendje krijimit të fermave komerciale sepse ka një treg të mirë konsumi.
Vlerësojmë se Komuna me këto kapacitetete të pulave vojse që ka është shumë larg përmbushjes së nevojave për konsum lokal prandaj duhet nxitur individë dhe fermerë tjerë për të investuar në këtë sektor përmes politikave më të favorshme nga niveli lokal dhe qëndror.

*Bletaria***:** Ky sektor vlersohet ende i vogël, por edhe i pa shfrytëzuar në raport me potencialin dhe kapacitetet ekzistuese, si për nga sasia ashtu edhe për nga rendimenti. Komuna e Klinës ka resurse të mira për zhvillim të këtij sektori, mirëpo, ashtu sikur sektorëve tjerë blegtoral, edhe sektorit të Bletarisë i mungon aplikimi i praktikave të mira për mbarështim. Komuna e Klinës ka 5,300 shtëpiza me bletë në total.

### *2.3.3.7. Sektorët mbështetës*

***Ambulancat Veterinare:*** Komuna e Klinës ka 6 ambulanca veterinare të cilat përbëjnë një infrastrukturë të mirë mbështetëse të sektorit. Ndihma ofrohet në disa aspekte, të tilla si: preventivë, kurime dhe vaksinime por edhe përmirësim racor përmes inseminimeve artificiale. Ambulancat veterinare përmes rolit të tyre preventiv dhe mjekues që kanë te kafshët ndikojnë edhe në parandalimin e përhapjes së disa sëmundjeve zoonotike dhe epidemike në njerëz duke mbrojtur në mënyrë inderekte edhe shëndetin publik.

***Barnatoret Bujqësore:*** Komuna e Klinës ka 5 barnatore bujqësore aktive të cilat poashtu paraqesin një aset shtesë dhe mbështetës të sektorit duke furnizuar prodhuesit me inpute agrare.

***Qumështoret dhe Pikat Grumbulluese të qumështit:*** Klina ka qumështoren VITA e cila ka kapacitete të mëdha përpunuese me mbi 140,000 l/ditë, si dhe 6 pika grumbulluese të qumështit të cilat lehtësojnë në masë të madhe punën e prodhuesve të qumështit.

*Therrtoret dhe Industria e Mishit***:** Komuna ka 1 therrtore e cila e bënë më të qëndrueshëm sektorin e trashjes së derrave, ndërsa nuk ka as një therrtorre të kafshëve të trasha si gjedhi.

***Tregu i kafshëve:*** Klina ka një treg të kafshëve i cili është në gjendje të mirë.

## 2.3.4. Pylltaria

Sipas vlerësimit të shfrytëzimit të tokës në Komunën e Klinës nga 30,869.01 Ha sa është sipërfaqja totale e komunës 10,787.76 Ha, apo 34.94% e sipërfaqes totale janë Pyje dhe Kullosa; 14,582.55 Ha, apo 47.24 % e sipërfaqes totale janë Tokë Bujqësore; 3,288.30 Ha, apo 10.65% e sipërfaqes totale janë Sipërfaqe e Ndërtuar, ndërsa 2,210.4 Ha, apo 7.16 % e sipërfaqes totale të komunës së Klinës i takojnë kategorisë ‘Sipërfaqe tjera”.
Në tabelën e më poshtme është paraqitur shpërndarja e sipërfaqeve pyjore në Komunën e Klinës sipas vendbanimeve.

**Tabelë 15**. Shpërndarja e sipërfaqeve pyjore në komunën e Klinës , sipas vendbanimeve

| Vendbanimi | Sip. Pyjore (Ha) |
|---|---|
| Berkove | 61.45 |
| Binxhë | 80.20 |
| Bokshiq | 81.86 |
| Budisalc | 127.80 |
| Caravikë | 41.97 |
| Çabiq | 149.38 |
| Deiq | 1.52 |
| Dobërdol | 191.19 |
| Dollc | 202.36 |
| Dollovë | 10.21 |
| Dranashiq | 64.85 |
| Drenoc | 220.48 |
| Dresnik | 487.89 |
| Dugojevë | 208.18 |
| Dush | 35.63 |
| Dush I Vogel | 131.49 |
| Gllarevë | 60.70 |
| Grabanicë | 162.61 |
| Gremnik | 448.199 |
| Grapc | 144.03 |
| Gjurgjevik I Madh | 624.55 |
| Gjurgjevik I Vogel | 7.85 |
| Jagodë | 3.20 |
| Jashanicë | 218.54 |
| Jelloc | 97.31 |
| Klinavc | 89.67 |
| Klinë | 4.56 |
| Kpuz | 616.32 |
| Kërrnicë | 54.33 |
| Krushevë e Madhe | 111.42 |
| Krusheve e Vogel | 20.69 |
| Leskoc | 118.94 |
| Nagllavkë | 51.54 |
| Pograxhë | 38.46 |
| Perqevë | 385.27 |
| Pjëterq i Eperm | 82.04 |
| Pjëterq i Poshtem | 164.89 |
| Qeskovë | 7.79 |
| Qupevë | 116.71 |
| Radulloc | 82.75 |
| Resnikë | 186.69 |
| Ranoc | 43.20 |
| Rixhevë | 819.05 |
| Rudicë | 10.45 |
| Sferkë | 576.60 |
| Siqevë | 237.46 |
| Stupë | 23.01 |
| Shtupel | 107.85 |
| Ujmirë | 11.40 |
| Videjë | 277.71 |
| Volljak | 111.82 |
| Zabërgjë | 21.37 |
| Zajm | 77.06 |
| Zllakuqan | 28.00 |
| TOTALI | 8,609.08 Ha. |

*Burimi: Drejtoria e Bujqësisë, Klinë*

### 2.3.5. Tregtia

Nga numri total i bizneseve aktive në Komunën e Klinës (1,510), 343 prej tyre, apo 23 % e totalit të bizneseve i takojnë kategorisë së Tegtisë me Shumicë dhe Pakicë. Kjo e bënë Tregtinë sektorin më të madh ekonomik në Komunën e Klinës dhe rrjedhimisht sektorin më të rëndësishëm ekonomik, krahas bujqësisë, shërbimeve dhe akomodimit/hotelerisë.

### 2.3.6. Zona Industriale

Zona Industriale në Klinafc me sip 20.09 Ha, Zona Industriale në Nagllavkë me sip 6.06 Ha, si dhe Zona Industriale në Pograxhë e cila është e propozuar me Hartën Zonale Komunale 2020-2028+ si Zonë Industriale me sip.7.89 Ha janë akutalisht sipërfaqe të planifikuara për zhvillimin e aktivitetit industrial dhe prodhues, mirëpo asnjëra nga këto zona nuk funksionon plotësisht. Nga këto zona, Zona Industriale në Klinafc funksionon vetëm pjesërisht, ndërsa edhe Strategjia e Zhvillimit

Ekonomik Lokal parasheh zhvillimin e mëtutjeshëm të kësaj zone dhe funksionalizimin e plotë të saj. Zona Industriale në Nagllavkë është privatizuar dhe aktualisht nuk ka funksion të Zonës Industriale. Sa i përket Zonës Industriale në Pograxhë, kjo zonë ka mbetur vetëm si propozim ndërsa nuk është ndërmarrë asnjë hap për funksionalizmin e saj. Kjo zonë po ashtu është në kufi me perimetrin e cakturar për zonën e mbrojtur të burimit të ujit.




**Harta 17.** Harta e Zonave Ekonomike

## 2.3.7. Zejtaria

Profesioni tradicional i femrave në rajonin e Klinës është prodhimi i veshjeve të endura në gjergjef dhe të dekoruara me ngjyra të ndryshme. Kjo është zeje që ende ekziston, dhe krijon potencial për një produkt atraktiv që është zhvilluar nga artizanet femra të komunës së Klinës.
Shumica e aktiviteteve të banorëve është në veprimtaritë shërbyese – hoteliere dhe zejtare e cila në shumicën e rasteve zhvillohet në kuadër të objekteve të banimit përgjatë rrugëve kryesore. Aktualisht mungojnë të dhënat për numrin e saktë të bizneseve të regjistruara e të cilat aktivitet primar i kanë aktivitetet zejtare.

## 2.3.8.Turizmi

Komuna e Klinës ofron një potencial të larmishëm turistik falë burimeve të saj të pasura natyrore dhe trashëgimisë kulturore. Ndër format e identifikuara të turizmit që mund të zhvillohen në këtë zonë janë turizmi shëndetësor, turizmi natyror, agroturizmi, turizmi rural dhe turizmi kulturor. Gryka e lumit Klina - ofron mundësi për ndërtimin e një qendre rehabilituese për sëmundjet e

frymëmarrjes, duke i dhënë rëndësi turizmit shëndetësor. Në aspektin natyror, komuna përmban atraksione si Monumenti i Natyrës Mirusha dhe Kanioni i lumit Klina, të cilat tërheqin vizitorë për bukurinë e tyre unike dhe aktivitetet në natyrë, përfshirë speleoturizmin. Parku "Ujëvarat e Mirushës" është një ndër zonat më të bukura dhe interesante të natyrës së Republikës së Kosovës. Ky park shtrihet në territorin e komunave Klinë, Malishevë dhe Rahovec. Saktësisht gjendet në jug të maleve Gremnik, në të dy anët e rrjedhës së lumit Mirusha. Sipërfaqja e këtij parku është 598.4 ha. Lartësia mbidetare e parkut është 340-600 m. Në këtë park, lumi Mirusha në pjesën e fundit të rrjedhës së tij kalon nëpër një grykë e cila njihet si Kanjoni i lumit Mirusha dhe krijon 12 ujëvara dhe 16 liqene e që këto paraqesin një fenomen të rrallë morfohidrologjik. Pa dyshim, është një nga peizazhet më atraktive për vizitorë. Ky park zbukurohet edhe më tej me florën dhe faunën e saj.
Ndërkohë, trashëgimia kulturore përfaqësohet nga monumentet e shumta historike, të cilat përbëjnë një pasuri të çmuar për turizmin kulturor në këtë komunë.
Sa i përket të dhënave mbi numrin e turistëve dhe shifrave të ngjashme, nuk ka ndonjë të dhënë mbi të cilën mund të pasqyrohet gjendja aktuale e as mbi bazën e së cilës do të mund të bëhej planifikimi për të ardhmen.

### 2.3.9. Resurset nëntokësore dhe sipërfaqësore

Territori i Komunës së Klinës shquhet për pasuri natyrore. Hapësira karakterizohet me pyje dhe tokë kualitative bujqësore, pasuri nëntokësore, trashëgimi të pasur natyrore dhe kulturore.
Komuna ka resurse natyrore minerale dhe jo minerale, të tilla si: rezerva të linjitit (2 miliardë tone), të xehes së boksitit (2 milionë tonë), të argjilës (6.5 milionë tonë), të rërës dhe zhavorrit (3.5 milionë tonë) etj.Nga totali i bizneseve aktive të regjistruara në Klinë (1,510), vetëm 23 nga to, apo 1.5 % e totalit të bizneseve aktivitet primar i kanë xeheroret dhe gurëthyesit. Kjo përqindje e vogël e bizneseve të orientuara në këtë sektor tregon një disproporcion mes potencialit real të sektorit për zhvillim të gjithëmbarshëm ekonomik dhe aktivitetit të realizuar aktualisht.




**Harta 18.** Harta e minierave dhe burimeve minerale

## 2.4. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Uji ka një rol shumë të rëndësishëm në jetën e njeriut dhe sigurimi i tij është kthyer në një nga sfidat më të mëdha botërore. Gjithmonë uji ka qenë faktor vendimtar në zhvendosjen e popullsive nga një vend në një tjetër, sepse ai është kushti themelor për një jetë të sigurt e të shëndetshme.
Prandaj, qëllimi i planit zhvillimor komunal është të orientojë institucionet në procesin e përmirësimit të shërbimeve të ujit dhe largimit të ujërave të ndotur, duke synuar:

1. Përfshirjen e të gjithë banorëve me shërbime të kontrolluara të ujit të pijes,
2. Rritjen e kualitetit te shërbimeve dhe
3. Largimin e trajtimin e ujërave të ndotura.

Furnizimi me ujë të pijes dhe largimi i ujërave të ndotura paraqesin një shërbim të veçantë për banorët me ndikim të drejtpërdrejtë në kualitetin e jetës dhe reflektim në shëndetin e popullatës.
Te gjitha shkarkimet e ujërave te ndotura krijojnë probleme mjedisore në lumenjtë dhe liqenet, prandaj zhvillimi i këtij projekti do të sillte ndikime pozitive në mjedis duke krijuar një impiant të trajtimit të këtyre ujërave të ndotur dhe më pas derdhjen e tyre në liqen dhe me tej në det.

### 2.4.1. Infrastruktura e Ujësjellësit

#### *2.4.1.1.Uji i pijes*

Komuna e Klinës ka mbi 38,000 banorë me gjithsej 53 fshatra dhe qyteti i Klinës, i cili gjendet në pikën ku lumi Klina derdhet në pellgun e lumit Drini i Bardhë. Shtrirja e popullsisë në zona rurale është 85.6%, ndërsa në zonë urbane jetojnë vetëm 14.4% e popullsisë. Në bazë të numrit të banorëve për Komunën e Klinës, sasia e nevojshme për furnizim me ujë të pijes për tërë komunën është rreth Q=120 l/s.
Humbjet ne rrjet janë 50%. Materiali në sistemin e ujësjellësit është HDPE. Një ndër problemet më të mëdha të Komunës së Klinës është furnizimi i banorëve me ujë të pijshëm. Këto probleme janë për arsye se shumica e vendbanimeve nuk furnizohen me ujë nga sistemet e ujësjellësit, por nga puset dhe burime të pakontrolluar. Probleme kanë edhe banorët që janë të kyçur në rrjetin ujësjellësit, e kjo për shkak të cilësisë diskutabile të ujit. Vendbanimet që furnizohen me ujë janë paraqitur në formë tabelare:

__Tabelë 16__. Vendbanimet që furnizohen me ujë

| Sistemet e Ujit | Nr | Vendbanimi | Mënyra e furnizimit | Lloji I sistemit | Nr. i konsumatorëve | Kapaciteti q (l/s) | Reshjet mesatare $P_{mes}$ (mm) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Klinë** | 1 | Klina | Sistemi I ujësjellsit të qytetit | Nga rezervuari I vjetër | 5542 | 7 | **700** |
| | 2 | Dollc | | | 276 | 08-12 | |
| | 3 | Dresnik | | | 1770 | 08-12 | |
| | 1 | Jashanica | | | 1784 | | |
| | 2 | Pograxha | | | 366 | | |
| | 3 | Jellovc | | | 27 | | |
| | 4 | Dush I vogël | | | 196 | | |
| | 5 | Ujmiri | | | 544 | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Jashanicë** | 6 | Siqeva | Sistemi I ujësjellsit në Jashanicë | Nga Rezervuari I ri | 1338 | 4-6 | |
| | 7 | Shtupel | | | 771 | | |
| | 8 | Kërnicë | | | 794 | | |
| | 9 | Binxhë | | | 117 | | |
| | 10 | Grabc | | | 206 | | |
| | 11 | Dranashiq | | | 21 | | |
| | 12 | Klinafc | | | 480 | | |
| **Sferkë** | 1 | Sferkë | Sistemi I ujësjellësit I Sferkë | Nga pusi me pompa | 2448 | | |
| | 2 | Dush | | Nga pusi me pompa | 196 | | **650** |
| | 3 | Volljakë | | Nga pusi me pompa | 929 | | |
| | 4 | Qupevë | | Nga pusi me pompa | 579 | 5-8 | |
| **Furnizim nga burimet vetjake** | 1 | Bërkovë | | | 246 | | **700** |
| | 2 | Qeskovë | Pusi Publik | | 373 | | |
| | 3 | Kpuz | Pusi Publik | | 622 | | |
| | 4 | Grabnicë | Puset Publike | | 728 | | |
| | 5 | Gremnik | Burimi | | 1131 | | |
| **Furnizim Individual** | 1 | Zajmë | Furnizimi individual (secila nga familjet kanë patur furnizim vetjak) | Nga puset, burimet, etj. | 1267 | | **700** |
| | 2 | Videjë | | | 663 | | |
| | 3 | Deiq | | | 376 | | |
| | 4 | Krushevë e Vogël | | | 323 | | |
| | 5 | Gjurgjevik e vogël | | | 754 | | |
| | 6 | Jagodë | | | 197 | | |
| | 7 | Budisalc | | | 398 | | |
| | 8 | Rudicë | | | 446 | | |
| | 9 | Krushevë e madhe | | | 585 | | |
| | 10 | Stupë | | | 179 | | |
| | 11 | Nagllavë | | | 67 | | |
| | 12 | Zllakuqan | | | 660 | | |
| | 13 | Ranoc | | | 353 | | |
| | 14 | Leskoc | | | 239 | | |
| | 15 | Raduloc | | | 353 | | |
| | 16 | Drenoc | | | 440 | | |
| | 17 | Dugajevë | | | 399 | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 18 | Pjetërq I Poshtëm | | | 160 | | |
| | 19 | Pjetërq I Epërm | | | 563 | | |
| | 20 | Bokshiq | | | 433 | | |
| | 21 | Dollovë | | | 444 | | |
| | 22 | Resnik | | | 399 | | |
| | 23 | Gjurgjevik i madh | | | 449 | | |
| | 24 | Çabiq | | | 862 | | |
| | 25 | Dobërdoll | | | 339 | | |
| | 26 | Gllarevë | | | 1784 | | |
| | 27 | Rixhevë | | | 870 | | |
| | 28 | Caravik | | | 1241 | | |
| | 29 | Zabërgjë | | | 728 | | |




**Harta 19.** Mbulueshmëria e vendbanimeve me rrjet të ujësjellësit

### *2.4.1.2. Burimet e Furnizimit*

Qytetarët e komunës së Klinës furnizohen me ujë të pijshëm nëpërmjet tri formave:

- Sistemit qendror të furnizimit - ujësjellësi i KRU "HIDRODRINI"
- Sistemet e vogla - ujësjellësit lokal (sistem i pompimit), dhe
- Sistemet vetjake të vendbanimeve (Puset individuale).

Bazuar në statistikat e raportit të përformancës komunale, rreth 75% e vendbanimeve, përfshirë edhe qytetin e Klinës furnizohen me ujë nga KRU "Hidrodrini" dhe nga sistemet e pompimit, ndërsa 25% nga puset individuale.

Burimi i ujit "Jarinë" furnizon me ujë qytetin e Klinës dhe disa fshatra. Fabrika ka një kapacitet prodhues prej 310 $m^3$/orë (86.1 l/s dhe furnizon me ujë të pijes qytetin e Klinës dhe rreth 25 fshatra për rreth.

### *2.4.1.3. Fabrika për trajtimin e ujit*

Fabrika e përpunimit të ujit të pijshëm në Klinë dhe stacioni i pompave ndodhen pranë lumit Drini i Bardhë dhe momentalisht furnizohet me ujë nga 6 puset pranë fabrikës. Mirëpo uji që vije nga puset është në një sasi të vogël dhe uji i basenit të hapur është me turbullirë të lartë. Prodhimi i ujit varet edhe nga turbullirat e ujit të lumit Drini i Bardhë.

Stacioni i pompimit e dërgon ujin në rezervuarin me kapacitet 1,500 m3 i cili ndodhet në kodrën e Tikveshit.

Fabrika është ndërtuar nga ndërmarrja PC&E dhe në bashkëpunim me firmën Holandeze "TURBINE" me investim të përbashkët nga Komuna e Klinës dhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Në këtë fabrikë i gjithë procesi është i automatizuar falë instalimit të PLC të prodhuesit "Simens Simatic S7".

Burimi i Jarinës gjendet në pjesën lindore të qytetit të Klinës, afër hekurudhës, më saktësisht tek tuneli i hekurudhës në afërsi të fshatit Pogragjë. Sipas të dhënave të mbledhura, ky burim ka kapacitet prej 120-200 l/s, mirëpo deri në stacion të pompave vjen sasia e ujit me kapacitet max. 105 l/s.

Stacioni i pompave të Jarinës furnizohet me ujë me vetërrjedhje nga burimi i Jarinës prej nga pastaj me pompim furnizohet rezervuari në Tikvesh me kapacitet prej 1,500 m3. Nga aty pastaj furnizohet pjesërisht qyteti i Klinës si dhe fshatrat Klinavc, Pograxhë, Dresnik, Dollc, Gjurgjevik i Madh (50%), Ujmirë, Dush-Jelloc, Siqevë, Jashanicë, Shtupel, Kërnicë dhe Binxhë-Grapc.

Pompat ekzistuese në Jarinë janë në një Stacion pompimi nëntokësor (SP1).

Zona urbane – Burimet e ujit të pijes dhe gjendja ekzistuese e furnizimit me ujë të pijes

Zona urbane furnizohet me ujë të pijes nga Fabrika e ujit "Jarinë" e cila ka një kapacitet prodhues prej 310 $m^3$/orë (86.1 l/s). Edhe tek ky rast uji që vie nga puset është në sasi të vogël dhe uji i basenit të hapur është me turbullirë të lartë.

Zona rurale – Burimet e ujit të pijes dhe gjendja ekzistuese e furnizimit me ujë të pijes

Nga të dhënat e lartpërmendura rezulton se nga 54 vendbanime sa ka komuna e Klinës:

- ✓ 24 vendbanime, respektivisht 44.44% kanë sistem të ujësjellësit,
- ✓ 30 vendbanime, respektivisht 55.55% furnizohen me ujë të pijes me sistem individual (puset, burimet etj.)




**Grafiku 7.** Përqindja e furnizimit me ujë për vendbanimet e Klinës

- ✓ 15 vendbanime, ose 27.77% e totalit të vendbanimeve janë të lidhura me sistemin qendror të furnizimit me ujë. Cilësia e ujit është shumë diskutabile, prandaj banorët nuk e shfrytëzojnë këtë ujë për pije.
- ✓ Sistemi i ujësjellësit Sferkë ka probleme teknike, prandaj nuk është plotësisht funksional.
- ✓ 30 fshatra nuk kanë ende sistem të ujësjellësit.
- ✓ Numri i kyçjeve: 300 konsumatorë
- ✓ Lloji i kyqjeve: Amvisëri, biznese të vogla, biznese të mëdha, industri dhe institucione etj.
- ✓ Gjatësia e përgjithshme e rrjetit me furnizim me ujë të pijshëm L=10 km'
- ✓ Materialet në sistemin e ujësjellësit: gypa HDPE nga 25mm –125mm
- ✓ Numri i pompave dhe rezervuarëve: 4 pompa me fuci instaluese 2x30 kë dhe 2x37 kë.
- ✓ Një rezervuar në stacionin e pompave V= 6.0$m^3$ dhe një rezervuar për fshatra me kapacitet Vr= 200 $m^3$

Infrastruktura teknike në komunën e Klinës ka nevojë për përmirësime dhe investime të mëtutjeshme, ngjashëm si në pjesën më të madhe të Kosovës. Përkundër faktit se Klina është një ndër komunat më të pasura me rrjedha ujore, furnizimi me ujë të pijshëm ende paraqit një problem të pazgjidhur në tërësi.

## 2.4.2. Infrastruktura e Kanalizimit

### *2.4.2.1. Rrjeti ekzistues i ujërave të zeza, atmosferike dhe industriale*

Njëri nga problemet më serioze mjedisore në Kosovë është shkarkimi i ujërave të ndotura dhe të patrajtuara në kanale, përroska, lumenj etj.

Në komunën e Klinës, shumica e vendbanimeve kanë qasje në kanalizim të ujërave të zeza, mirëpo mungon trajtimi i ujërave të zeza. Bazuar në statistikat e raportit të performancës komunale, konsiderohet se 85% e vendbanimeve në këtë komunë kanë qasje të plotë ose të pjesshme në kanalizim. Ndërsa 15% e tyre nuk kanë qasje fare.

Rrjeti i kanalizimeve në qytet e shumë fshatra po paraqet problem të madh në mirëmbajtje. Hedhja e mbeturinave në puseta dhe kyçja e stallave të bagëtive apo ujërave të shiut, shpesh shkakton

defekte shumë të mëdha. Problemi më i madh paraqitet në pjesët ku është instaluar kanalizimi, mirëpo nuk ka ende rrjet të ujësjellësit, dhe si pasojë KRU "HIDRODRINI" nuk e merr në mbikëqyrje për shkak së nuk e vjelë tarifën e ujit të harxhuar. Komuna e Klinës është në procesin e marrjes së të dhënave për nevojat e riparimit dhe mirëmbajtjes së këtij rrjeti.
Në Klinë janë të ndërtuar dy impiante për trajtimin e ujërave të zeza. Impianti në fshatin Sfërk dhe impianti në fshatin Vollajk. Të dy këto impiante janë funksionale. Gjithashtu ka filluar edhe të ndërtohen impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Gllarevë.
Vendbanimet që kanë rrjet të kanalizimit janë paraqitur në tabelën vijuese:

**Tabelë 17**. Vendet që kanë rrjet të kanalizimit

| Nr. | Vendbanimet me rrjet të kanalizimit | Lloji i sistemit | Gjatësia (m) |
|---|---|---|---|
| 1 | Gremnik | Sistem i veçantë | 2813 |
| 2 | Drenoc | Sistem i veçantë | 2000 |
| 3 | Dush | Sistem i veçantë | 1562 |
| 4 | Çabiqi | Sistem i njejtë | 1866 |
| 5 | Gllareva | Sistem i njejtë | 6000 |
| 6 | Rixheva | Sistem i njejtë | 6064 |
| 7 | Carraviki | Sistem i njejtë | 3500 |
| 8 | Zabërgjë | Sistem i njejtë | 2025 |
| 9 | Stupë | | 2641 |
| 10 | Budisalc | | 6929 |
| 11 | Nagllavë | | 1000 |
| 12 | Krushevë e Madhe | | 8000 |
| 13 | Jagodë | | 7345 |
| 14 | Videjë | | 3500 |
| 15 | Deiq | | 4628 |
| 16 | Zajm | | 3133 |
| 17 | Dollovë | | 4687 |
| 18 | Pjetërq i Poshtëm | | 4200 |
| 19 | Pjetërq i Epërmë | | 1500 |
| 20 | Volljakë | | 2950 |
| 21 | Dugajevë | | 3260 |
| 22 | Bokshiq | | 5922 |
| 23 | Grabanicë | | 6078 |
| 24 | Qeskovë | | 3000 |
| 25 | Këpuz | | 7100 |
| 26 | Berkovë | | 750 |
| 27 | Leskoc | | 4417 |
| 28 | Zllakuqan | | 5016 |
| 29 | Shtupel | | 7903 |
| 30 | Radulloc | | 5713 |
| 31 | Krushevë e Vogël | | 4400 |
| 32 | Gjurgjevik i Vogël | | 5761 |
| 33 | Klinë | | 20000 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **34** | Jashanicë | | 9500 |
| **35** | Kërrnicë | | 4000 |
| **36** | Rudicë | | 2500 |
| **37** | Resnik | | 4188 |
| **38** | Jellovcë | | 4000 |
| **39** | Siqevë | | 5837 |
| **40** | Pograxhë | | 5856 |
| **41** | Gjurgjevik i Madh | | 5245 |
| **42** | Dresnik | | 2350 |
| **43** | Dollc | | 5150 |
| **44** | Qupevë | | 3861 |
| **45** | Ujëmirë | | 4962 |
| **46** | Dobërdoll | | 7050 |
| **47** | Përqevë | | 2500 |
| **48** | Sferkë | | 12982 |
| **49** | Dush i Sferkës | | 2481 |
| **50** | Klinafc | | 2903 |
| **51** | Ranoc | | 3235 |
| | | **TOTAL:** | **241,181** |

Të gjitha vendbanimet që kanë sistem të kanalizimit, duke përfshirë edhe qytetin e Klinës, ujërat e zeza i shkarkojnë në lumenjtë më të afërt pa ndonjë trajtim paraprak. Pra, janë ndotës të drejtpërdrejt të lumenjve.

## Vendbanimet që nuk kanë rrjet të kanalizimit:

**Tabelë 18**. Vendet që nuk kanë rrjet të kanalizimit

| Nr | Vendabnimet pa rrjet të kanalizimit | Gjatësia (m) |
|---|---|---|
| ***1*** | *Grapc* | / |
| ***2*** | *Binxhë* | / |
| ***3*** | *Dranashiq* | / |




**Harta 20.** Mbulueshmëria e vendbanimeve me rrjet të kanalizimit

Në fshatrat tjerë ku nuk ka rrjet të kanalizimit, shkarkimi i ujërave të zeza bëhet në gropa klasike, nëpër jaze ose kanale sipërfaqësore. Shtëpitë ose grup-shtëpitë që kanë afër lumenj i shkarkojnë ujërat e zeza drejtpërdrejt në lumë pa ndonjë trajtim paraprak.
Materialet e përdorura në rrjetin e kanalizimit janë materiale PVC. Gjatësia totale e rrjetit aktual të kanalizimit është L=**241,181** m ose L=241.1 km.

## 2.4.3. Ujitja dhe Drenazhimi

Ujitja është një proces mjaft kompleks që ngërthen në vete çështje teknike, mjedisore, sociale e ekonomike në dimensione tejet të ndryshme hapësinore e kohore. Ujitja është edhe proces institucional që duhet të jetë i mirë-koordinuar në të gjitha nivelet administrative për të përfshirë efektivisht palët e ndryshme të interesit në proceset e vendim-marrjes.Kosova synon të rigjallërojë sektorin e saj bujqësor i cili është jetik për rritjen ekonomike dhe me këtë të ngadalësojë trendët e shpërnguljes së vazhdueshme apo shkretëtirëzimin e zonave rurale. Sipas Master Planit Kombëtar të Ujitjes- të publikuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural- Komuna e Klinës përfshihet në një nga zonat që kanë potencial për zhvillimin e ujitjes në Kosovë. Ndërsa, gjatë vitit 2021, komuna ka ndërtuar 225 m kanal për ujitje në fshatin Stupë dhe 1022 m në fshatin Dollovë.

Po ashtu, ka filluar më ndërtimin e kanaleve për ujitje në fshatrat Grabanicë, Krushevë e Madhe dhe shtrimin e rrugëve fushore me zhavorr.



**Figura 3**. Potenciali i zhvillimit të ujitjes në Kosovë (Burimi: Master Plani Kombëtar për Ujitje në Kosovë – MBPZHR)

**Tabelë 19:** Sipërfaqja e tokës bujqësore e ujitur sipas madhësisë së klasave, sipas komunave, Kosovë, 2014

| | Nr. i ekonomive bujqësore | Sipërfaqja (ha) |
|---|---|---|
| | Klinë | Klinë |
| Gjithsej | 470 | 459.62 |
| Më shumë se 0 dhe më pak se 0.25 | 192 | 17.71 |
| Nga 0.25 deri në më pak se 0.5 | 72 | 25.33 |
| Nga 0.5 deri në më pak se 1 | 93 | 59.37 |
| Nga 1 deri në më pak se 2 | 56 | 69.15 |
| Nga 2 deri në më pak se 5 | 39 | 102.98 |
| Nga 5 deri në më pak se 10 | 9 | 51.84 |
| 10 e më shumë | 9 | 133.24 |

### 2.4.4. Infrastruktura e Energjisë Elektrike

Kërkesat për energji dhe plani hapësinor për zhvillim strategjik ndryshon në periudha zhvillimore dhe për shkak të këtij ndryshimi vështirësohet balancimi i sistemit. Për të parë këtë ndikim, sidomos për rastin e sistemit elektroenergjetik të Kosovës, është me rëndësi analiza e diagramit ditor të konsumit për çdo orë të ditës për tërë periudhën vjetore. Klina me rrethinë furnizohet nga nënstacioni KLINA 110/10 kV/kV me fuqi instaluese prej 31.5 MVA. Trafostacionet të cilat furnizohen nga e njëjta kyçje e nënstacionit KLINA vazhdojnë të furnizohen nga TS 35/10 kV/kV me fuqi 2x8 MVA me furnizime të linjave 10(20)kV në drejtimet e fshatrave: Kina, Budisalc, Zllakuqan, Jagodë, Drenoc, Grabanicë, Kpuz, Dollc, Volljakë, Sfërk, Caravik, Ujmirë, Jashanicë dhe Shtupel. Rrjeti elektrik i përçuesve ajror dhe kabllor për nivelin e tensionit 10(20)/04 kV/kV i Komunës së Klinës është i shtrirë në të gjitha vendbanimet e Komunës.

Sa i përket gjatësisë së rrjetit për shpërndarje të energjisë elektrike; gjatësia e linjës 10 kv është 219,519.57 m (219.519 km); gjatësia e linjës 110 kv është 12,874 m (12.874 km); gjatësia e linjës 220 v është 8,828 m (8.828 km).

Numri total i trafostacioneve në komunën e Klinës është 248.

Nënstacioni i nivelit 110/10KV KLINA paraqet një mundësi të mirë për furnizim dhe zhvillim të qëndrueshëm energjetik në Komunë duke eliminuar dobësitë e vazhdueshme furnizuese të tilla si:

- Jo qëndrueshmëri e furnizimit me energji elektrike me përçues jo të diemnzionuar mirë të tipit ajror (LP 10(20) kV), e cila është bazë për zhvillimin ekonomik industrial;
- Investimet e mangëta në zhvillim të infrastrukturës energjetike me kapacitetet gjeneruese dhe të instaluara furnizuese energjetike;
- Humbje të mëdha teknike dhe komerciale të energjisë për shkak të mosdimensionimit të përçuesve për linjat ajrore dhe kabllore duke i vazhduar linjat furnizuese të tension të mesëm dhe tension të lartë për konsumatorët e rijnë;
- Humbjet e energjisë nga kyçjet ilegale dhe kyçjet në linjat e TM dhe TU pa balanc të ngarkesave;
- Jo stabilitet gjenerues i Termocentraleve të vjetruara dhe mungesë e sigurisë së furnizimit me energji elektrike për shkak të pajisjeve të vjetërsuara, ndërtimeve të egra dhe linjave të gjata radiale me shumë degëzime të stërngakuara;
- Mirëmbajtje jo e rregullt e stabilimenteve energjetike nga vjetërsia e tyre dhe prishja e pajisjeve industriale dhe rezidenciale nga ndërprerjet e shpeshta të linjave furnizuese;
- Rëniet e tensionit dhe cilësia e ulët furnizuese për shkak të humbjeve të mëdha teknike dhe komerciale deri në 27% në total, prej të cilave 15% janë humbje teknike dhe rënie të mëdha të tensionit;
- Mungesë e planit strategjik i cili pamundëson nisma konkrete për zhvillimin e infrastrukturës së sistemeve të energjisë së ripërtritëshme e në veçanti energjisë termike.

Në figurën e mëposhtme (Fig. 4) është paraqitur harta e Kosovës, skema gjeografike dhe skema njëpolare 400/220/110 kV nëpër tërë Kosovën, ashtu si edhe lidhja e Kosovës me vendet fqinje me anë të linjave 400/220 kV, dhe po ashtu, është paraqitur lidhja e linjës 110 kV në KLINË .[12]

[12] Njësia e KEK-ut në KLINË




**Figura 4.** Skema njëpolare 400/220/110 kV në hartën gjeografike të Kosovës

Klina me Fshatrat e afërta posedon 12,988 Konsumatorë Rezidencial dhe Komercial. Linjat Furnizuese janë nga nëstacioni i Linjës së TS 220/110 kV/kV Nashec nëpërmjet Gjakovës në nivelin 110kV. Në Klinë ekziston nënstacioni i KOSTIT TS 110/10kV/kV me fuqi transformatorike 31.5MVA dhe 12 dalje në nivelin 10KV, ndërsa në nivelin e DS KLINA ekziston TS 35/10 kV në punë paralele me dy transformatorë energjetik me fuqi instaluese 8 MVA dhe 5 dalje të nivelit 10 kV.




**Figura 5.** Rrjeti elektroenergjetik ekzistues në Klinë

Shtatë daljet të largpërçuesve 10 kV nga trafostacioni KLINA janë: Klina, Budisalc, Zllakuqan, Jagodë, Drenoc, Grabanicë, Dollc, Volljakë, Sfërk, Ujmirë, Jashanicë, Shtupel.Modeli i rrjetit të distribucionit dhe transmisionit të energjisë elektrike të qytetit të Klinës me rrethinë 110/35/10 kV, dhe pozicionimi i trafostacioneve 110/10 kV dhe 35/10 kV Klinë, është paraqitur në figurën në Figurën 6. Në Klinë rreth 70% të linjave 10 kV janë me seksion tërthor të vogël (Al/Fe – 35 mm2 dhe 50 mm2 ) dhe 30% janë kabllo nëntokësor PPOO 3x150 mm2. Për ketë arsye LP 10 kV ajror kanë rënie të mëdha të tensionit në Klinë dhe rrethinë. Ndërsa sa i përket energjisë termike, në komunën e Klinës aktualisht ekziton një rrjet i ngrohjes me gjatësi prej 76,995 m.




**Figura 6.** Seksionet tërthore të linjave ajrore 10 kV në Klinë




**Harta 21.** Rrjeti Energjetik në Komunën e Klinës

## 2.4.5. Infrastruktura e Telekomunikimit

Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Klinës, vetëm 2% e ekonomive familjare në komunën e Klinës posedojnë telefon fiks. Pjesa dërrmuese e tyre (85.6%) posedojnë vetëm telefon celular. Ndërsa 0.2% e popullsisë së Klinës nuk kanë as telefon fiks e as celular.
Sa i përket posedimit të kompjuterit personal, afër 51 % e ekonomive familjare në komunën e Klinës e posedojnë së paku një të tillë. Prej ekonomive familjare që posedojnë kompjuter, 45.1% e tyre kanë qasje në internet nga njësia e banimit dhe 5.9% e tyre nuk kanë qasje në internet. Ndërsa, nga ekonomitë familjare që nuk kanë kompjuter, 1.7% e tyre shfrytëzojnë mundësitë alternative të qasjes në internet dhe 47.3% e tyre nuk kanë qasje në internet fare.

## 2.4.6. Infrastruktura e Menaxhimit te Mbeturinave

*Grumbullimi i mbeturinave:* Mbeturinat grumbullohen në tërë territorin e komunës. Komuna ka marrëveshje për shërbime me KRM “Ambienti” njësia në Klinë. Shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave të amvisërisë bëhet në të gjithë territorin e Komunës, respektivisht në 6,411 amvisëri, 744 biznese dhe në 64 institucione. Ky operator grumbullon mbeturinat nga ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet në komunë dhe i transporton për deponim në deponinë sanitare rajonale në Sferkë (Komuna Pejë). Operatori i njëjtë kryen edhe shërbimin e grumbullimit të mbeturinave masive dhe të ndërtim rrënimit edhe pse për veprimtarinë e fundit nuk

posedon licencë valide. Në komunë të Klinës oprojnë edhe operatorë tjerë të riciklimit të cilët nuk janë të formalizuar dhe veprojnë jashtë sistemit legal.

Gjatë vitit 2021-2022 si rezultati i performacës së mirë në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, komuna e Klinës ka përfituar donacion dhe atë 3 kamionë, 2025 kontejnerë 120L dhe 240 komposter. Komuna ka miratuar Planin Komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027 dhe Rregulloren Komunale për menaxhimin e mbeturinave. Nga të dhënat e Raportit për gjendjen e mbeturinave në Kosovë, i hartuar në AMMK, për vitin 2021 dhe 2018, kemi këtë gjendje të menaxhimit të mbeturinave të gjeneruara, grumbulluara dhe të deponuara në Komunën e Klinës.

**Tabelë 20.** Sasia e mbeturinave të grumbulluara dhe deponuara në 2021 në Komunën e Klinës

| Viti | Mbeturina të grumbulluar (ton) | Mbeturina të grumbulluara nga deponitë ilegale (ton) | Totali i sasisë së mbeturinave të deponuara nga Ambienti (ton) |
|---|---|---|---|
| **2021**[13] | 9,758.70 | - | 9758.70 |
| **2018**[14] | 10,067.60 | - | 10067.60 |

Mbulimi më shërbim për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Klinës për ekonomit familjare është 97.9%. Prej numrit të përgjithshëm të EF që është 5843, shërbehen 5,721 EF.

**Tabelë 21.** Mbulimi me shërbim për gumbullimin e mbeturinave në territorin e komunës

| Emri i operatorit | Numri i EF | Numri i EF të shërbyera | Numri i bizneseve aktive | Numri i bizneseve të shërbyera | Numri i institucioneve | Numri i institucioneve të shërbyera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **KRM Ambienti** | 5,843 | 5,721 | - | 699 | - | 70 |

## 2.5. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI

### 2.5.1. Tansporti Rrugor

Në territorin e Komunës së Klinës shtrihen rrugët Nacionale N9 (Prishtinë-Pejë) dhe N9.1 (Klinë-Gjakovë) si dhe rrugët rajonale (R104,R105 dhe R122). Këto rrugë në aspektin administrativ janë nën juridiksionin e Ministrisë së Infrastrukturës. Pjesa tjetër e rrugëve janë në juridiksionin e komunës së Klinës. Në territorin e Klinës shtrihet edhe hekurudha në kuadër të linjave Prishtinë-Pejë dhe Prishtinë-Prizren.

**Tabelë 22**. Sipërfaqja në ha e rrugëve sipas kategorive në komunën e Klinës

[6] Raporti Vjetor për Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë, AMMK 2021

[14] Raporti Vjetor për Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë, AMMK, 2018

| Nr | Përshkrimi | Gjatësia [km] | % | Sipërfaqja me rrugë në nivel komune [ha] | % | Gjendja |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Rrugë nacionale | 28.7 | 5.76% | 22.96 | 7.48% | Asfalt |
| **2** | Rrugë rajonale | 46.3 | 9.30% | 30.10 | 9.81% | Asfalt |
| **3** | Rrugë lokale | 423.02 | 84.94% | 253.81 | 82.71% | Asfalt |
| **Total** | | 498.02 | 100.00% | 306.87 | 100.00% | |
| Sipërfaqja e komunës | | | | 30808 | | |
| Rrugë nacionale | | | | 0.07% | | |
| Rrugë rajonale | | | | 0.10% | | |
| Rrugë lokale | | | | 0.82% | | |
| Sipërfaqja e mbuluar me rrugë në nivel të komunës | | | | 1.00% | | |

Sipas gjatësisë, rrjeti rrugor i komunës së Klinës përbëhet nga:
-Rrugë nacionale: 5.76%,
-Rrugë rajonale: 9.30%,
-Rrugë komunale (lokale): 84.94%.




**Grafiku 8.** Sipërfaqja në ha dhe gjatësia e rrugëve në km sipas kategorive në komunën e Klinës

Rrjeti rrugor i komunës së Klinës kryesisht përbëhet nga rrugët lokale. Duke iu referuar ortofotove (v. 2018) dhe analizave të bëra në nivel të komunës, janë nxjerrë edhe sipërfaqet e mbuluara me rrugë dhe aktivitete të tjera përcjellëse sipas kategorisë së tyre. Në nivel komune vlerësohet se rrugët mbulojnë rreth 1.00 % të sipërfaqes totale. Pjesëmarrje më të madhe kanë rrugët lokale me 253.81 hektar (84.94%), rrugë regjionale 30.1 ha (9.30%) dhe ato nacionale 22.96 ha (5.76%). Rrugët e kategorisë së katërt (të pa kategorizuara) nuk janë të asfaltuara dhe kanë shtrirje kryesisht në zonat

periferike të komunës. Nga gjithsej 54 vendbanime të komunës, Klina përfaqëson kategorinë e rrugëve lokale, dhe 19 vendbanime tjera kanë qasje në kategorinë e rrugëve nacionale dhe regjionale, ndërsa të tjerat kanë rrugë lokale. Numri i banorëve që kanë në qasje në rrugë nacionale është 6491/b apo 16.86% (8 vendbanime), kurse në ato rajonale është 9977/b apo 25.92% (11 vendbanime). Qasjet tjera janë përmes rrugëve lokale apo 57.22%. Kjo formë e qasjes në rrugë nacionale dhe rajonale mundësohet për shkak të shtrirjes së dy rrugë nacionale (Pejë-Prishtinë (N9) dhe Klinë-Gjakovë (N9.1)) dhe 3 rrugë rajonale (Klinë-Istog (R104), Klinë-Skenderaj (R105) dhe Klinë-Gjakovë (R121)).

**Tabelë 23**: Numri i banorëve me qasje direkt në rrugët sipas kategorive dhe të asfaltuara

| Nr | Vendbanimi | Nr popullsisë (2020) | Qasje | Gjendja |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bërkovë | 246 | Rajonale | Asfalt |
| 2 | Binxhë | 117 | Lokale | Asfalt |
| 3 | Bokshiq | 433 | Lokale | Asfalt |
| 4 | Budisalc | 398 | Lokale | Asfalt |
| 5 | Caravik | 1,241 | Lokale | Asfalt |
| 6 | Çabiq | 862 | Lokale | Asfalt |
| 7 | Deiq | 376 | Lokale | Asfalt |
| 8 | Dobërdol | 339 | Rajonale | Asfalt |
| 9 | Dollc | 276 | Nacionale | Asfalt |
| 10 | Dollovë | 444 | Rajonale | Asfalt |
| 11 | Dranashiq | 21 | Lokale | Asfalt |
| 12 | Drenoc | 440 | Nacionale | Asfalt |
| 13 | Dresnik | 1,770 | Lokale | Asfalt |
| 14 | Dugajevë | 399 | Lokale | Asfalt |
| 15 | Dush | 241 | Lokale | Asfalt |
| 16 | Dush I Vogël | 196 | Lokale | Asfalt |
| 17 | Gllarevë | 1,784 | Nacionale | Asfalt |
| 18 | Grabanicë | 728 | Rajonale | Asfalt |
| 19 | Grapc | 206 | Lokale | Asfalt |
| 20 | Gremnik | 1,131 | Nacionale | Asfalt |
| 21 | Gjyrgjevik I Madh | 449 | Lokale | Asfalt |
| 22 | Gjyrgjevik I Vogël | 745 | Lokale | Asfalt |
| 23 | Jagodë | 197 | Lokale | Asfalt |
| 24 | Jashanicë | 1,784 | Lokale | Asfalt |
| 25 | Jelloc | 27 | Lokale | Asfalt |
| 26 | Kërnicë | 794 | Lokale | Asfalt |
| 27 | Klinafc | 480 | Rajonale | Asfalt |
| 28 | Klinë | 5,542 | Rajonale | Asfalt |
| 29 | Këpuz | 622 | Lokale | Asfalt |
| 30 | Kryshevë e Madhe | 585 | Lokale | Asfalt |
| 31 | Kryshevë e Vogël | 323 | Lokale | Asfalt |
| 32 | Leskoc | 239 | Lokale | Asfalt |
| 33 | Nagllavë | 67 | Lokale | Asfalt |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **34** | Përqevë | 1,005 | Lokale | Asfalt |
| **35** | Pjetërq I Epërm | 563 | Nacionale | Asfalt |
| **36** | Pjetërq I Poshtëm | 160 | Nacionale | Asfalt |
| **37** | Pograxhë | 366 | Rajonale | Asfalt |
| **38** | Qeskovë | 373 | Rajonale | Asfalt |
| **39** | Qupevë | 579 | Lokale | Asfalt |
| **40** | Radulloc | 353 | Rajonale | Asfalt |
| **41** | Ranoc | 353 | Lokale | Asfalt |
| **42** | Resnik | 399 | Lokale | Asfalt |
| **43** | Rixhevë | 870 | Nacionale | Asfalt |
| **44** | Rudicë | 446 | Rajonale | Asfalt |
| **45** | Sferkë | 2,448 | Lokale | Asfalt |
| **46** | Siqevë | 1,338 | Lokale | Asfalt |
| **47** | Stupë | 179 | Lokale | Asfalt |
| **48** | Shtupel | 771 | Lokale | Asfalt |
| **49** | Ujmirë | 544 | Lokale | Asfalt |
| **50** | Videjë | 663 | Lokale | Asfalt |
| **51** | Volljak | 929 | Lokale | Asfalt |
| **52** | Zabërgjë | 728 | Lokale | Asfalt |
| **53** | Zajm | 1,267 | Nacionale | Asfalt |
| **54** | Zllakuqan | 660 | Rajonale | Asfalt |

### 2.5.2. Transporti Hekurudhor

Klina ka lidhje të mira edhe përmes hekurudhës, duke qenë se në Klinë gjendet nyja e dytë hekurudhore e Kosovës, pas asaj në Fushë Kosovë. Në këtë nyje degëzohen drejtimet për Pejë dhe Prizren të cilat përmes Klinës lidhen me Fushë Kosovën për t'u degëzuar më tej për Shkup, Nish apo Beograd. Fatkeqësisht drejtimet hekurudhore paraqesin një potencial ende të pashfrytëzuar duke pasur parasysh qarkullimin minimal të trenave në hekurudhat e Kosovës.

**Rrugë urbane** – konsiderohen rrugët të cilat i lidhin lagjet brenda zonës urbane, dhe janë në gjendje shumë të mirë.

**Rrugë lokale** – konsiderohen rrugët të cilat i lidhin të gjitha vendbanimet e komunës duke u nisur nga qendra e vendbanimit dhe rrugët e tjera të rëndësishme, të cilat mundësojnë lidhje të mira ndërmjet qendrës administrative dhe vendbanimeve, përfshirë këtu edhe rrugët brenda lagjes së vendbanimit. Të tilla janë rrugët që lidhin vendbanimet e 54 fshatrave të komunës, me gjatësi prej 423.02 km ose 84.94% nga totali I përgjithshëm i rrugëve.

**Rrugë qasëse** - konsiderohen të gjitha sipërfaqet të cilat shfrytëzohen për realizimin e aktiviteteve bujqësore, socio-ekonomike dhe të tjera si në brendësi të vendbanimeve, po ashtu edhe në sipërfaqet e tjera të komunave kadastrale. Kjo kategori e rrugëve nuk është e asfaltuar, mirëpo rrugët të cilat shfrytëzohen për lidhjen hapësirave në brendësi të vendbanimeve, si dhe ato të cilat i lidhin vendbanimeve në thellësi të komunës, përkatësisht të viseve malore janë të shtruara me rërë dhe zhavorr. Ndërsa rrugët e tjera të kësaj kategorie janë rrugë të cilat shfrytëzohen për aktivitete bujqësore.



**Harta 22**. Infrastruktura rrugore (Burimi: Harta Zonale 2020)

## 2.5.3. Urat

Urat e identifikuara në territorin e komunës së Klinës i takojnë kategorisë së transportit rrugor, hekurudhor dhe ato të destinuara vetëm për këmbësor, varësisht nga kategoria e rrugëve ku janë të vendosura. Nga gjithsej 24 ura sa ka në territorin e komunës, 4.17% janë të ndërtuara në rrugë, vetëm për këmbësor janë 8.33%.

**Urat në rrugë nacionale**- Në rrugën nacionale Prishtinë-Peje, në fshatin Zajm, gjendet ura e vetme në rrugë nacionale në territorin e komunës së Klinës. Kjo urë është ndërtuar mbi lumin Drini i Bardhë dhe ka dimensionet 84 m në gjatësi dhe 9.30 m në gjerësi.

**Urat në rrugë regjionale**- Në rrugët rajonale R104 dhe R122 janë identifikuar gjithsej 4 ura. Ato janë ndërtuar mbi lumenjtë Lumëbardhi i Pejës (në fshatin Grabanicë), Ranovica (Zllakuqan), Klina (Klinë dhe Shtaricë). Gjatësia maksimale e urave në rrugët rajonale është 50 m, kurse gjerësia maksimale është 10 m.

**Urat në rrugë lokale** - janë ndërtuar mbi lumenjtë e njëjtë sipas lokacioneve Drini i Bardhë (Zllakuqan, Rudicë, Klinë, Rastokë, Krushevë), Ranovica (Ranoc), Klina (Ujëmirë, Jashanicë, Pogragjë), Lumëbardhi i Pejës (Dugajevë, Poterq), ura mbi lumin e Jashanicës dhe lumen Murgë në Caravik. Gjatësia maksimale e urave në rrugët lokale është 48 m, kurse gjerësia maksimale është 9.0 m.

**Urat hekurudhore** - janë të vendosura mbi lumenjtë Klina (3) dhe Drini i Bardhë (1). Gjatësia maksimale e urave hekurudhore është 85 m, kurse gjerësia maksimale është 7.0 m.

**Urat për këmbësor** - janë të vendosura mbi lumenjtë Klina (në qytetin e Klinës) dhe Drini I Bardhë (Klinë). Gjatësia maksimale është 48 m, kurse gjerësia maksimale është 4.5m.

**Tabelë 24.** Urat sipas kategorisë së rrugëve

| Përshkrimi | Nr. urave | % | Gjatësia min (m) | Gjatësia max (m) | Gjerësia min. (m) | Gjerësia max. (m) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Rrugë nacionale** | 1 | 4.17% | 84 | 84 | 9.30 | 9.30 |
| **Rrugë rajonale** | 4 | 16.67% | 16 | 50 | 7 | 10 |
| **Rrugë lokale** | 13 | 54.17% | 8 | 48 | 5 | 9 |
| **Hekurudhë** | 4 | 16.67% | 30 | 85 | 7 | 6 |
| **Këmbësor** | 2 | 8.33% | 35 | 48 | 3.5 | 4.5 |




**Harta 23.** Harta e Infrastrukturës së Transportit

## 2.5.4. Transporti Urban dhe Ndër-urban

Transporti publik përgjatë linjave lokale realizohet nga kompani private të transportit. Aktualisht janë 12 linja të transportit lokal (Tabela 25). Janë linja të përhershme, përveç muajve Korrik dhe Gusht në të cilët ka reduktime të linjave. Në aspektin e përfshirjes së vendbanimeve rezulton se vetëm 10 vendbanime nuk janë të përfshira në transport publik. Kurse vendbanimet që gravitojnë rreth rrugës nacionale Pejë-Prishtinë, dhe Klinë-Gjakovë shfrytëzojnë transportin ndërurban.

**Tabelë 25.** Linjat lokale të transportit publik

| LINJAT LOKALE TË TRANSPORTIT PUBLIK | | | |
|---|---|---|---|
| **Destinacioni** | | Frekuenca (ditore) | Statusi |
| **1** | Klinë-Leskoc dhe anasjelltas | 12 | Përhershme |
| **2** | Klinë-Siqevë dhe anasjelltas | 6 | Përhershme |
| **3** | Klinë-Ujmirë dhe anasjelltas | 19 | Përhershme |
| **4** | Klinë-Shtupel dhe anasjelltas | 8 | Përhershme |
| **5** | Klinë-Kerrnicë dhe anasjelltas | 17 | Përhershme |
| **6** | Klinë-Budisalc dhe anasjelltas | 6 | Përhershme |
| **7** | Klinë-Deiq-Grabanicë-Bokshiq dhe anasjelltas | 11 | Përhershme |
| **8** | Klinë-Grabanicë-Qeskovë-Kpuz dhe anasjelltas | 11 | Përhershme |
| **9** | Klinë-Resnik dhe anasjelltas | 8 | Përhershme |
| **10** | Klinë-Caravikë dhe anasjelltas | 17 | Përhershme |
| **11** | Klinë-Perqevë dhe anasjelltas | 6 | Përhershme |
| **12** | Klinë-Sferkë dhe anasjelltas | 18 | Përhershme |




**Harta 24**. Rrjeti i linjave lokale të transportit publik (burimi: Komuna e Klinës)

Linjat rajonale lidhin qytetin e Klinës me qytetet tjera me të cilat kufizohet ky i pari. Janë gjithsej katër linja rajonale, ku frekuenca më e lartë është ajo Klinë-Pejë (Tabela 26)

**Tabelë 26.** Linjat rajonale të transportit publik

| LINJAT RAJONALE TË TRANSPORTIT PUBLIK | | | |
|---|---|---|---|
| **Destinacioni** | | Frekuenca (ditore) | Statusi |
| **1** | Klinë-Pejë dhe anasjelltas | 60 | Përhershme |
| **2** | Klinë-Gjakovë dhe anasjelltas | 4 | Përhershme |
| **3** | Klinë-Rahovec-Prizren dhe anasjelltas | 4 | Përhershme |
| **4** | Klinë-Skenderaj dhe anasjelltas | 4 | Përhershme |




**Harta 25**. Rrjeti i linjave rajonale të transportit publik (Burimi: Komuna e Klinës)

Në përgjithësi vendbanimet e komunës së Klinës janë të përfshira në transportin publik, ku vendbanimet me qaje në rrugët nacionale dhe rajonale shfrytëzojnë edhe linjat transite që lidhin qytetet dhe ato interurbane. Numri i banorëve (sipas vendbanimeve) që kanë qasje në transportin publik është 34,295 apo 89.09%, kurse numri i banorëve që nuk kanë qasje në transportin publik është 4,201 apo 10.91%. Sipas listës së linjave të transportit, rezulton se 10 vendbanime nuk kanë qasje në transportin publik:

**Tabelë 27.** Vendbanimet pa qasje në transportin publik

| Nr | Vendbanimi | Nr popullsisë (2020) |
|---|---|---|
| **1** | Binxhë | 117 |
| **2** | Dugajevë | 399 |
| **3** | Dush | 241 |
| **4** | Grapc | 206 |
| **5** | Gjyrgjevik i Madh | 449 |
| **6** | Jashanicë | 1,784 |
| **7** | Jelloc | 27 |

| | | |
|---|---|---|
| **8** | Ranoc | 353 |
| **9** | Rudicë | 446 |
| **10** | Stupë | 179 |




**Grafiku 9.** Qasja e popullsisë në transport publik

## 2.6. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

### 2.6.1. Institucionet e Administratës

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur institucionet e administratës dhe kapacitetet e tyre hapësinore. Janë identifikuar institucionet, përkatësisht objektet përcjellëse të tyre, që shtrihen në kuadër të territorit të Komunës së Klinës.

**Tabelë 28.** Infrastruktura e administratës

| Institucionet administrative | Vendbanimi | Sip. e parcelës (ha) | Sip. e parcelës m² | Nr. i kateve |
|---|---|---|---|---|
| **Stacioni Policor** | Klinë | 0.73 | 7300 | |
| **Qendra për pajisje me dokumente identifikuese** | Klinë | 0.032 | 320 | |
| **Qendra për regjistrim te automjeteve** | Klinë | 0.01 | 100 | |
| **Komuna** | Klinë | 0.1 | 1000 | |
| **Zjarrfikës** | Klinë | 0.0753 | 753 | |
| **Gjykata** | Klinë | 0.1 | 1000 | |
| **Zyra e Vendit** | Drenoc | 0.15 | 1500 | |
| **Zyra e Vendit** | Grabanicë | 0.3118 | 3118 | |
| **Zyra e Vendit** | Sferk | 0.4970 | 4970 | |
| **Zyra e Vendit** | Gllarevë | 0.08 | 800 | |
| **Zyra e Vendit** | Caravikë | 0.3139 | 3139 | |
| **Zyra e Vendit** | Ujëmir | 0.2333 | 2333 | |
| **Zyra e Vendit** | Jashanicë | 0.5277 | 5277 | |
| **Zyra e Vendit** | Zllakuqan | 0.3353 | 3353 | |
| **Zyra e Vendit** | Shtupel | 0.8830 | 8830 | |
| **Zyra e Vendit** | Budisalc | 1.9814 | 19814 | |
| **Gjithsej** | | **6.3607** | **63607** | |




**Harta 26.** Harta e Institucioneve Publike dhe Sociale

## 2.6.2. Institucionet Arsimore

Struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Klinës është e organizuar në katër nivele: arsimin parashkollor (për fëmijët 5 - 6 vjeçar), arsimin fillor (I – V), arsimin e mesëm të ulët (VI – IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (X – XII). Numri total i objekteve të shkollave fillore të mesme të ulëta është 26. Ka edhe 2 objekte shkollore të shkollave të mesme publike dhe private si dhe një çerdhe publike e një private. Nga të gjitha shkollat fillore, 18 prej tyre janë shkolla amë dhe 8 të tjera janë shkolla satelite (paralele të ndara). Në procesin edukativo-arsimor të sektorit publik janë të angazhuar gjithsej 532 mësimdhënës. Numri total i nxënësve në të gjitha nivelet është 6,050, e që i bie rreth 11.4 nxënës/mësimdhënës.

***Çerdhe dhe kopshte*** – Komuna e Klinës posedon një çerdhe publike dhe një private. Çerdhja “Xhevë Lladovci“ ka 104 nxënës të moshës nën 5 vjec dhe ka kushte solide. Në të janë të angazhuar 11 mësimdhënës, 2 punëtorë administrativ dhe 5 punëtorë teknik. Ka një hapësirë prej 806.78 m² dhe oborr me sipërfaqe prej 39,606 m². Sipas këtyre shënimeve del se në këtë çerdhe ke 7.75 m² hapësirë shkollore për nxënës si dhe mesatarisht 8.5 nxënës për mësimdhënës. Në komunën e Klinës ka edhe një çerdhe private “Margherita Kids” në Zllakuqan me gjithsej 35 nxënës.

***Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët (i obliguar)*** - në tërë territorin e komunës mësimi fillor dhe i mesëm i ulët zhvillohet në 26 objekte shkollore, ndërsa mësimet i ndjekin 4,666 nxënës. Numri i kuadrit të mësimdhënësve të angazhuar në procesin edukativo-arsimor në këto shkolla është 409. Raporti i

hapësirës shkollore për nxënës është mesatarisht 2.71 m² hapësirë e brendshme shkollore/nxënës. Ndërsa shkollat me hapësirë shkollore më të vogël për kokë nxënësi janë shkolla "Ismet Rraci në Klinë (1.27 m2 për nxënës), shkolla "Motrat Qiriazi në Klinë (1.6 m2 për nxënës), shkolla "Esad Mekuli në Caravik (2.1 m2 për nxënës) si dhe shkolla "Dëshmorët" në Volljakë (1.7 m2 për nxënës). Raporti nxënës/mësimdhënës në këto hapësira shkollore sillet rreth 11.4 nxënës për 1 mësimdhënës. Mirëpo edhe në këtë raport ka dallime të theksuara në mes të shkollave të ndryshme të komunës.




**Grafiku 10.** Mesatarja e hapësirës shkollore për kokë nxënësi sipas shkollave

***Arsimi i mesëm i lartë*** - përfshinë tri vite të shkollimit për nxënësit e grup-moshës 15 deri 18 vjeç. Në komunë janë dy shkolla të mesme: Gjimnazi "Luigj Gurakuqi" dhe Shkolla e Mesme Teknike "Fehmi Agani" në Klinë. Numri i nxënësve që i ndjekin mësimet në këto shkolla është 1,280 nxënës. Numri i kuadrit të mësimdhënësve të angazhuar në procesin edukativo-arsimor në këto shkolla është 110. Raporti nxënës/mësimdhënës në shkollat e mesme është 11.6 nxënës për 1 mësimdhënës. Hapësira e brendshme në këto dy shkolla është 4,390.76 m² dhe kanë mesatarisht rreth 3.4 m² hapësirë për një nxënës. Në komunën e Klinës operon edhe shkolla private e mjekësisë "Keka Med" që ka gjithsej 121 nxënës.




**Harta 27.** Shtrirja hapësinore e Objekteve shkollore në komunën e Klinës

## 2.6.3.Institucionet Shëndetësore

Në komunën e Klinës shëndetësia është e organizuar në sektorin publik, ku ofrohen shërbime të nivelit parësor, si dhe në sektorin privat i cili ofron shërbime parësore të lëmive të specializuara mjekësore. Në sektorin publik, kujdesi shëndetësor është i organizuar në 14 institucione shëndetësore të mjekësisë familjare:

- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në qytetin e Klinës;
- 3 Qendra të Mjekësisë Familjare në Ujmir (objekti i ri dhe ai i vjetër), Zllakuqan dhe Sferkë;
- 10 ambulanta të Mjekësisë familjare të organizuara në vendbanimet Jashanicë e Ulët, Jashanicë e Epërme, Shtupel (objekti i vjetër dhe objekti i ri), Leskoc, Budisalc, Jagodë, Drenoc, Grabanicë, Gllarevë dhe Cerravik;
- Ekzistojnë edhe dy ambulanta të tjera në fashtrat Dranashiq dhe Berkovë por ato nuk janë funksionale.

**Tabelë 29.** Objektet shëndetësore në komunën e Klinës

| | Numri | Mjek të | Teknik | Sipërf. e parcelës | Sipërf. Ndërtuar |
|---|---|---|---|---|---|
| **QKMF** | 1 | 25 | 94 | 0.448 | 3954 |
| **QMF** | 3 | | 6 | 0.7158 | 930.16 |
| **AMF** | 10 | | 8 | 2.836 | 1334.07 |

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Klinë, si bartëse e kujdesit primarë, është e vendosur në qytetin e Klinës dhe mbulon me shërbime territorin e Klinës me të gjitha vendbanimet. Në këtë institucion janë të punësuar gjithsej 136 punonjës, prej tyre 7 mjek që kanë bazë kualifikuese fakultetin, 11 mjek në specializim, 7 mjek të mjekësisë familjare. Punojnë po ashtu edhe 94 infermier dhe teknik. Si dhe 17 staf tjetër mbështetës administrativ dhe Teknik. Në këtë qendër puna është e organizuar në dy ndërrime, ndërsa emergjenca ofron shërbime 24 orë.




**Harta 28**. Shtrirja e objekteve shëndetësore në komunën e Klinës

### 2.6.4. Institucionet e Mirëqenies Sociale

Për problemet e shumta sociale në Komunën e Klinës kryesisht përkujdesen Qendra për Punë Sociale dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. QPS merret me: Mbrojtjen Sociale të Fëmijëve dhe Rinisë, përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror, mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta dhe atyre me sjellje të çrregulluara, mbrojtjen sociale të të rriturve në nevojë për kujdes social etj.

**Tabelë 30.** Mirëqenia Sociale në komunën e Klinës

| Kategoria | Periudhat tremujore gjatë vitit 2020 | | | |
|---|---|---|---|---|
| | TM1 | TM2 | TM3 | TM4 |
| Nr. Familjeve | 855 | 860 | 867 | 889 |
| Nr. Anëtarëve | 3,563 | 3,571 | 3,617 | 3,693 |
| Pensionet bazike të moshës | 3,409 | 3,500 | 3,569 | 3,567 |
| Pensionet kontribut paguese të moshës | 657 | 668 | 669 | 666 |
| Pensionet e personave me aftësi të kufizuara | 344 | 415 | 415 | 434 |
| Familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara | 51 | 52 | 53 | 54 |
| Pensionet familjare | 42 | 36 | 39 | 41 |
| Pensionet paraplegjike dhe tetraplegjike | 66 | 64 | 58 | 56 |
| Skema për kompensimin e punonjësve të arsimit për vitet 90/91 deri në vitin 98/99 | 237 | 245 | 251 | 255 |
| Pensionet për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës | 528 | 534 | 532 | 532 |
| Pensionet e veteranëve të luftës | 1,704 | 1,704 | 1,705 | 1,705 |
| Pensionet për trupat mbrojtëse të Kosovës | 14 | 15 | 16 | 16 |
| Pensionet për forcat e sigurisë së Kosovës | 12 | 12 | 12 | 12 |
| Kompensimet për personat e verbër | 42 | 42 | 41 | 40 |

### 2.6.5. Institucionet Kulturore dhe sportive

*Kultura:* Në komunën e Klinës ekzistojnë 3 objekte të rëndësishme kulturore-artistike në të cilat zhvillohen aktivitete në fusha të ndryshme të artit dhe kulturës. Këto objekte janë: Qendra e Kulturës "Jehona e Dukagjinit" e themeluar në vitin 1969, Teatri amator "Osman Gashi" i themeluar në vitin 1970 si dhe Biblioteka "Kongresi i Manastirit" e themeluar në vitin 1968.

*Rinia:* Rinia paraqet grup-moshën më të madhe të popullsisë në këtë komunë, njëjtë si në nivel të Kosovës. Mbi 50 % e popullsisë së përgjithshme përbëhet nga rinia nën moshën 30 vjeç. Kushtet për zhvillimin e aktiviteteve rinore në Klinë nuk janë edhe aq të volitshme. Aktivitetet rinore zhvillohen në stadiumin e qytetit "18 Qershori", Palestrën sportive "Adem Jashari", Qendrën rinore si dhe në hapësira të tjera në shkolla të ndryshme të komunës.

*Sporti:* Sporti në komunën e Klinës zhvillohet në mënyrë ekipore dhe individuale. Në këtë komunë zhvillohen lëmi të ndryshme të sportit si: futboll, hendboll, basketboll, shah etj. Në këtë komunë e Klinës janë: Dy klube të futbollit, dy klube të volejbollit, dy klube të hendbollit, një klub I basketbollit, një klub të boksit, dy klube të ping-pong, një klub të biçiklistave, një klub të shahut.

Gjithashtu në komunën e Klinës është edhe shoqata e gjuetarëve, shoqata e peshkatarëve, si dhe pesë shkolla të futbollit. Sa i përket terrene sportive në komunë janë dy terrene sportive të futbollit të madh, një palestër sportive e cila është publike, katër terrene sportive me bari sintentik për futboll të vogël të cilat janë private.

### 2.6.6. Hapësirat e Gjelbërta dhe Parqet publike

Sot qytetet dhe lagjet e reja që po ndërtohen në Kosovë duhet të planifikohen dhe ndërtohen sipas disa kritereve mjedisore, që ndryshe njihen si principe ekologjike në rregullimin e qyteteve. Sipas standardeve minimale të sugjeruara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) dhe të miratuara nga Organizata e Bujqësisë dhe Ushqimit e Kombeve të Bashkuara (FAO) kufiri minimal i hapësirës së gjelbër në qytete është 9 m2/banor. Ndërsa sipas standardeve të aprovuara me UA nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, ky standard në Kosovë është 2 m2/banor në kuadër të vendbanimit dhe për brezat përgjatë rrjedhave ujore, si dhe 1 m2/banor për brezat përgjatë rrugëve.
Hapësirat e gjelbërta në Komunën e Klinës përfshijnë parqet urbane të Qytetit të Klinës, gjelbërimin e rrugëve (trotuareve), përgjatë rrugëve kryesore të qytetit dhe rreth lumit "Drini", parqet në disa fshatra, hapësirat e gjelbra afër godinave institucionale, shkollave, lapidarëve, varrezat e dëshmoreve etj. Mirëpo, këto hapësira, në zonën urbane janë në konkurrencë të vazhdueshme me ndërtimet duke rrezikuar të humbasin nga presioni i ndërtimit. Sa i përket sipërfaqeve aktuale të HHP-ve në qytetin e Klinës, nga inventarizimi i sipërpërmendur janë marrë të dhëna mbi sipërfaqet e hapësirave në raport me numrin e banorëve, e të cilat janë paraqitur në tabelën në vijim.

**Tabelë 31.** Hapësirat e hapura dhe të gjelbra publike në Komunën e Klinës, sipas kategorizimit të tyre

| Nr | Klasifikimi i hapësirave sipas përdorimit | Sipërfaqja ne m2 | Numri i banorëve | Sipërfaqet m2 /banorë. |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Hapësirat e gjelbra | 468,800 | 30,503 | 15.36 |
| 2 | Parqe | 866,000 | 30,503 | 28.39 |
| 3 | Pishinë | 14,500 | 30,503 | 0.47 |
| 4 | Sport | 120,800 | 30,503 | 3.96 |
| 5 | Kulturë | 6,100 | 30,503 | 0.19 |
| | Gjithsej hapësirë e hapur publike dhe të gjelbra | 1,476,200 | 30,503 | 48.39 |

Nga tabela e lartshënuar është evidente se standardet lokale ekzistuese dhe ato ndërkombëtare janë mirë të plotësuara e madje të tejkaluara për hapësira publike. Në Komunën e Klinës, sipërfaqja aktuale e hapësirave të hapura publike për parqe është 28.39 m2, ndërsa për hapësira të gjelbra është 15.36 m2/banor.

## 2.6.7. Objektet e religjionit dhe varrezat

*Objektet Fetare:* Komuna e Klinës ka objekte fetare në disa vendbanime, mirëpo jo në të gjithat. Numri total i objekteve fetare të evidentuara në komunë është 16. 8 nga këto objekte janë kisha katolike, 1 është kishë ortodokse si dhe 7 janë xhamia. Kishat katolike gjenden në vendbanimet Klinë, Dobërdol, Deiq, Zllakuqan, Budisalc, Jagodë, Poterq, Dugajevë, ndërsa kisha ortodokse që gjendet në vendbanimin Budisalc. Xhamitë gjenden në vendbanimet Klinë, Jashanicë, Gllarevë, Kpuz, Jashanicë e Poshtme, Sferkë dhe Gjurgjevik i Madh.

Gjithësej sipërfaqja e parcelave kadastrale ku janë të vendosura objektet fetare është 56,765 m² apo rreth 5.6 ha. Sipërfaqja e parcelave kadastrale ku gjenden kishat është 45,315 m² apo rreth 4.5 ha, ndërsa sipërfaqja e parcelave kadastrale ku gjenden xhamitë është 11,450 m² apo rreth 1.1 ha.

*Varrezat Publike:* Çdo vendbanim i banuar në komunën e Klinës ka varreza. Në disa vendbanime ka dy ose ma shumë varreza. Një pjesë e varrezave i plotëson kërkesat edhe për 8 vitet e ardhshme, mirëpo në shumicën prej tyre ka mungesë të  infrastrukturës, mirëmbajtjes dhe menaxhimit.

Sipërfaqja totale e parcelave kadastrale ku gjenden varrezat në komunën e Klinës është 722,918 m² apo rreth 72.2 ha.




**Harta 29**. Objektet Fetare dhe Varrezat Publike në Komunën e Klinës

## 2.7. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

### 2.7.1. Ndotja e mjedisit

Ndotja e mjedisit në tërë territorin e Kosovës është një problem mjaft serioz dhe është prezent gati kudo. Në komunën e Klinës aktivitete të ndryshme humane ndikojnë drejtpërsëdrejti në degradimin e mjedisit, përfshirë këtu ndikimin negativ në ekosisteme. Ky degradim shkakton ulje të kualitetit në mjedis, zvogëlim të mundësisë së përdorimit të biodiversitetit për zhvillim ekonomik, si dhe zvogëlim të mirëqenies së popullatës humane.
Faktorët që me së shumti kanë ndikuar në uljen e cilësisë së mjedisit në Komunën e Klinës janë: Zënia e tokës- zgjerimi i zonave të banimit, ndërtimet pa leje, ndërtimi i rrugëve të reja dhe zgjerimi i atyre ekzistuese, ndërtimet për qëllime komerciale etj. Degradimi i lumenjve për shkak të aktivitetit të ndërtimit, devijimit të shtretërve të lumenjve, nxjerrjes së rërës etj. shpesh rezulton me daljen e lumenjve nga shtrati dhe vërshime, sidomos në stinën e pranverës dhe vjeshtës kur edhe ka më shumë reshje.

***Ujërat e Zeza-*** ujërat e zeza që vijnë nga amvisëria si dhe nga aktivitetet e ndryshme industriale nuk trajtohen paraprakisht, ato derdhen drejtpërsëdrejti në lumenj. Kjo shkakton dëme të konsiderueshme në mjedis, dëmtim të peizazhit, florës dhe faunës si dhe dëme në shëndetin e njeriut.

***Bujqësia-*** Komuna e Klinës ka një sipërfaqe të madhe në të cilën kultivohen produkte bujqësore, për rritjen e të cilave përdoren plehra artificiale si dhe pesticide të ndryshëm. Ndikimi i plehrave dhe pesticideve është i shumëfishtë, duke filluar nga ndotja e ujërave nëntokësore, ujërave sipërfaqësore, tokës, florës dhe faunës. Ato kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe indirekt edhe në shëndetin e njeriut.

***Mbeturinat-*** një sasi e konsiderueshme e mbeturinave në Komunës së Klinës hedhen jashtë deponive, si p.sh. përgjatë lumenjve dhe përroskave, si dhe vende të ndryshme. Mbeturinat ndikojnë negativisht në peizazhin e zonës, në florë dhe faunë, si dhe në shëndetin e njeriut.

Gjatë vitit 2021 janë identifikuar 31 deponi ilegale të mbeturinave në komunën e Klinës.

***Eksploatimi i gurit dhe gurthyesit***: janë një faktor tjetër shqetësues në Komunën e Klinës e të cilët shkaktojnë probleme të mëdha në mjedis, sidomos në peizazhin e zonës, por edhe në shëndetin e njeriut.

***Prerja ilegale e pyjeve-***në një pjesë të madhe të sipërfaqes pyjore të Komunës së Klinës hasen aktivitete të prerjes ilegale të pyjeve. Edhe ky aktivitet degradues ndikon negativisht në mjedis, me pasoja direkte për ekosistemin, biodiversitetin si dhe shëndetin e njeriut.




**Harta 30.** Harta e Ndotjes së Mjedisit

## 2.7.2. Ndotja e ajrit

Monitorimi i cilësisë së ajrit është vlerësim sistematik dhe afatgjatë i niveleve të ndotësve, duke matur cilësinë e ajrit në një rrethinë të caktuar. Monitorimi i cilësisë së ajrit bëhet për grimcat e pluhurit (PM10 dhe PM2.5) si dhe katër lloje të gazrave (NO2, SO2, O3 dhe CO)[15].

Monitorimi i cilësisë së ajrit në Kosovë është i ndarë në dy zona: Aglomerati -AKS1 me stacionet IHMK, Rilindja, Obiliqi, Dardhishtë dhe Palaj si dhe Zona ZKS1, me stacionet në Gjilan, Pejë, Prizren, Drenas, Brezovicë, Mitrovicë dhe Hani i Elezit.

**Tabelë 32.** Të dhënat për cilësinë e ajrit sipas parametrave dhe stacioneve monitoruese në aglomeracionin KS1 për vitin 2022 – Stacioni i monitorimit Pejë

| Vendi | Muaji | PM10 | PM2.5 | O3 | SO2 | NO2 | CO |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pejë** | Janar | 38.9 | 33 | 41.8 | 8.4 | 24.9 | 1.2 |
| **Pejë** | Shkurt | 32.4 | 25 | 51.3 | 8.3 | 22.8 | 1.2 |
| **Pejë** | Mars | 26.2 | 20.3 | 76.6 | 8.4 | 16.5 | 1.1 |
| **Pejë** | Prill | 15.5 | 10.7 | 76.2 | 7.7 | 11.1 | 0.2 |
| **Pejë** | Maj | 14.7 | 8.2 | 73.4 | 7.8 | 8.5 | 0.1 |
| **Pejë** | Qershor | 13.5 | 7.9 | 72.1 | 8.5 | 8 | 0.2 |
| **Pejë** | Korrik | 11.5 | 6.6 | 91.2 | 9.7 | 8.2 | 0.2 |
| **Pejë** | Gusht | 13.4 | 77 | 79.5 | 11 | 10.2 | 0.3 |
| **Pejë** | Shtator | 11.4 | 7.4 | 51.7 | 12.9 | 10.7 | 0.3 |
| **Pejë** | Tetor | 23 | 14.9 | 42.4 | 16.2 | 17.1 | 0.5 |
| **Pejë** | Nëntor | 39.2 | 28.9 | 25.4 | 4 | 24.7 | 1.1 |
| **Pejë** | Dhjetor | 43 | 36.4 | 17 | 9 | 23 | 1.1 |
| **Pejë** | Mes 2022 | 23.56 | 17.25 | 58.22 | 9.33 | 15.48 | 0.63 |

Vlera mesatare mujore për parametrin PM10 ka rezultuar si më e lartë në stacionin monitorues të Pejës. Vlera mesatare më e lartë është regjistruar në stacionin e Pejës më 43 µg/m3, dhe atë gjatë muajt Dhjetor 2022.

Të dhënat tregojnë se nuk ka pasur tejkalime të vlerave limite të mesatares vjetore sipas standardit 40 µg/m3 parametrin PM10. As në parametrat e tjerë të monitoruar nuk janë regjistruar tejkalime të vlerave limite të mesatares vjetore në asnjë nga stacionet monitoruese. Në anën tjetër, numri i ditëve me tejkalime për 24 orë për parametrin PM10 tregon se ka pasur tejkalime të vlerave limite ditore të standardit 50 µg/m3 për këtë parametër.

Numri më i madh i rasteve me tejkalime është regjistruar gjatë sezonit vjeshtë – dimër, e që është si rezultat i përdorimit të lëndëve djegëse për ngrohje. Gjatë kësaj sezone edhe kushtet meteorologjike ndikojnë shumë në cilësinë e ajrit për shkak të lagështisë së ajrit, temperaturave të ulëta, mjegullave etj.

[15] https://airqualitykosova.rks-gov.net/




**Figura 7.** Vlerat kufitare për parametrat në stacionin e monitorimit të cilësisë së ajrit Pejë

### *Cilësia e ajrit në katër lokacionet e Komunës së Klinës*

Monitorimi i cilësisë së ajrit në Komunën e Klinës është realizuar me anë të pajisjes Aeroqual nga studentët e Universitetit "Haxhi Zeka" dhe "Fehmi Agani" dhe atë gjatë muajit Qershor. Lokacionet në të cilat janë bërë matjet janë: Sheshi "Ndue Perlleshi", Sheshi "Mujë Krasniqi", Tek hekurudhat dhe Sheshi "Faruk Elezi". Parametrat të cilët janë matur janë: PM2.5, PM10, NO2, SO2, O3, CO, temperatura si dhe lagështia e ajrit.




| | Sheshi" Ndue Perlleshi" | Sheshi "Mujë Krasniqi" | Tek hekurudhat e trenit | Sheshi "Faruk Elezi" |
|---|---|---|---|---|
| PM2.5 | 18.96 | 15.2 | 9.86 | 18.42 |
| PM10 | 32.64 | 27.5 | 24.1 | 36.04 |
| NO2 | 12.1 | 17.95 | 7.7 | 12.57 |
| O3 | 10.75 | 9.54 | 19.27 | 13.73 |
| SO2 | 2.4 | 2.2 | 3.1 | 2.5 |
| CO | 0.3 | 0.2 | 0.5 | 0.3 |

Figura 8. Cilësia e ajrit të jashtëm për Komunën e Klinës gjatë muajit Qershor, 2023

Duke u bazuar në Indeksin e Cilësisë së Ajrit (tab.4.) gjendja e cilësisë së ajrit në Komunën e Klinës është e pranueshme për parametrat PM10 dhe PM2.5, ndërsa e mirë për parametrat e tjerë në të gjitha lokacionet.

***Ndotja e ajrit***
Ndotja e ajrit në komunën e Klinës kryesisht shkaktohet nga trafiku dhe gurëthyesit.
Sa i përket trafikut, rrjeti i propozuar i trafikut në territorin e Komunës ka paraparë shkurtimin e distancave në mes të vendbanimeve dhe përmirësimin e kualitetit të rrugëve, gjë që ndikon edhe në zvogëlimin e ndotjes. Ndikim të madh në zvogëlimin e nivelit të ndotjes së ajrit kanë edhe brezat e gjelbërimit përgjatë rrugëve.
***Mbrojtja e ajrit***
Në mënyrë që të mbrohet ajri, është e nevojshme që të kontrollohet lokacioni për prodhimin e pajisjeve dhe llojin e teknologjisë, llojin e energjisë dhe të stimulohet energjia e pastër dhe energjia ripërtëritëse

### 2.7.3.Ndotja e ujit
Zhvillimi industrial, urbanizimi dhe bujqësia intensive janë vetëm disa prej faktorëve që ndikojnë në ndotjen e ujërave. Përkundër angazhimit të vazhdueshëm, shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve tona ujore. Presionet në ujëra vijnë kryesisht si pasojë e rritjes së vëllimit të ujërave të shkarkuara pa trajtimin adekuat fizik, kimik e biologjik. E gjithë kjo ndikon në rritjen e vlerave të parametrave fizik, kimik dhe mikrobiologjik në trupat ujorë. Presione të tjera nga reshjet janë shpëlarja e tokave bujqësore dhe sipërfaqeve të tjera ndotëse me ç‘rast vije deri te rritja e materieve të suspenduara, materive inorganike (fertilizerët-N, P, K, NH4 + etj.) dhe atyre organike (PCB, Herbicide, etj). Ndër presionet më të mëdha në trupat ujorë janë shkarkimet industriale të veprimtarive të ndryshme.

***Rrjedhat e Ujit***
Rrjedhat e ujit të cilat kalojnë nëpër territorin e komunës nuk janë të rregulluara, me përjashtime të vogla, prandaj gjatë reshjeve të pandërprera apo gjatë shkrirjes së borës mund të shkaktohen dëme. Për shkak të mos sigurimit të brigjeve, të gjitha këto rrjedha të ujërave dhe disa rrjedha më të vogla në disa vende rrënojnë brigjet si dhe ndryshojnë drejtimin e shtratit duke bartë me veti një pjesë të madhe të tokës.

***Cilësia e ujërave sipërfaqësore***
Monitorimin e ujërave të lumenjve në territorin e Republikës së Kosovës e bën Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Cilësia e këtyre lumenjve përcaktohet në bazë të analizave fizike, kimike dhe metaleve të rënda. Rrjeti i monitorimit ka gjithsej 54 vendmostrime (stacione monitoruese). Parametrat fizik që aktualisht monitorohen janë 10 parametra fizikë (maten 11 herë në vit), 39 parametra kimik (maten 11 herë në vit) dhe 8 metale të rënda (maten 2 herë në vit).
***Sasia e ujërave sipërfaqësore***
Përveç cilësisë së ujërave, IHMK bën edhe monitorimin e sasisë së ujërave. Monitorimi i sasisë së ujërave bëhet përmes rrjetit hidrometrik, i cili përbëhet nga një numër i stacioneve matëse nëpër lumenj e ku kryhen matje për sasinë e ujit. Në këto stacione matet Niveli (H) dhe Prurja (Q). Në tabelat vijuese janë prezantuar të dhënat për nivelin e ujit H (cm) dhe prurja (Q) në stacionet hidrometrike të realizuara për vitin 2021 dhe trendi në raport me vitin 2020.

**Tabelë 33.** Vlerat mesatare vjetore të nivelit te ujit H (cm) sipas stacioneve matëse për vitin 2021 dhe trendi në raport me vitin 2020

| Stacioni | Mes. (cm) 2021 | Trendi në raport me vitin 2020 |
| --- | --- | --- |

| | | |
|---|---|---|
| **Klinë** | 49 | **Nuk ka matje** |

### 2.7.4. Ndotja e tokës

Gjatë viteve të fundit, Komuna e Klinës ka bërë përparime të dukshme, por sfidat si degradimi i tokës në zonat rurale dhe përreth zonave urbane mbeten ende të pranishme. Këto probleme kanë ardhur si pasojë e zgjerimit të pakontrolluar urban, ndotjes mjedisore dhe shfrytëzimit të pakujdesshëm të burimeve natyrore. Për një menaxhim të qëndrueshëm të këtij resursi jetik, është e nevojshme që toka të trajtohet në mënyrë të integruar duke u mbështetur në politika të koordinuara ekonomike, sociale dhe mjedisore.
Për të ruajtur ekuilibrin midis shfrytëzimit të tokës dhe mbrojtjes së mjedisit, duhet të parandalohet shfrytëzimi i tepruar i resurseve natyrore dhe urbanizimi i pa kontrolluar. Zgjatja e veprimtarive që dëmtojnë mjedisin rrezikon shëndetin publik, ul cilësinë e jetës dhe rrit ndjeshëm koston e zhvillimit ekonomik. Në Klinë, si në pjesën më të madhe të Kosovës, tokat përreth zonave urbane përdoren kryesisht për ndërtim, ndërsa zonat rurale mbeten të fokusuara në aktivitetet bujqësore.
Shkaqet kryesore të degradimit të tokës në Klinë përfshijnë shfrytëzimin e pa kontrolluar të burimeve natyrore, ndërrimin e destinimit të tokës, përdorimin e tepruar të pesticideve dhe plehrave kimike, ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe mbeturinat e depozituara jashtë zonave të përcaktuara. Gjithashtu, ndotja e lumenjve dhe burimeve ujore, së bashku me krijimin e deponive ilegale, kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në degradimin e tokës në komunë.
Në Klinë sikur edhe në disa raste tjera në Kosovë është dyshuar për ndotje të tokës dhe ujit nga materie radioaktive (Uranium, Cesium, Tritium) në ish kazermën e ushtrisë dhe disa vendbanime dhe për këtë qëllim komuna ka hulumtuar rastin duke marrur dhe analizuar mostra të dheut dhe ujit në qytet tek ish kazerma e ushtrisë, në fshatin Zllakuqan dhe pas analizave laboratorike të akredituara ka rezultuar se të gjitha vlerat e ndotjeve/rrezatimeve në ujë dhe tokë janë nën vlerat e lejuara.

### 2.7.5. Ndotja nga zhurma

Në mënyrë që vendbanimet të mbrohen nga tejkalimi i nivelit të zhurmës së lejuar, është e nevojshme të ndërtohen pengesa dhe të *zhvillohen* breza të gjelbër në mes të korridoreve të automjeteve motorike dhe vendbanimeve. Shfrytëzuesi i pajisjeve të cilat prodhojnë zhurmë dhe vibracion mund të vënë në qarkullim ose të përdorin pajisjet sipas kushteve të parapara për aplikimin e masave mbrojtëse, për zvogëlimin e zhurmës dhe vibracionit, respektivisht të bëjë përdorimin e impianteve, pajisjeve, makinave, mjeteve transportuese dhe aparateve të cilat lirojnë zhurmë deri në nivelin e lejuar me ligj të veçantë.

### 2.7.6. Tërmetet

Territori i Kosovës i është nënshtruar edhe lëkundjeve të forta nga tërmetet, vatrat e të cilëve kanë qenë jashtë territorit të Kosovës, në Maqedoninë Veriore, Shqipëri, Malit të Zi dhe Serbi. Këto dy dukuri, sizmiciteti lokal autokton dhe sizmiciteti që shkaktohet prej tërmeteve të largëta, dëshmojnë për renditjen e Kosovës në radhën e territoreve me një aktivitet të lartë sizmik. Ky aktivitet mjaft i lartë dikton nevojën për ndërmarrjen e studimeve të duhura të gjithanshme, në mënyrë që, në bazë të analizës dhe sintezës së të dhënave komplekse të fituara, të jepet një tablo e plotë, reale dhe e besueshme për vlerësimin e rrezikut sizmik të Kosovës. Në territorin e komunës së Klinës janë vërejtur thuajse të gjitha dridhjet sizmike të cilat janë bërë në hapësira me epiqendra te cilat e rrethojnë (Shkupi, Banjalluka, Bregdeti i Malit të Zi, Kopaoniku, Rumania, Shqipëria etj.). Pasojat

e dëmeve janë manifestuar me dëme të vogla materiale dhe gati të parëndësishme në disa objekte më të vogla të ndërtuara nga materialet e dobëta ndërtimore . Sipas interpretimit të hartave sizmike të hartuar në Entin Sizmik – Beograd ne vitin 1973 territori i komunës së Klinës është në ndikimin 6°- 7°(gradë) të intensitetit sizmik MSC. Gjithashtu sipas të dhënave hartografike me të cilat disponon komuna e Klinës shtrihen plasjet e mbuluara dhe pak të dukshme si dhe plasjet e mbuluara gjë që tregon karakteristika specifike tektonike të këtij subregjioni.
Në rast të tërmeteve me forcë 6° të MSC, ndërtesat e ndërtuara nga guri i papërpunuar, shtëpitë e vjetra fshatare, ndërtesat nga çerpiqet, dhe shtëpitë nga balta mund të pësojnë dëme të rënda deri në shkallën e I-rë, me mundësi të rrallë për çarje të gjerësisë 1 cm dhe rrëshqitje të tokës në rajonet malore. Ndërtesat e ndërtuara me beton arme dhe shtëpitë e mira nga druri mund të preken nga dëmtime të shkallës së I-rë në rast të tërmeteve me forcë 7° të MSC, ndërsa ndërtesat e ndërtuara me tulla të pjekura, materiale të fabrikuara, gurë të gdhendur, dhe konstruksione pjesërisht drunore mund të kenë dëmtime të shkallës së II-të. Numri më i madh i ndërtesave nga guri i papërpunuar, shtëpitë e vjetra fshatare, ndërtesat nga çerpiqet dhe shtëpitë nga balta mund të pësojnë dëme të shkallës së III-të dhe në raste të jashtëzakonshme edhe të shkallës së IV-të. Në kushte të veçanta, kyçjet në përçuesit e ujit mund të dëmtohen dhe të shkaktojnë çarje, ndryshime në nivelet e ujit dhe shterje të bedemeve rënore dhe zhavorore.

### 2.7.8. Erozioni

Duke ju falënderuar gjendjes së përgjithshme të vegjetacionit, bazës gjeologjike, pjerrësisë së terrenit, ndikimit të pavolitshëm të kushteve klimatiko-meteorologjike dhe hidraulike e sidomos ndikimit të njeriut, proceset e erozionit kanë marrë përpjesa shqetësuese sepse një pjesë e madhe e territorit është nën ndikimin shkatërrues të erozionit për shkak të ujërave vërshuese. Me erozion të kategorisë së III-të, IV-të dhe II-të është përfshirë afër 50% e territorit të komunës së Klinës.



**Harta 31.** Harta e Erozionit

## 2.7.9. Vërshimet

Sa i përket vërshimeve, probleme të mëdha ka pasur nga lumi Klina, por me rregullimin e shtratit të lumit shumica e problemeve janë evidentuar. Rregullimi i shtratit është nga derdhja në Dri deri te burimi i Jarinës, gjegjësisht, deri te ngushtimi natyral i lumit (gryka). Profili i rregulluar është trapez i dyfishtë me shtrat minor dhe major me gjerësi 36.00 m dhe thellësi 3.1 m, ndërsa i pranon ujërat maksimale 100 vjeçare. Hedhja e mbeturinave të ndryshme (material ndërtimor, makina të vjetra, etj) përgjatë shtratit të lumit e të cilat pengojnë rrjedhjen e natyrshme të ujit në të përbëjnë rrezik permanent për vërshime dhe ndotje të ujit. Në komunën e Klinës lumi Drini i Bardhë rrjedhë si lum fushor me shtrat të ndryshuar. Në pranverë dhe vjeshtë kur të reshurat janë më të mëdha, respektivisht kur bora shkrihet, ky lum vërshon nga shtrati dhe i vërshon tokat afër bregut të lumit, duke marrë me vete pjesën më kualitative të tokës. Lumenjtë e vegjël si lumi Jashanicë, lumi i Renocit, përroi i Volujakës etj. të cilët janë lumenj me tipare karakteristike për përroskat malore (lumenj të vegjël) me oscilime shumë të mëdha të sasisë së ujit e të cilat gjatë vitin paraqesin po ashtu rrezik- sado të ulët- të vërshimeve lokale. Gjatë kohës së thatë në shumicën e këtyre lumenjve ka shumë pak ujë ose nuk ka ujë fare, kurse gjatë kohës me reshje shpesh ndodhë që të ketë vërshime lokale. Me Planin Hapësinor për Monumentin e Natyrës me Rëndësi të Veçantë “Ujëvarat e Mirushës” të hartuar nga MMPH në vitin 2013 është paraparë edhe pastrimi i shtratit të lumit Mirusha nga bimët e vetë-rritura, zgjerimi i shtratit të lumit sipas pronësisë, eliminimi i pengesave natyrore në shtrat si dhe pastrimi dhe ndërtimi i brezave mbrojtës përgjatë shtratit. Të gjitha këto masa do të zvogëlonin apo minimizonin fatkeqësinë natyrore të vërshimeve.




**Harta 32.** Harta e zonave të rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore

## 2.7.10. Rrëshqitjet e borës

Periudha e lajmërimit të borës është kryesisht prej muajit Nëntor deri në Prill. Është me rëndësi të thuhet se ky rajon posedon një klimë mjaft të butë dhe pa variacione karakteristike ekstreme në temperaturë të ajrit gjatë vitit. Kjo vije për shkak të ndikimit të mediteranit i cili depërton me anë të lumit Drini i Bardhë. Rrjedhimisht mund të thuhet se në komunën e Klinës nuk ka ndonjë rrezik serioz për rrëshqitjen e borës.

## 2.7.11. Erërat

Erërat më të shpeshta janë nga drejtimi Perëndim dhe Jug-Perëndim. Më të rralla janë erërat nga drejtimi Veri-Perëndim dhe Lindje. Fuqia e erërave nuk është e madhe (nuk kalon 2,1 shkallë të Boforit).

## 2.7.12. Breshëri

Breshëri është dukuri e rrallë e reshjeve atmosferike dhe për nga sasia e përgjithshme e ujit paraqet një vlerë të papërfillshme, mirëpo për shkak të veprimit mekanik, sidomos gjatë periudhave vegjetative, konsiderohet që duhet ti kushtohet interes dhe vëmendje e posaçme. Në vjetarët hidrometerologjik evidentohet se në regjionin e Pejës, dukuria e breshrit shfaqet 0.7 ditë gjatë vitit. Muajt me rrezikshmëri më të madhe nga breshëri në rajonin e Pejës janë muajt Maj, Qershor, Korrik, duke mos i përjashtuar as muajt Prill dhe Shtator.

### 2.7.13. Akulli

Temperatura mesatare e ajrit ne Klinë është 10.8˚C. Në Korrik arrihet temperatura maksimale absolute prej 37.6˚C, ndërsa në Shkurt temperatura minimale absolute zbret deri në -11,8˚C. Amplituda mesatare është 46,1˚C. Nga kjo mund të vihet në përfundim se në Komunën e Klinës nuk ka ndonjë rrezik serioz nga akulli.

### 2.7.14. Thatësira

Në territorin e komunës së Klinës janë të pranishme edhe thatësirat të cilat nganjëherë zgjasin edhe nga dy muaj. duke u shkaktuar dëme të mëdha zonave bujqësore.

Duke pasur parasysh faktin se lumenjtë e vegjël si lumi i Jashanicë, lumi i Renocit, proi i Volujakës etj. janë lumenj me tipare karakteristike për përroskat malore, gjatë kohës së thatë në shumicën e këtyre lumenjve ka shumë pak ujë ose nuk ka ujë fare, kurse gjatë kohës me reshje shpesh ndodh që të ketë vërshime lokale.

### 2.7.15. Aktiviteti Radioaktiv (jonizues dhe jo-jonizues)

Dokumenti "Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera" i hartuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent të Republikës së Kosovës në vitin 2016 flet edhe për aktivitetin radioaktiv në Kosovë. Mirëpo, raporti në fjalë në asnjë vend nuk e përmend Klinën si vendbanim me ekspozim direkt ndaj këtij rreziku. Megjithatë, Nën-kapitulli 11.3 i këtij dokumenti - "Transporti rrugor me materie të rrezikshme" pasqyron ndërlidhshmërinë e bartjes së materieve të rrezikshme dhe aktivitetin radioaktiv të atyre materieve në këtë kontekst. Materiet e rrezikshme janë substanca që për nga përbërja fizike - kimike ose për nga natyra e reaksioneve mund të paraqesin rrezik për njeriun, të mirat materiale ose ambientin. Ato mund të jetë materie që digjen, toksike, eksplozive, gërryese (korrozive) ose radioaktive. Aksidentet e mjeteve dhe automjeteve që transportojnë materie të rrezikshme kanë si efekt primar të menjëhershëm dhe që vërehet lehtë (zjarrin, eksplodimin, derdhjen) dhe efektet sekondare (përhapjen ajrore të avujve toksik ndotjen e ujërave dhe të tokës).

### 2.7.16. Zjarret

Komuna e Klinës është kryesisht zonë në të cilën zjarret janë të pranishme në pyje gjetherënëse të cilat në disa raste për shkak të përhapjes së shpejtë të ndikuar nga faktor natyror dhe human kanë rrezikuar edhe hapësirat afër vendbanimet në të cilat janë paraqitur këto zjarre. Raportet e analizuara tregojnë se zjarret në komunën e Klinës janë paraqitur gjatë stinës së verës të cilat në disa raste kanë qenë zjarrëvenie të qëllimshme, e po ashtu ka raste kur janë konstatuar se zjarret në hapësira pyjore kanë ardhur nga rrjeti dhe instalimet e amortizuara të energjisë elektrike, djegia e hamulloreve, djegia e mbeturinave etj. Në vitet e fundit zjarret në pyjet e komunës së Klinës janë bërë fenomen i "rregullt" dhe paraqitja e tyre po evidentohet kryesisht në muajt me temperature të nxehta (korrik-gusht). Dëmet e tyre krysisht janë evidentuar në masën drunore dhe biodiversitetin në ato hapësira. Territori i komunës së Klinës përfshinë sipërfaqe totale të pyjeve afro 34% të territorit të saj. Pjesa më e madhe e pyjeve shtrihet në jug-lindje. Në territorin e komunë së Klinës masa drunore dominohet nga drunjët fletor gjtherënëse dhe në disa zona paraqiten dhe pyjet halore (pishë, afro 14 ha.) Statistikat për zjarret pyjore mbahen rregullisht nga viti 1955 e tutje. Ndryshimet klimatike kanë ndikuar edhe në Kosovë, ndërsa vitet më të theksuara janë evidentuar në vitet: 2000, 2004, 2007 dhe 2012, me c'rast janë dëmtuar sipërfaqe të mëdha të pyjeve duke shkaktuar humbje të konsiderueshme. Edhe pse mungojnë të dhënat e përditësuara vetëm për

komunën e Klinës, megjithatë në dokumentin "Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera" të përgaditur nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent të Republikës së Kosovës në vitin 2016 jepen të dhëna statistikore për zjarret në Rajonin e Pejës. Këto të dhëna janë të vitit 2007 dhe pasqyrojnë numrin e zjarreve në periudhën Mars – Tetor. Sipas raportit, në periudhën në fjalë në tërë Rajonin e Pejës janë evidentuar 2,883 zjarre të cilat kanë rezultuar me dëme materiale prej 2,670,575 Euro.

## 2.8. ASETET E TRASHËGIMISË KULTURORE, NATYRORE dhe TURISTIKE

### 2.8.1. Trashëgimia Natyrore

Trashëgimia dhe resurset natyrore kanë rol të rëndësishëm për zhvillim ekonomik në komunën e Klinës. Këtu ekzistojnë shumë monumente dhe tërësi natyrore të mbrojtura me Ligjin për Konservimin e Natyrës, sipas të cilit biodiversiteti dhe peizazhet e larmishme me vlerë duhet të mbrohen me çdo kusht.

***Monumenti i Natyrës "Mirusha"*** karakterizohet si zonë me interes të veçantë e cila përfshinë sipërfaqe prej 598.4 ha. Kunjoni i Mirushës e cila gjendet në rrjedhën e poshtme të lumit Mirusha shquhet me format e saj impozante morfologjike të sajuara nga 16 liqene dhe 12 ujëvara me forma, sipërfaqe dhe lartësi të ndryshme. Plani Hapësinor i Monumentit të natyrës "Mirusha" ka përcaktuar mundësitë e zhvillimit të turizmit dhe veprimtarive tjera ekonomike si dhe përgjegjësive të komunës në mbrojtën e vlerave natyrore dhe kulturore të identifikuara.
***Monumente tjera natyrore*** - në territorin e komunës së Klinës ka vendbanime në të cilën gjenden një ose më shumë monumente natyrore me veçori specifike dhe vlera unike-rariteti, veçori natyrore, vlera rekreative ose estetike dhe vlera të posaçme kulturore.
Janë dy lloje të monumenteve natyrore në komunën e Klinës: Hidrologjike dhe Botanike.
Monumentet natyrore me veçori hidrologjike të rëndësisë së veçantë e të cilat gjenden në listën e zonave të mbrojtura natyrore janë si vijon: Burimi i ujit mineral në Dresnik; Burimi i ujit mineral në Rudicë; Gryka e lumit Klinë; Kompleksi i trungjeve të rrënjës në Gllarevë (Quercus robus); Trungu i qarrit në Zllakuqan (Quercus cerris); Trungu i rrënjës në Deiq (Quercus robus); Trungu i qarrit në Nagllavkë (Quercus cerris); Trungu i bungut në Ujëmirë (Quercus pubescens).
***Burimet e ujërave minerale në Klinë*** hyjnë në kategorinë e tretë të mbrojtës (neni 4, nr. 40 – 13/07 Udhëzimi Administrativ- Kriteret për përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Ujore dhe masat e tyre mbrojtëse për burimet e ujit që përdoren për pije).

***Shpellat-*** në komunën e Klinës shumica e shpellave gjenden në zonën e kunjonit të Mirushës si dhe në Dush, të tilla si: Shpella e Kishës së madhe, Shpella e Kishës së vogël, Shpella te liqeni i dhjetë, Shpella te liqeni i nëntë, Shpella karstike, Shpella e madhe dhe Shpella e Dushit. Këto shpella duhet të hulumtohen dhe të shpallen si hapësira me të drejtë për shfrytëzim për vizita turistike ose të tjera (neni 21, Ligji për Konservimin e natyrës, pika 3).

## 2.8.2. Astete e Trashëgimisë Kulturore dhe Turisitike

Komuna e Klinës karakterizohet me një trashëgimi të pasur arkeologjike dhe arkitekturore. Trajtimi i duhur i këtyre aseteve mund të vendosë Klinën në hartën e destinacioneve të rëndësishme turistike duke nxitur zhvillimin socio-ekonomik si dhe duke përforcuar identitetin e vendit. Në mesin e lokacioneve të trashëgimisë kulturore në komunë është edhe kështjella e Mark Rrustem Jakajt në fshatin Ranoc. Ajo është e ndërtuar nga guri dhe tullat, me dekorime të pasura të fasadës që e dallojnë nga kullat tjera në rajon. Profesioni tradicional i femrave në këtë rajon është prodhimi i veshjeve të endura në gjergjef dhe të dekoruara me ngjyra të ndryshme. Kjo është zeje që ende ekziston, dhe krijon potencial për një produkt atraktiv që është zhvilluar nga artizanet femra të komunës së Klinës.

Bazuar në shënimet e Zyrës për Trashëgimi Kulturore në Klinë, si dhe **Listës së Trashëgimisë Kulturore Për Mbrojtje Të Përkohshme (për periudhën 06.10.2023-06.10.2024)** e aprovuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me date 06.10.2023, kjo përfshinë këto Asete të Trashëgimisë Kulturore nga Komuna e Klinës:

**I. Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike**

**Nënkategoria: Monument/Ansambël**

**Tabelë 34.** Lista e trashëgimisë arkeologjike

| Nr. | Emërtimi | Periudha | Vendi/ Komuna | Statusi | Nr. unik në databazë | Sip. (Ha) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **31** | Mbetjet e Manastiri te Dollcit | Mesjetë | Dolle, Kline | ZVM | 3024 | 1.84 |
| **32** | Manastiri i Budisalcit | Mesjetë | Budisalc, | ZVM | 3025 | 27.63 |
| **33** | Kisha e Shen Ndrrimit | Mesjetë | Budisalc, | | 3025 | - |
| **34** | Kisha e Shen Nikolles | Mesjetë | Siçeve, | | 3023 | - |
| **35** | Kisha e Shen Nikolles ne | Mesjetë | Mleqan, | | 3022 | - |
| **36** | Kisha e Shen Nikolles ne | Mesjetë | Qabiq, Klinë | | 3019 | 0.04 |
| **37** | Kisha e Eperme ne | Mesjetë | Pogragje, | | 3021 | - |
| **38** | Kisha e Shen Dhimitrit ne | Mesjetë | Pogragje, | | 3020 | - |
| **39** | Lokalitet arkeologjik parahistorik ne Pogragje | Parahistori | Pogragje, Kline | | 3485 | - |
| **40** | Lokalitet arkeologjik parahistorik ne Perçeve | Parahistori | Përçevë, Klinë | | 3486 | - |

### Nënkategoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat

**Tabelë 35.** Lista e trashëgimisë arkeologjike

| Nr. | Emërtimi | Periudha | Vendi/ Komuna | Statusi | Nr. unik në databazë | Sip. (Ha) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **110** | Germadhat e Kishes varrezore e Shen Nikolles | Mesjete | Kijeve, Klinë | | 2890 | |
| **111** | Germadhat e Kishes varrezore e Shen Premtes | Mesjete | Dresnik, Klinë | | 2889 | |
| **112** | Germadhat e Manastirit 'Shen | Mesjete | Ujëmirë, | | 3027 | |
| **113** | Germadhat e kishes ne Sverh- | Mesjete | Sferk, Klinë | | 3028 | |
| **114** | Nekropoli tumular ne Volljake | Parahistori | Volljakë, | | 3609 | |
| **115** | Tumat ne Kramovik | Parahistori | Kramovik, | | 4179 | |
| **116** | Tumat ne Dolle | Parahistori | Dolle, Klinë | | 4180 | |
| **117** | Lokaliteti parahistorik | Parahistori | Gllareve, | | 3596 | |
| **118** | Lokaliteti parahistorik | Parahistori | Gllareve, | | 3678 | |
| **119** | Tumat Ilire ne lokalitetin | Parahistori | Përçevë, Klinë | | 3597 | |
| **120** | Tuma e madhe Ilire ne | Parahistori | Jashanicë, | | 3624 | |
| **121** | Lokaliteti shumeshtresor ne Qabiq | Parahistori | Qabiq, Klinë | | 3724 | |
| **122** | Tuma ne Zabergje | Parahistori | Zabërgj, Klinë | | 4305 | |

## II. Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore

### Nënkategoria: Monument/Ansambël

**Tabelë 36.** Lista e trashëgimisë arkitekturore

| Nr. | Emërtimi | Periudha | Vendi/ Komuna | Statusi | Nr. unik në databazë |
|---|---|---|---|---|---|
| **337** | Ura e vjeter e gurit | | Kline | | 4310 |
| **338** | Manastiri i Budisalcit | | Kline | | 4312 |
| **339** | Kulla e Gjon Nikolles | | Budisalc, Kline | | 4617 |
| **340** | Stacioni i trenit | | Budisalc, Kline | | 4751 |
| **341** | Ura e vjeter e gurit | | Budisalc, Kline | | 4750 |
| **342** | Kisha varrore e Shen | | Dresnik, Kline | | 4619 |
| **343** | Kulla e Shaban Ali Berisha | | Grabanice, Kline | | 7620 |
| **344** | Kulla e Enver Maxharraj | | Gremnik, Kline | | 4622 |
| **345** | Kisha e Zllakuqanit | | Zllakuqan, Kline | | 4624 |
| **346** | Shkolla fillore e vjeter | | Pogragje, Kine | | 4328 |
| **347** | Kulla e Jakajve | | Ranoc, Kline | | 4627 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **348** | Kulla Sali Tafilaj | | Shtarice, Kline | | 4626 |
| **349** | Kulla Haki Gashi | | Sferke, Kline | | 4631 |
| **350** | Kompleksi Memorial Muje Krasniqi | Shek. XXI | Çabiq, Kline | | 4678 |
| **351** | Kulla e Beke Syle Millakut | Shek. XIX | Ujmire, Kline | | 4887 |
| **352** | Kulla e Gjon Mark !;unit | 1908-1913 | Dresnik, Kline | | 4888 |
| **353** | Mulliri i lsuf Halilit | Shek. XIX | Pertoq i eperm, | | 4889 |
| **354** | Kulla e Nue Jakut | 5hek. XX | Videje, Kline | | 4890 |

**Nënkategoria: Fushat e konservimit arkitekturor**

**Tabelë 37.** Lista e trashëgimisë arkitekturore

| **Nr.** | **Emërtimi** | **Periudha** | **Signatura-konteksti i gjetjes dhe vendodhja** | **Vendi/ Komuna** | **Statusi** |
|---|---|---|---|---|---|
| **98** | Urnë | 1500-1100 p.kr | T/30.C Varri II nr.173 (IAK) | Volljakë, Kline | |
| **99** | Urnë | 1500-1100 | T/30.C Varri II nr.134 | Volljakë, | |
| **109** | Tas nje vegjak | 850-600 p.Kr | B.K.-X/ Ill, nr. Inv. 20 | Përçevë, | |
| **110** | Tas nje vegjak | 850-600 p.Kr | B.K. X/1, nr. Inv. 8 (MK) | Përçevë, | |
| **115** | Tas nje vegjak | 850-600 p.Kr. | B.K.0X/IV, nr. Inv. 34 | Përçevë, | |
| **131** | Maje heshte | 850-600 p.Kr. | Perçeve, nr. 74/45 (MK) | Përçevë, | |
| **216** | Afreskat e Stibadium-it/Triclinium-it | Periudha Romake | Kuader pikturimi, Pikture murale | Dersnik, Kline | |




**Harta 33.** Harta e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore

## 2.8.3. Zonat e veçanta të mbrojtura

Zonat e veçanta të mbrojtura janë territore të përcaktuara rreth monumenteve ose grupeve të ndërtesave me vlera historike, kulturore, arkitektonike, apo arkeologjike. Këto zona mbrohen nga çdo lloj zhvillimi apo aktiviteti që mund të dëmtojë kontekstin historik apo estetik të vendit, si dhe mjedisin natyror ose vizual përreth.

Në komunën e Klinës, tri nga këto zona të mbrojtura përfshijnë Manastirin e Budisalcit, Manastirin e Dollcit, dhe Kishën e Heremitëve në Ularicë, të cilat kanë rëndësi për trashëgiminë kulturore dhe fetare të rajonit. Këto vende ruhen për të mbrojtur peizazhin dhe autenticitetin e tyre nga ndikimet negative të zhvillimeve moderne.

MANASTIRI I BUDISALCIT është në gjendje relativisht të mirë, megjithëse disa dëmtime të vogla janë të pranishme për shkak të mungesës së mirëmbajtjes. Një ndërhyrje e rekomanduar është konservimi i freskave për të ruajtur këtë trashëgimi artistike. Për çështjet e sigurisë dhe monitorimit, që nga nëntori i vitit 2012, manastiri është nën mbikëqyrjen e Policisë së Kosovës (PK)

*( burimi: Raporti i progresit “ Vënja në jetë e zonave të veçanta të mbrojtura për trashëgiminë fetare dhe kulturore në Kosovë”, 2009 ICO, fq 33)*




**Figure 1**. Manastiri i Budisalcit ( Burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2014-2021+)

MANASTIRI I DOLLCIT është në gjendje të shkatërruar, me një lokacion të braktisur dhe të rrezikuar nga zgjerimi i mundshëm i rrugës përreth. Zona nuk është e siguruar dhe ka qasje të pakontrolluar, çka rrit rrezikun për dëmtime të mëtejshme dhe humbje të vlerave të saj historike.

*(burimi: Raporti i progresit "Vënja në jetë e zonave të veçanta të mbrojtura për trashëgiminë fetare dhe kulturore në Kosovë", 2009 ICO, fq 34)*




**Figure 2.** Manastiri I Dollcit, Dollc ( Burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2014-2021+)

HERMITAZHI ME KISHË apo KISHA E HEREMITËVE është në gjendje të keqe, veçanërisht freskat, të cilat janë dëmtuar rëndë. Ndërtimi i një rruge të re, pa asfalt dhe me parkim të jashtëligjshëm, së bashku me ndërtimin e një mini-hidrocentrali, ka shkaktuar shkatërrimin e zonës së veçantë të mbrojtur. Për më tepër, zona nuk është e siguruar dhe ka qasje të pakontrolluar, duke përkeqësuar gjendjen e saj dhe rrezikuar më tej trashëgiminë historike *( Burimi: Raporti i progresit " Vënja në jetë e zonave të veçanta të mbrojtura për trashëgiminë fetare dhe kulturore në Kosovë", 2009 ICO, fq 34).*




**Figure 3.** Hermitazhi me kishrë– Kisha e heremitëve, Ularicë. ( Burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2014-2021+)

## 2.9. VENDBANIMET

### 2.9.1. Tipologjia e vendbanimeve sipas madhësisë

Trajtimi i vendbanimeve në planet zhvillimore komunale është i domosdoshëm dhe kyç ngase i tërë aktiviteti dhe organizimi i jetës së njeriut dhe shoqërisë njerëzore ka qenë dhe është i lidhur për to. Tipizimi i vendbanimeve sipas madhësisë është njëra ndër metodat më të rëndësishme për të pasqyruar karakteristikat e sistemit popullativ të hapësirës së caktuar si dhe mënyrën dhe cilësinë e jetës në vendbanimet e asaj hapësire, sepse vendbanimi më i madh nënkupton mënyrën e jetës më cilësore në shumë aspekte. Kurse vendbanimi më i vogël zakonisht tregon të kundërtën e asaj të pares. Pikërisht nga kjo arsye vendbanimet kategorizohen sipas madhësisë popullative dhe në bazë të shumë analizave të kësaj problematike përcaktohen pikat strategjike për zhvillim të mëtejmë të komunës apo edhe më gjerë.

Bazuar në udhëzimin Administrativ mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, vendbanimet sipas madhësisë demografike në komunën e Klinës mund të kategorizohen në:

1. Vendbanime shumë të vogla rurale (0-199 banorë);
2. Vendbanime të vogla rurale (200-499 banorë);
3. Vendbanime të mesme rurale (500-999 banorë);
4. Vendbanime të mesme të mëdha rurale (1,000-2,499 banorë);
5. Vendbanime të mëdha rurale (2,500-4,999 banorë) dhe
6. Vendbanim shumë i vogël urban (5,000-9,999 banorë).

Në komunën e Klinës ekzistojnë 54 vendbanime gjithsej e të cilat shtrihen në 43 zona kadastrale. Sipas regjistrimit të popullsisë për vitin 2011 nga ASK, në komunën e Klinës kemi këto grupe të vendbanimeve bazuar në ndarjen e më sipërme:

***Vendbanime shumë të vogla rurale (0-199 banorë)*** janë gjithsej 8 vendbanime: Dranashiq me 21 banorë, Jelloc me 27 banorë, Nagllavë me 67 banorë, Binxhë me 117 banorë, Pjetërq I Poshtëm me 160 banorë, Stupë me 179 banorë, Dushë I Vogël me 196 banorë dhe Jagodë me 197 banorë.

***Vendbanime të vogla rurale (200-499 banorë)*** janë gjithsej 21 dhe numri më i madh i vendbanimeve hyn në këtë kategori: Grabc me 206 banorë, Leskoc me 239 banorë, Dush me 241 banorë, Bërkovë me 246 banorë, Dollc me 276 banorë, Krushevë e vogël me 323 banorë, Dobërdol me 339 banorë, Ranoc me 353 banorë, Raduloc me 353 banorë, Pograxhë 366 banorë, Qeskovë 373 banorë, Deiq 376 banorë, Budisalc 398 banorë, Resnik 399 banorë, banorë, Dugajevë me 399 banorë, Bokshiq me 433 banorë, Drenoc me 440 banorë, Dollovë me 444 banorë, Rudicë me 446 banorë, Gjurgjevik i Madh me 449 banorë dhe Klinafc me 480 banorë.

***Vendbanime të mesme rurale (500-999 banorë)*** janë gjithsej 15 vendbanime: Ujmir me 544 banorë, Pjetërq i Epërm me 563 banorë, Qupevë me 579 banorë, Krushevë e Madhe me 585 banorë, Kpuz me 622 banorë, Zllakuqan me 660 banorë, Videjë me 663 banorë, Grabanicë me 728 banorë, Zabërgjë me 728 banorë, Gjurgjevik i Vogël me 745 banorë, Shtupel me 771 banorë, Kërnicë me 794 banorë, Çabiq me 862 banorë, Rixhevë me 870 banorë dhe Volljak me 929 banorë.

***Vendbanime të mesme të mëdha rurale (1,000-2,499 banorë)*** janë 9 vendbanime: Përqevë me 1,005 banorë, Gremnik me 1,131 banorë, Caravik me 1,241 banorë, Zajm me 1,267, Siçvë me 1,338

banorë, Sferkë me 2,448 banorë, Dresnik me 1,770 banorë, Gllarevë me 1,784 banorë dhe Jashanicë me 1,784 banorë.

***Vendbanime të mëdha rurale (2,500-4,999 banorë)*** nuk ka në komunën e Klinës.

***Vendbanimet me mbi 5,000 banorë***: Klina me 5,542 banorë. Klina si qendër komunale, shtrihet në pjesën fushore nëpër të cilin vendbanim rrjedh Drini i Bardhë. Ka një sipërfaqe prej 308 Hektarë.

### 2.9.2. Shtrirja hapësinore e vendbanimeve sipas madhësisë

Shtrirja hapësinore e vendbanimeve sipas madhësisë është e një rëndësie të veçantë për planifikimin dhe rregullimin e hapësirës. Në bazë të kësaj analize mund të përcaktohen kahet e zhvillimit dhe organizimit të më tejmë shoqëroro-ekonomik në hapësirën e caktuar. Madhësia mesatare e vendbanimeve në komunën e Klinës është 712 banorë. Dallimet në numrin e popullsisë të disa vendbanimeve janë të konsiderueshme dhe ato sillen në mes maksimumit me 5,542 banorë (Klina) dhe minimumit me 21 banorë (Dranashiq), e që është dallim shumë i madh. Këto dallime janë të kushtëzuara nga pozita e vendbanimit dhe gjeomorfologjia e terrenit. Prandaj, është me rëndësi edhe analiza e shtrirjes së këtyre vendbanimeve sipas zonave të lartësisë mbidetare.

Përfaqësimi i disa vendbanimeve të kategorive të mëdha në rrjetin e vendbanimeve ka ndikim të rëndësishëm në organizimin e hapësirës dhe sistemin funksional të vendbanimeve. Karakteristikë e rrjetit të vendbanimeve në komunën e Klinës është numri më i madh i vendbanimeve të vogla rurale nga 200 – 499 banorë e që janë 21 vendbanime në total, apo rreth 38% e të gjitha vendbanimeve. Gjithashtu ka edhe një numër të konsiderueshëm të vendbanimeve me madhësi të mesme të vogël nga 500 – 999 banorë, e që janë 15 vendbanime apo rreth 27% e totalit të vendbanimeve. Numri i vendbanimeve me madhësi nga 1,000 – 2,499 banorë është 9, apo rreth 16% e vendbanimeve. Numri i vendbanimeve shumë të vogla rurale me nën 200 banorë është 8.

Sa i përket lëvizjes së numrit të popullsisë në vendbanimet e komunës së Klinës sipas viteve vërehen ndryshime të theksuara. Në periudhat më të hershme kohore kishte një dominim shumë të theksuar të vendbanimeve me numër të vogël të popullsisë deri në 500 banorë, ndërsa në anën tjetër kishte shumë pakë apo aspak vendbanime të mëdha. Me kalimin e kohës dhe me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, social e infrastrukturor ka një rritje të vazhdueshme të vendbanimeve dhe kështu edhe zvogëlim të numrit të vendbanimeve të vogla duke u rritur numri i vendbanimeve të mesme dhe të mëdha.

**Tabelë 38.** Struktura e vendbanimeve sipas madhësisë demografike në periudhën 1941-2011

| Madhësia e vendbanimit në banorë | Numri i vendbanimeve sipas viteve dhe madhësisë | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1948 | 1953 | 1961 | 1971 | 1981 | 1991 | 2011 |
| **0-199** | 8 | 7 | 4 | 2 | 2 | 2 | 8 |
| **200-499** | 32 | 32 | 29 | 22 | 16 | 11 | 21 |
| **500-999** | 13 | 14 | 16 | 23 | 24 | 24 | 15 |
| **1000-2499** | 1 | 1 | 5 | 7 | 11 | 15 | 9 |
| **2500-4999** | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 |
| **5000-9999** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 |
| **Gjithsej** | 54 | 54 | 54 | 54 | 54 | 54 | 54 |




**Grafiku 11.** Numri i vendbanimeve sipas madhësisë demografike për periudhën 1948-2011

Nga tabela dhe grafikoni shihet se vendbanimet me popullsi deri 500 banorë kanë pasur zvogëlim në numër, nga 40 sa ishin në vitin 1948, në 13 vendbanime në vitin 1991. Vlen të theksohet se në vitin 2011 sërish kishte një rritje të vendbanimeve të vogla deri në 500 banorë. Ky numër sot është 29 si rezultat i migrimit dhe depopullimit kryesisht të vendbanimeve periferike dhe kushteve jo të favorshme për të jetuar.

Krahas zvogëlimit të numrit të vendbanimeve të vogla, vazhdimisht kishte një rritje të vendbanimeve të mesme dhe të mëdha. Vendbanimet me 500 – 1000 banorë kanë shënuar një rritje nga 13 vendbanime në vitin 1948 në 24 sosh në vitin 1991, por që numri i tyre sërish kishte rënë në 15 në vitin 2011. Gjithashtu edhe vendbanimet e mëdha me 1,000 – 2,500 banorë kanë regjistruar rritje më të madhe. Në vitet 1948 dhe 1953 kishte vetëm një vendbanim të madh, ndërsa në vitin 1961 kishte 5, 1971 kishte 7 vendbanime, në vitin 1981 ishin 11 dhe në vitin 1991 numri i këtyre vendbanimeve kishte arritur në 15. Numri i këtyre vendbanimeve zvogëlohet në vitin 2011 në 9 vendbanime.

Vendbanime të mëdha nga 2,500 – 5,000 banorë nuk kishte deri në vitin 1981 kur Klina bëhet vendbanimi i vetëm me këtë popullsi, ndërsa në vitin 1991 kemi kishte 2 vendbanime të tilla (Gllareva me mbi 2,500 banorë dhe Klina me mbi 5,000 banorë). Nga këto të dhëna del se në të kaluarën kryesisht kanë dominuar vendbanimet e vogla rurale, ndërsa në periudhat e fundit kohore kemi rritje edhe të vendbanimeve të vogla edhe të atyre të mëdha. Kjo si rezultat i lëvizjeve të popullsisë nga viset rurale drejt qendrave më të zhvilluara. Në këtë mënyrë është duke u zvogluar numri i banorëve në vendbanimet periferike dhe njëkohësisht është duke u rritur numri i vendbanimeve të vogla dhe gjithashtu në disa qendra po rritet numri i popullsisë dhe njëkohësisht po rritet numri i vendbanimeve të mëdha.

### 2.9.3. Dendësia e vendbanimeve në komunën e Klinës

Qyteti i Klinës ka 5,865 banorë që përbëjnë rreth 15% të popullsisë së gjithëmbarshme të komunës. Të gjitha vendbanimet tjera rurales ë bashku kanë 32,631 banorë, apo rreth 85% të popullsisë.

**Tabelë 39.** Popullsia, sipërfaqja dhe dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve

| Nr | Vendbanimi/Zona kadastrale | Popullsia | Sip_Ha | Sip_km² | Banorë/km² |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Berkovë | 246 | 490.6 | 4.9 | 50.14 |
| 2 | Binxhë/Grapc | 323 | 1143.9 | 11.4 | 28.24 |
| 3 | Bokshiq | 433 | 539.9 | 5.4 | 80.19 |
| 4 | Budisalc | 398 | 428.7 | 4.3 | 92.85 |
| 5 | Çabiq | 862 | 579.4 | 5.8 | 148.78 |
| 6 | Caravik | 1241 | 873.3 | 8.7 | 142.1 |
| 7 | Qupevë | 579 | 352.9 | 3.5 | 164.06 |
| 8 | Dollovë | 444 | 352.9 | 3.5 | 125.8 |
| 9 | Dobërdol | 339 | 454.3 | 4.5 | 74.61 |
| 10 | Drenoc | 440 | 807 | 8.1 | 54.52 |
| 11 | Dranashiq/Ranoc/Leskoc | 613 | 976.9 | 9.8 | 63.78 |
| 12 | Dresnik | 1770 | 1523 | 15.2 | 116.22 |
| 13 | Dugojevë | 399 | 576.4 | 5.8 | 69.23 |
| 14 | Dush i Vogël | 196 | 413.6 | 4.1 | 47.39 |
| 15 | Gjurgjevik i Madh | 449 | 1217.7 | 12.2 | 36.87 |
| 16 | Gllarevë/Rixhevë | 2654 | 1562 | 15.6 | 169.91 |
| 17 | Grabanicë | 728 | 550.8 | 5.5 | 132.18 |
| 18 | Gremnik | 1131 | 758.6 | 7.6 | 149.09 |
| 19 | Jagodë | 197 | 222.6 | 2.2 | 88.52 |
| 20 | Jashanicë | 1784 | 1492.1 | 14.9 | 119.56 |
| 21 | Klinë/Krushevë e Vogël | 5865 | 591 | 5.9 | 992.39 |
| 22 | Klinafc/Pograxhë/Gjurgjevik I Vogël | 1591 | 1051.1 | 10.5 | 151.36 |
| 23 | Kpuz | 622 | 1160.9 | 11.6 | 53.58 |
| 24 | Krushevë e Madhe | 585 | 643.2 | 6.4 | 90.96 |
| 25 | Nagllavkë | 67 | 386.8 | 3.9 | 17.32 |
| 26 | Zajm | 1267 | 482.2 | 4.8 | 262.74 |
| 27 | Perqevë | 1005 | 993.4 | 9.9 | 101.17 |
| 28 | Pjëterq i Poshtem | 160 | 612.6 | 6.1 | 26.12 |
| 29 | Pjëterq i Epërm | 563 | 395.6 | 4 | 142.32 |
| 30 | Rudicë | 446 | 241.1 | 2.4 | 184.98 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 31 | Shtupel/Kërnicë | 1565 | 1161.8 | 11.6 | 134.7 |
| 32 | Siqevë | 1338 | 785.9 | 7.9 | 170.25 |
| 33 | Stupë | 179 | 232.7 | 2.3 | 76.93 |
| 34 | Volljak | 929 | 695.9 | 7 | 133.5 |
| 35 | Zllakuqan/Radulicë | 1013 | 625.6 | 6.3 | 163.53 |
| 36 | Dollc | 276 | 475.2 | 4.8 | 58.08 |
| 37 | Ujmirë | 544 | 331.5 | 3.3 | 164.13 |
| 38 | Zabërgjë | 728 | 236.9 | 2.4 | 307.32 |
| 39 | Qeskovë | 373 | 336 | 3.4 | 111.01 |
| 40 | Videjë | 663 | 849.4 | 8.5 | 78.06 |
| 41 | Deiq | 376 | 97.7 | 1 | 384.73 |
| 42 | Sferkë | 2448 | 1594.3 | 15.9 | 153.55 |
| 43 | Dush/Jellovcë/Resnik | 667 | 1604.9 | 16 | 41.56 |
| | Gjithsej | 38496 | 30902.1 | 309 | 124.6 |

Mesatarisht 124 banorë jetojnë në një km² dhe kjo dendësi e popullsisë dallon varësisht nga vendbanimi. Zakonisht tek vendbanimet me popullsi më të madhe ka edhe dendësi më të lartë të popullsisë. Gjithashtu, dendësia e popullsisë brenda zonës ndërtimore ndryshon sipas vendbanimeve. Në komunën e Klinës ka vendbanime që kanë mbi 30 banorë për ha në zonën e ndërtuar.

### 2.9.6. Vendbanimet Joformale

Vendbanimet joformale në vendin tone kanë ekzistuar edhe më parë, mirëpo kryesisht kanë qenë të njohura me emërtime të ndryshme si lagje të egra, ilegale, të paplanifikuara, mahalla etj. Sipas Ligjit Nr. 03/L-106 për ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 2003/14 ,Neni 2.

Vendbanimet Joformale përkufizohen si në vijim: janë vendbanime njerëzore të cilat nuk u mundësojnë banorëve të gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm të jetesës, në veçanti banim të përshtatshëm. Si të tilla, vendbanimet joformale duhet të kenë karakteristika si në vijim:

- Zotërimi joformal i pronësisë,
- Qasja joadekuate ose privimi në shërbime elementare,
- Pjesëmarrja joadekuate ose mos pjesëmarrja në qeverisje dhe
- Rrezikshmëria e lartë VBJ e identifikuara në vendin tonë, karakterizohen kryesisht me zotërim joformal të pronësisë si dhe me qasje joadekuate në shërbime elementare. Karakteristikat identifikuese do të jenë bazë për të ju qasur rregullimit të tyre.

Bazuar në të dhënat nga raporti i fundit në komunën e Klinës janë identifikuar 21 Vendbanime Joformale.

Plani Zhvillimor Komunal 2014-2021+ ka identifikuar vendbanimet vijuese joformale të cilat janë përfshirë në strategjinë zhvillimore:

Potërq i poshtëm, Drenoc, Dugajevë, Grabanicë, Zajm, Dollovë, Volljakë, Rudicë, Budisalc, Jagodë, Bërkovë, Shtupel, Bingjë, Pogragjë, Stapanicë, Resnik, lagja në mes të Jashanicës dhe Jashanicës së Epërme, Klinë –zona veriore dhe Klinë - Dërsnik.

Plani Zhvillimor Komunal 2014-2021+ ka kategorizuar Vendbanimet Joformale si vijon:

- Vendbanimet joformale të cilat kanë zotërim joformal të pronësisë. Këtu bëjnë pjesë : Bokshiq, Dollova, Dresniku, Drenoci, Grabanica dhe Potërq I poshtëm. Shtëpitë që gjenden brenda kufirit të përcaktuar të vendbanimit joformal janë ndërtuar në pronë shoqërore.
- Vendbanime joformal në zona të veçanta. Këtu bën pjesë Budisalci. Kufijtë e këtij vendbanimi janë përcaktuar me ligj të veçantë. Ky vendbanim kërkon regjim të veçantë të organizimit, zhvillimit, shfrytëzimit dhe mbrojtjes.
- Vendbanime joformale të cilat kanë mungesë të infrastrukturës teknike. Të gjitha vendbanimet pothuajse e kanë problemin lidhur me furnizimin me ujë, rrjetin e kanalizimit , telefonisë etj.

Të gjitha vendbanimet e lartpërmendura e plotësojnë kriterin lidhur më infrastrukturës sociale, sepse të gjitha ose e kanë ose janë të mbuluara nga vendbanimi përkatës. Kështu psh. Budisalc, Drenoci, Grabanica, kanë institucione arsimore dhe shëndetësore ndërsa vendbanimet tjera joformale mbulohen nga vendbanimet tjera më të afërta. Bokshiq graviton në Grabanicë, Dollova në Grabanicë apo Gremnik, Dersniku graviton në Klinë dhe Poterq në Poterq të Epërm apo Drenoc.

Kriteri i mbulueshmërisë më infrastrukturë sociale.- Në bazë të informatave hapësinore lidhur më shtrirjen e përmbajtjeve publike, komuna e Klinës ka në shpërndarje relativisht të mirë të ndërtesave arsimore dhe shëndetësore. Sa I përket ndërtesave të çerdheve , nuk mund ta konsiderojmë si kriter për shkak se çerdhet-kopshtet sipas standardeve duhet të jenë në çdo 2000 banorë. E njëjta gjë vlen edhe për shtëpitë e kulturës. Prandaj duke I marrë për bazë këto informata vijmë në përfundim që pothuajse të gjitha vendbanimet joformale e plotësojnë kushtin lidhur me qasjen në infrastrukturës sociale.

Kushti tjetër I plotësuar është edhe infrastruktura teknike. Viteve të fundit janë realizuar mjaft projekte. Kështu p.sh. Mahalla Klinë (vendbanim joformal i cili gjendej ne zonën urbane) iu janë ndërtuar rrugët, nderuar rrjeti I ujësjellësi dhe kanalizimit. Dhe paraqet një shembull të një lagje të organizuar.

Ndonëse Harta Zonale e Komunës ka trajtuar infrastrukturën teknike, publike, sociale dhe të transportit për të gjitha Vendbanimet Joformale, për Budisalc, Bokshiq, Dollova, Dresniku, Drenoci, Grabanica dhe Potërq I Poshtëm nevojitet të hartohen Plane Rregulluese të Hollësishme.




**Figure 4.** Vendbanimet jofomale (Burimi: Harta Zonale Komunale 2020-2028)

## 2.9.7.Ndërtimet pa leje ndërtimore

Bazuar në regjistrin e ndërtimeve pa leje, në të gjitha vendbanimet e komunës së Klinës del se janë 12,016 ndërtime pa leje, prej të cilave deri më tani vetëm 435 kanë aplikuar për legalizim, 178 prej tyre janë me vendim për listë të pritjes, 148 janë të pajisur me çertifikatë të legalizimit, 11 refuzime, 1 vendim për rrënim, dhe 18 objekte të ndërtuara pas datës 05.09.2018. Pjesa e mbetur e objekteve të ndërtuara pa leje duhet të trajtohen sipas Ligjit nr.06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

## 2.9.8. Zona Urbane

Pozita gjeografike, kushtet e favorshme për jetesë dhe pasuritë natyrore kanë ndikuar që treva e Komunës së Klinës të jetë e banuar që nga lashtësia. Vendbanimet në këtë zonë datojnë që nga periudha e neolitit, siç dëshmojnë gërmadhat e shumta të zbuluara në lokalitete të ndryshme. Gjurmët më të rëndësishme arkeologjike përfshijnë lokalitete ilire në Përcetë, Qëndresë dhe gërmadha të tjera të panjohura në Dërsnik, Lug, Gurgat dhe Bardhaj. Në shumë prej këtyre vendbanimeve janë gjetur tuma ilire dhe objekte të kulturës materiale. Gjatë periudhës romake, treva e Klinës përjetoi ndryshime të mëdha politike dhe shoqërore. Romakët ngritën vendbanime përgjatë rrugëve kryesore dhe një pjesë e popullsisë iliro-dardane u zhvendos nga vendbanimet e vjetra në kodrat mbrojtëse. Një qendër e rëndësishme gjatë kësaj periudhe ishte Dërsniku, i përmendur edhe nga Konstantin Porfirogjeni në shekullin e 10-të. Gjurmë të rëndësishme të kësaj periudhe janë zbuluar edhe në fshatin Dollc, i cili shfaqet në dokumente historike që nga shekulli i 12-të. Sundimi osman solli ndryshime të tjera në strukturën politike dhe shoqërore të zonës. Defteret osmane tregojnë se Dollci ishte një qendër e rëndësishme administrative, e njohur si nahi, me manastirin e tij dhe 19 fshatra përreth. Gjatë kësaj periudhe, pati kryengritje dhe lëvizje të

mëdha popullsie, duke ndikuar në krijimin dhe rrënimin e vendbanimeve të kësaj treve. Pas rënies së Perandorisë Osmane, zona u pushtua nga Serbia dhe Mali i Zi, duke përjetuar një periudhë të gjatë të krizave politike dhe ekonomike. Komuna e Klinës, e themeluar më 1954, shtrihet në pjesën perëndimore të Kosovës dhe kufizohet me shtatë komuna të tjera. Territori i saj është i pasur me pyje, tokë bujqësore dhe pasuri nëntokësore. Pesë lumenj, përfshirë Drinin e Bardhë dhe Lumbardhin e Pejës, kalojnë nëpër këtë zonë, duke ofruar potencial të madh për zhvillimin e bujqësisë dhe ujitjes. Klima dhe pozita gjeografike e Klinës janë të përshtatshme për kultivimin e kulturave bujqësore, zhvillimin e blegtorisë dhe bletarisë, duke e bërë atë një zonë me potencial të lartë zhvillimor.

### 2.9.9. Zona Rurale

Rrjeti i vendbanimeve rurale në komunën e Klinës është kryesisht i shpërndarë në aspektin hapësinor. Territori i komunës së Klinës karakterizohet me numër të madh të vendbanimeve të shpërndara në njësi sipërfaqesh. Në kuadër të sipërfaqes prej 308.69 km² janë të koncentruara 53 vendbanime Në aspektin topografik vendbanimet në komunën e Klinës ndahen në dy kategori: vendbanime fushore dhe ato kodrinore-malore. Vendbanimet e pjesës fushore janë të pozicionuara në rrafshet aluviale të Drinit të Bardhë, lumit Klina dhe kanë kategori të tokave bujqësore mes I dhe IV (përshtatshmëria e tokave bujqësore). Në këtë hapësirë janë të vendosura vendbanimet si Zajm, Grabanica, Dollovë, Zllakuqan, Jagodë, Deiq, Bërkovë, Rudicë, Stupë, Budisallcë, Nagllavkë, Krushevë e Madhe, Dresnik, Gremnik (pjesa perëndimore), Dollc, Petriq i Poshtëm, Drenoc. Pjesa tjetër e vendbanimeve janë të pozicionuara në pjesën kodrinore-malore, ku veprimtari kryesore është bujqësia dhe blegtoria.

## 2.10.BANIMI

Në qytetin e Klinës dominon banimi i ulët, i cili në pjesën më të madhe përbëhet prej shtëpive individuale. Sipas të dhënave, dendësia e banimit të ulët individual është 36.25 banorë/ha. Fondi banesor është i shpërndarë në 30 seksione, të cilat janë të ndërtuara në qendrën e ngushtë të qytetit dhe përgjatë tri rrugëve kryesore që drejtojnë në Istog, Skenderaj dhe magjistralen Prishtinë-Pejë. Në qytetin e Klinës, fondi banesor përbëhet kryesisht nga banimi individual dhe shumëbanesor. Numri i përgjithshëm i njësive të banimit individual në komunën e Klinës është rreth 10,283 ndërtesa me sipërfaqe totale prej 1,690.96 Ha, nga 1,759 njësi të banimit në qytet, 84% përfaqësohet nga banimi individual, ndërsa 16% nga banesa shumëbanesore. Numri i përgjithshëm i shtëpive është 1,479, dhe dendësia e përgjithshme e banimit të ulët pasqyrohet në një dendësi prej 36.25 banorë/ha në qytet. Numri i ndërtesave të banimit kolektiv (në zonën urbane) është 46 ndërtesa me sipërfaqe rreth 7.23 Ha. Ndërtesat shumëbanesore janë ndërtuar kryesisht gjatë periudhës së viteve 1950-1990. Ndërtesat e larta, me një lartësi prej P+4, P+6, përbëjnë shumicën, ndërsa një pjesë e këtyre banesave të vjetra kanë nevojë për përmirësime në izolim, instalime dhe riparime të fasadave. Pjesa më e madhe e shtëpive të ndërtuara pas viteve 1940 përbëhet kryesisht nga shtëpi individuale. Shtëpitë ndërtuara gjatë viteve 1950-1970 përcaktojnë konfiguracionin aktual të qytetit dhe zonave banesore përreth rrugëve kryesore. Rreth 45% e shtëpive janë në gjendje të mirë fizike, 12% janë në gjendje relativisht të mirë, ndërsa 8% janë në gjendje të dobët dhe 26% janë ende të papërfunduara ose të shkatërruara.

**Tabelë 40.** Fondi banesor, Klinë

| | FONDI BANESOR | Klinë |
|---|---|---|
| **1** | Nr. I objekteve të banimit | 1759 njësi të banimit |
| **2** | Nr. I banesave në pronësi komunale ( Në kuadër të objekteve kolektive) | 23+23+25+35<br>Njësi banesore, Katër objekte<br>Gjithsej - 106 njësi banesore |
| **3** | Me partneritet publik privat (Përfitues janë ish-banorët) | 8 Objekte banesore |
| **4** | Qendra për banim social | 4 Objekte banesore |
| **5** | Qendra të përkohshme kolektive | / |

*Burimi: Programi Tre vjeçar i banimit 2022-2025*

**Tabelë 41.** Banesat sipas llojit, Statusit të Shfrytëzimit dhe Tipit të Vendbanimit

| **Komuna** | | **Gjithsej** | **Banesa të zakonshme për banim** | | | | | **Lloj tjetër banese** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Gjithsej | E shfrytëzuar nga një apo më shumë banorë | E shfrytëzuar nga banorë që nuk janë përfshirë në regjistrim (personeli diplomatik etj.) | E shfrytëzuar nga banorë për qëllime të rastësishme apo përdorim dytësore, që Nuk janë përfshirë në regjistrim | Banesë e pabanuar (e dedikuar për shitje, qira etj) | |
| Klinë | | 8129 | 8125 | 5825 | 10 | 534 | 1756 | 4 |
| | Urban | 1718 | 1716 | 1060 | - | 65 | 591 | 2 |
| | Rural | 6411 | 6409 | 4765 | 10 | 469 | 1165 | 2 |

*Burimi: Agjenica e Statistikave të Kosovës -ASK, 2011*

Në total, janë regjistruar 8,129 banesa, prej të cilave 8,125 janë banesa të zakonshme për banim dhe 4 prej tyre lloj tjetër. 5,825 banesa janë shfrytëzuar nga një ose më shumë banorë, ndërsa 10 janë shfrytëzuar nga banorë që nuk janë përfshirë në regjistrim, si personeli diplomatik, dhe 534 banesa janë përdorur për qëllime të rastësishme ose si përdorim dytësor. 1,756 banesa, janë të pabanuara dhe të dedikuara për shitje ose qira.

**Tabelë 42.** Strukturat e ndërtuara në kuadër të vendbanimeve

| Vendbanimet | Shtëpitë | Ndërtesa-Apartament | Objekt rezidencial | Objekte komerciale | Shtëpi një katëshe | Shtëpi dy katëshe | Sip. $m^2$ | Nr. banjave |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Berkovë | 130 | 0 | 5 | 0 | 43 | 82 | 14920 | 212 |
| Bingjë | 80 | 0 | 0 | 0 | 56 | 24 | 6849 | 104 |
| Bokshiq | 142 | 0 | 5 | 0 | 61 | 76 | 17253 | 218 |
| Budisalc | 137 | 0 | 6 | 0 | 40 | 91 | 17286 | 228 |
| Qabiq | 185 | 0 | 2 | 0 | 71 | 112 | 25750 | 297 |
| Caravik | 306 | 0 | 0 | 0 | 100 | 206 | 41333 | 512 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Deiq | 132 | 0 | 16 | 0 | 52 | 64 | 19424 | 196 |
| Dobërdol | 108 | 0 | 3 | 0 | 73 | 32 | 17422 | 140 |
| Dollc | 164 | 0 | 2 | 0 | 59 | 103 | 26125 | 267 |
| Dollovë | 132 | 0 | 2 | 0 | 55 | 75 | 17322 | 207 |
| Dranashiq | 227 | 0 | 12 | 0 | 92 | 123 | 32040 | 350 |
| Drenoc | 147 | 0 | 5 | 0 | 62 | 80 | 17858 | 227 |
| Dresnik | 1091 | 11 | 61 | 0 | 368 | 651 | 172430 | 1742 |
| Dugajevë | 100 | 0 | 5 | 0 | 39 | 56 | 12634 | 156 |
| Dush | 181 | 0 | 2 | 0 | 73 | 106 | 20130 | 287 |
| Dush i vogel | 74 | 0 | 1 | 0 | 23 | 49 | 10691 | 122 |
| Gjurgjevik i madh | 182 | 0 | 2 | 0 | 58 | 122 | 21788 | 304 |
| Gllarevë | 637 | 0 | 1 | 0 | 186 | 450 | 83646 | 1087 |
| Grabanicë | 239 | 0 | 9 | 0 | 86 | 149 | 31243 | 393 |
| Gremnik | 368 | 0 | 6 | 0 | 138 | 224 | 60712 | 592 |
| Jagodë | 123 | 0 | 7 | 0 | 60 | 56 | 17448 | 179 |
| Klinafc | 595 | 2 | 17 | 0 | 256 | 320 | 77273 | 915 |
| Klinë | 3679 | 1395 | 129 | 0 | 513 | 1642 | 403324 | 5321 |
| Kpuz | 132 | 0 | 2 | 0 | 56 | 74 | 16796 | 206 |
| Krushevë e madhe | 225 | 0 | 36 | 0 | 62 | 127 | 29965 | 352 |
| Nagllavë | 37 | 0 | 0 | 0 | 7 | 30 | 5609 | 67 |
| Përqevë | 201 | 0 | 1 | 0 | 41 | 159 | 24179 | 360 |
| Pjetërq I epërm | 226 | 0 | 13 | 0 | 47 | 166 | 31161 | 392 |
| Pjetërq I poshtem | 61 | 0 | 3 | 0 | 12 | 46 | 8257 | 107 |
| Qeskovë | 91 | 0 | 6 | 0 | 26 | 59 | 12403 | 150 |
| Qupevë | 114 | 0 | 0 | 0 | 35 | 79 | 14040 | 193 |
| Rudicë | 151 | 0 | 14 | 0 | 39 | 98 | 19379 | 249 |
| Sferkë | 509 | 0 | 4 | 0 | 194 | 310 | 66575 | 818 |
| Shtupel | 345 | 0 | 14 | 0 | 106 | 225 | 44714 | 570 |
| Siqevë | 344 | 0 | 5 | 0 | 78 | 261 | 41732 | 605 |
| Stupë | 88 | 0 | 5 | 0 | 20 | 63 | 12876 | 151 |
| Ujmir | 121 | 0 | 0 | 0 | 32 | 89 | 16334 | 210 |
| Videjë | 293 | 0 | 11 | 0 | 102 | 180 | 39094 | 473 |
| Volljakë | 224 | 0 | 0 | 0 | 56 | 168 | 3339 | 392 |
| Zabërgjë | 175 | 0 | 0 | 0 | 32 | 143 | 23669 | 318 |
| Zajm | 390 | 0 | 0 | 0 | 105 | 285 | 56179 | 675 |
| Zllakuqan | 422 | 0 | 29 | 0 | 111 | 282 | 62168 | 704 |
| **Totali** | **13308** | **1408** | **441** | **0** | **3725** | **7737** | **169337 0** | **21048** |

Sipërfaqja mesatare e shfrytëzuar për kokë banori është 12 metra katrorë, e cila jep një tregues për hapësirën që çdo banor ka në dispozicion.

**Tabelë 43.** Numri i banesave të shfrytëzuara të zakonshme, numri mesatar i ekonomive familjare për banesë, sipërfaqja mesatare e shfrytëzuar për kokë banori, sipas komunës 2011

| | Numri i banesave të zakonshme të banueshme | Numri mesatar i ekonomive familjare për banesë | Mesatarja e sipërfaqes së shfrytëzuar (për kokë banori) |
|---|---|---|---|
| **Klinë** | 5825 | 1 | 12 |

*Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës -ASK, 2011*

**Tabelë 47:** Ndërtesat me së paku një banesë të zakonshme të banuar dhe komunës

| | 1 | 2 | 3-4 | 5-8 | 9-15 | 16> | **Total** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Klinë** | 4879 | 275 | 37 | 4 | 5 | 10 | 5210 |

*Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës ASK, 2011*

**Tabelë 44.** Banesat sipas llojit, ekonomive familjare dhe personave sipas tipit të vendbanimit

| Komuna dhe lloji i banesës | Gjithsej banesa ekonomi familjare dhe persona sipas tipit te vendbanimit | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | | | Urban | | | Rural | | |
| | Banesa | Ekonomi familjare | Persona | Banesa | Ekonomi familjare | Persona | Banesa | Ekonomi familjare | Persona |
| **Klinë** | 5 829 | 5 843 | 38 496 | 1 062 | 5 908 | 5 908 | 4 781 | 4781 | 32 588 |
| Banesa te zakonshme | 5 825 | 5 839 | 38 434 | 1 060 | 5 895 | 5 895 | 4 765 | 4 779 | 32 539 |
| Lloj tjetër banese | 4 | 4 | 20 | 2 | 2 | 5 | 2 | 2 | 15 |

*Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës -ASK, 2011*

**Tabelë 45.** Banesat e zakonshme sipas statusit të shfrytëzimit, llojit të pronësisë dhe komunës

| | Banesat e zakonshme me një apo më shumë banor resident | Pronës i private | Prej të cilës - pronari banon në banesë | Pronësi publike | Pronësi e përzier | Pronësi coperative | Lloj tjetër i pronësisë | Banesa të zakonshme me banor që nuk janë përfshirë në regjistrim | Banesa të rezervuara për shfrytëzim sezonal apo dytësor | Banesa të zbrazëta |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Klinë** | 5825 | 5804 | 5740 | 13 | 11 | 6 | 4 | 10 | 534 | 1756 |

*Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës ASK, 2011*

**Tabelë 46.** Banesat e banuara të zakonshme sipas periudhës së ndërtimit të ndërtesës dhe komunës

| | <1960 | 1960-1969 | 1970-1979 | 1980-1989 | 1990-1999 | 2000-2009 | 2010 | 2011 | **Total** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Klinë** | 47 | 89 | 616 | 1159 | 1209 | 2471 | 210 | 24 | 5825 |

*Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës ASK, 2011*

**Tabelë 47:** Programi Tre vjeçar i banimit 2022-2025

| KOMUNA E KLINËS | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr. i popullsisë** | | | 38.200 banorë |
| **Zonat rurale** | | | 29.500 banorë |
| **Zonat urbane** | | | 8.700 banorë |
| **Nr. i fshatrave/nr. i lagjeve** | | | 54 vendbanime |
| **Banimi Individual** | Nr. objekteve para 1999 | | 6.400 |
| | Nr. objekteve pas 1999 | | 7.230 |
| | Etazhiteti mesatar | | P+2 |
| **Banimi Kolektiv** | Para 1999 | Nr. objekteve | 18 |
| | | Nj. banimi | 280 |
| | Pas 1999 | Nr. objekteve | 28 |
| | | Nj. banimi | 1065 |
| | Etazhiteti mesatar | | P+6+Nk |
| **Statusi pronësor (Banim kolektiv)** **Para 1999** | Privat [nj. banimi] | | 90% |
| | Shoqëror [nj. banimi] | | 10% |
| **Raporti banim individual/banim kolektiv në [%]** | | | 90/10 |

*Burimi: Programi Tre vjeçar i banimit 2022-2025*

### 2.10.1. Banimi social

Komuna Klinës ka të hartuar Programin Tre vjeçar për banim 2022-2025. Investimet në sektorin e banimit në komunën e Klinës kanë filluar menjëherë pas luftës (1999), gjegjësisht pas konstituimit te Komunës. Investimet në ekonominë e Klinës përfshinin ndërtimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve për jetë më të mirë. Këto investime mund të klasifikohen në dy faza:

**Faza I** kishte të bënte me periudhën emergjente ose krijimin e kushteve për banimin e qytetareve të mbijetuar e të cilëve iu ishin shkatërruar shtëpitë dhe pronat. Ndërsa, **Faza II** përfshinë periudhën e investimeve kapitale ose krijimin e kushteve për jetë më të mire, për një infrastrukturë më të zhvilluar dhe përpjekjet për zhvillimin e ekonomisë së mirëfilltë për të gjithë qytetarët e komunës së Klinës.
Në fazën e parë, faktor vendimtar kanë qenë donatorët e ndryshëm, kryesisht ndërkombëtar, e të cilët mjetet e tyre i orientuan kryesisht për ringritjen e ekonomive familjare në sektorin e banimit. Ndër organizata të shumta ndërkombëtare që investuan në Komunën e Klinës ishin edhe UNDP, DRC, MERCY CORPS, Caritas Sëitzerland etj.
Përfitues në ndërtimin e shtëpive nga donatorët në periudhën emergjente (2000-2009) ishin 1,288 familje, ndërsa edhe aktualisht investimet nga donatorët përbëjnë pjesën më të madhe të investimit në ndihmën ndaj qytetarëve për ndërtimin e shtëpive.
Në vitin 2006-2009, në Komunën e Klinës është implementuar programi për kthim të qëndrueshëm, nga ky program në bashkëveprim me Komunën janë implementuar 6 projekte: Pograxha, Klinafci 1 dhe 2, Bërkova 1 dhe 2 si dhe Rudica dhe Dollci, vlera e projektit përafërsisht ka kushtuar 1,350,000.00. Në këtë fazë përfitues ishin kryesisht pjesëtarë të komunitetit serb që kanë shprehur dëshirën për kthim, ndërsa në tërësi nga këto projekte kanë përfituar 224 familje në ndërtimin e shtëpive. Mjetet financiare janë siguruar nga donatorët, MKK si dhe Komuna e Klinës.
Edhe komunitetet tjera jo shumicë kanë përfituar nga donacionet dhe mjetet buxhetore lokale dhe qendrore. Në këtë mënyrë, 118 objekte të banimit individual- si në qytet e po ashtu edhe në fshatrat e Klinës- janë ndërtuar për pjesëtarë e minoritetit rom, ashkali dhe egjiptian.
Tutje: Në komunë e Klinës janë ndërtuar edhe 4 objekte banesore me qëllim të zgjidhjes së problemit të banimit për familjet që kanë nevoja për strehim.

**Tabelë 48.** Objektet e dedikuara për banim social

| Nr | Objekti | Viti i ndërtimit | Donatori | Etazhitetit | Njësit banesore | Parcela Kadastrale |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Banesa I | 2005 | MMPH | P+4 | 23 njësi banesore | 585-2 |
| **2** | Banesa II | 2006 | Donator | P+4 | 23 njësi banesore | 414-1 |
| **3** | Banesa III | 2010 | MPMS | P+4 | 25 njësi banesore | 585-2 |
| **4** | Banesa IV | 2018 | MPMS | P+6 | 35 njësi banesore | 414-1 |

*Burimi: Programi Tre vjeçar i banimit 2022-2025*

**Tabelë 49.** Familjet momentalisht të ndihmuara me banim social

| Nr | Mënyra e ndihmës | Nr i familjeve të ndihmuara | Nr I individëve të ndihmuar | Data e fillimit të ndihmës | Data e skadimit të ndihmës | Vlera e qirasë/ndihma financiare ( ) mesatarja |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira | 106 | 106x5=530 | 2005 | N/A | 0.30 e $m^2$ |
| 2 | Banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit | N/A | | | | |
| 3 | Banesat tjera në pronësi të komunës që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim; | N/A | | | | |
| 4 | Shtëpi individuale të ndërtuara nga donatorët të huaj/ vullnetarë | N/A | | | | |
| 5 | Renovime/riparime | N/A | | | | |

*Burimi: Programi Tre vjeçar i banimit 2022-2025*

Në komunën e Klinës informatat bazike të kategorive në nevojë për banim social janë si ne vijim:

**Tabelë 50**: Kërkesat për banim social

| | Kërkesat për banim social | |
|---|---|---|
| 1 | Me asistencë sociale | 75 |
| 2 | Kategoritë e dala nga Lufta 1 | 65 kërkesa |
| 3 | Të kthyerit | 17 familje |
| 4 | Të riatdhesuarit | 6 shtëpi banimi |
| 5 | Të moshuarit | 1 |
| 6 | Të rinjtë | 2 |
| 7 | Të punësuarit nga buxheti shtetëror | 4 kërkesa |

| | | |
|---|---|---|
| **8** | Minoritetet | 270 |
| **9** | Tregu i banimit | S'ka informata |
| **10** | Shitja e banesave në treg | 550e /$m^2$ |
| **11** | Të dhëna me qira | 116 |
| **12** | Me qira në kushte të caktuara | 0 |
| **13** | Pa qira | S'ka informata |

*Burimi: Programi Tre vjeçar i banimit 2022-2025*

***Familjet me asistencë sociale***: Numri i familjeve shfrytëzuese të asistencës sociale për muajin Nëntor 2022 ishte 848 (e dhëne e marre nga Raporti mujor financiar-ndihma sociale). Ndërsa, kërkesat faktike për përkrahje janë paraqitur si në tabelën e mësipërme:

- Kategori të dala nga lufta: prej vitit 2004 deri në vitin 2018 janë ndarë 106 njësi banesore, ndërsa janë ndërtuar 5 shtëpi. 35 njësi banesore për kategoritë e dala nga lufta janë ndarë në vitet 2018-19.
- Te kthyerit/riatdhesuarit: gjatë viteve 2021-2022, 1 familje ka paraqitur kërkesë për përkrahje faktike, ndërsa 230 persona-familje kanë paraqitur kërkesa për t'u kthyer dhe riatdhesuar;

• Te riatdhesuarit: Janë paraqitur 8 kërkesa për zgjidhjen e çështjes së banimit. Vetëm 4 raste të riatdhesuara janë në procedurë për ndërtimin e shtëpisë.

• Minoritetet: nga lista e vitit 2021-2022 janë paraqitur 30 kërkesa për zgjidhjen e çështjes së banimit, ndërsa janë ndërtuar 13 shtëpi;

•Përfituesit nga programi OJQ " Voice of Roma, Ashkali and Egyptians: për ndërtim, renovim të shtëpive për vitin 2021-2022 janë 13 familje, ku vlera për investime e këtij programi ka kushtuar 30,000.00 E.

• Janë 906 persona të punësuar në sektorin publik dhe rreth 2000 të punësuar në atë privat, ku shumica prej ttyre në qytetin e Klinës ( Plani Zhvillimor Komunal 2014-2021).

## 2.11. SHFRYTËZIMI AKTUAL I TOKËS

Komuna e Klinës ka një sipërfaqe totale prej 30869.01 ha, nga e cila 34.94% janë pyje dhe kullosa, 47.02% janë tokë bujqësore, 10.65% banim i përhershëm, 3.05% rrjetet e transportit, 0.13% industri dhe pjesa tjetër e territorit të komunës shfrytëzohet nga kategori të tjera si në tabelën më poshtë.

**Tabelë 51.** Shfrytëzimi tokës sipas sipërfaqeve (ha) dhe përqindjes

| LLOJI I SHFRYTËZIMIT | SIPËRFAQJA (Ha) | % |
|---|---|---|
| Bujqësi | 14582.55 | 47.02% |
| Pylltari | 10787.76 | 34.94% |
| Rekreative, Turistike | 16.70 | 0.05% |
| Zonë e mbrojtur | 192.40 | 0.62 |
| Zonë e veçantë e mbrojtur | 11.86 | 0.03 |
| Zonë për shfrytëzim të përzier | 101.29 | 0.32 |
| Industri | 34.08 | 0.13% |
| Minierë Sipërfaqësore | 338.99 | 0.11 |
| Komerciale | 27.79 | 0.09% |
| Prodhim tretësor / Shërbim i komunitetit / Shërbim i adminstratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale | 117.44 | 0.38% |
| Shërbime | 147.78 | 0.47% |
| Komunikacion-Transport | 942.91 | 3.05% |
| Banim | 3288.30 | 10.65% |
| Sipërfaqe Ujore | 279.15 | 0.90% |
| Gjithsej: | **30869.01 Ha** | **100%** |




**Harta 34.** Harta e Shfrytëzimit të Tokës

## 2.12. KAPACITETET NJERËZORE DHE FINANCIARE TË KOMUNËS

### 2.12.1. Kapacitetet njerëzore

Bazuar në të dhënat nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, në komunën e Klinës dominon kryesisht niveli i shkollimit të mesëm të ulët. Rreth 40% e popullsisë e kanë të përfunduar këtë nivel të shkollimit. Me shkollim të mesëm të lartë janë rreth 22%, ndërsa me shkollim fillor rreth 20% e popullsisë.

**Tabelë 52**: Popullsia e komunës së Klinës sipas nivelit të shkollimit

| Niveli i shkollimit | Meshkuj | Femra | Gjithsej | % |
|---|---|---|---|---|
| Nuk kanë përfunduar arsimin | 1,218 | 2,071 | 3,289 | 10.5 |
| Me shkollë fillore | 2,636 | 3,694 | 6,330 | 20.2 |
| Me shkollë të mesme të ulët | 5,389 | 7,315 | 12,704 | 40.6 |
| Me shkollë të mesme të lartë | 4,953 | 2,164 | 7,117 | 22.8 |
| Të diplomuar | 1,174 | 512 | 1,686 | 5.4 |
| Me diploma universitare (Master, PhD) | 114 | 31 | 145 | 0.5 |
| Gjithsej | 15,484 | 15,787 | 31,271 | 100 |

Përqindja e atyre që kanë përfunduar shkollimin e lartë është rreth 5 %, ndërsa i atyre me diploma pasuniversitare është vetëm 0.5%. Dallimet gjinore janë të theksuara edhe në këtë nivel të shkollimit. Ajo që mbetet ende shqetësuese është numri jo i vogël i atyre që nuk dinë shkrim-lexim dhe i atyre që nuk kanë të përfunduar shkollimin fillor. Janë mbi 10% e popullsisë që nuk kanë të përfunduar asnjë nivel të shkollimit. Në vazhdim janë paraqitur të dhënat rreth kapaciteteve administrative të Komunës së Klinës, ku janë prezantuar numri i të punësuarve gjatë periudhës 2015-2021. Gjatë kësaj periudhe numri i të punësuarve ka vazhduar të mbetet i njëjtë në të gjithë sektorët. Ndërsa në tabelën pasuese është paraqitur përvoja e punës së personelit në fjalë.

**Tabelë 53.** Pasqyra dhe trendët e punësimit të shërbyesve civil në administratë sipas drejtorive, 2015- 2021

| Drejtoria: | Të punësuar sipas viteve | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2021 |
| Zyra e kryetarit | 10 | 10 | 10 | 10 | 10 |
| Administratë dhe personel | 45 | 45 | 45 | 45 | 45 |
| Buxhet e Financa | 20 | 20 | 20 | 20 | 20 |
| Inspekcioni | 7 | 7 | 7 | 7 | 7 |
| Shërbime publike dhe komunale | 18 | 18 | 18 | 18 | 18 |
| Bujqësi Pylltari dhe Zh. Rural | 11 | 11 | 11 | 11 | 11 |
| Kadaster , Gjeodezi, Pronësi | 11 | 11 | 11 | 11 | 11 |
| Urbanizëm, Planifikim , Mjedis | 6 | 6 | 6 | 6 | 6 |
| Kulturë Rini e Sport | 14 | 14 | 14 | 14 | 14 |
| Zkk | 4 | 4 | 4 | 4 | 4 |
| Shëndetësia dhe mirëqenia sociale | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 |
| Shërbimet sociale | 11 | 11 | 11 | 11 | 11 |
| Arsimit dhe shkencës | 6 | 6 | 6 | 6 | 6 |
| **Gjithsej:** | 165 | 165 | 165 | 165 | 165 |

**Tabelë 54.** Përvoja e punës e shërbyesve civil në administratë sipas drejtorive, 2021

| Drejtoria: | Vite përvojë pune: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 0- 5 | 6- 10 | 11- 15 | 16- 20 | Gjithsej |
| Zyra e kryetarit | 20 | 3 | 6 | 23 | 52 |
| Administratë dhe personel / komunikimi | 3 | 0 | 0 | 4 | 7 |
| Buxhet e Financa | 2 | 1 | 0 | 15 | 18 |
| Inspekcioni | 6 | 0 | 0 | 2 | 8 |
| Shërbim publik komunal dhe emergjent | 44 | 8 | 19 | 85 | 156 |
| Bujqësi Pylltari dhe Zh. Rural | 12 | 2 | 0 | 4 | 18 |
| Kadaster, Gjeodezi, Pronësi | 132 | 112 | 74 | 338 | 645 |
| Urbanizëm, Planifikim , Mjedis | 1 | 0 | 0 | 4 | 5 |
| Kulturë Rini e Sport | 4 | 5 | 2 | 2 | 13 |
| Zkk | 2 | 2 | 2 | 7 | 13 |
| Shëndetësia dhe mirëqenia sociale | 20 | 3 | 6 | 23 | 42 |
| Shërbimet sociale | 3 | 0 | 0 | 4 | 7 |
| Arsimit dhe shkencës | 2 | 1 | 0 | 15 | 18 |
| Gjithsej: | 226 | 133 | 103 | 484 | 946 |

### 2.12.2. Kapacitetet financiare

Komuna e Klinës është një komunë jo shumë e madhe dhe gjithashtu karakterizohet edhe me kapacitete mjaft të kufizuara financiare. Në vazhdim janë paraqitur pasqyra dhe trendet e realizimit të të hyrave vetanake sipas kategorive kryesore për vitet 2022 – 2024:

**Tabelë 55.** Pasqyra dhe trendët e realizimit të të hyrave vetanake sipas kategorive kryesore, 2022- 2024

| **Kategoria e te hyrave vetanake:** | **Te hyrat - viti:** | | | **Trendet e rritjes / zvogelimit - viti:** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2022 | 2023 | 2024 | 2022 - 2023 | 2023 - 2024 | **2022 - 2024** |
| Tatimi ne prone: | 453,281.30 | 621,791.15 | 550,999.44 | 168,509.85 | 70,791.71 | **97,718.14** |
| Regjistrimi i automjeteve: | 80,326.50 | 86,049.50 | 93,624.92 | 5,723.00 | 7,575.42 | **13,298.42** |
| Lejet e ndertimit: | 300,448.67 | 303,282.64 | 264,474.25 | 2,833.97 | 38,808.39 | **35,974.42** |
| Regjistrimi i trashegimise: | - | | | | - | **-** |
| Nderrim i destinimit te tokes: | - | | | | - | **-** |
| Dokumentet e gjendjes civile: | 41,646.20 | 44,518.00 | 41,723.00 | 2,871.80 | 2,795.00 | **76.80** |
| Veprimtarite afariste: | 73,565.85 | 61,519.10 | 60,067.00 | -12,046.75 | 1,452.10 | **13,498.85** |
| Shfrytezimi i prones publike: | 10,427.23 | 11,219.08 | 9,707.85 | 791.85 | 1,511.23 | **719.38** |
| Participimet ne Arsim dhe Shendetesi: | 100,116.20 | 101,607.10 | 118,282.00 | 1,490.90 | 16,674.90 | **18,165.80** |
| Tjera: | 146,806.16 | 155,814.47 | 149,910.24 | 9,008.31 | 5,904.23 | **3,104.08** |
| **Gjithsej:** | **1,206,618.11** | **1,385,801.04** | **1,288,788.70** | **179,182.93** | **97,012.34** | **82,170.59** |

Siç shihet edhe nga tabela, pjesa më e madhe e të hyrave realizohen nga tatimi në pronë